



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 1 DHE 2 MARS 2012**

T R A N S K R I P T

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
1. I 2. MARTA 2012. GODINE**

**MARS – MART
2012**

Më 1 dhe 2 mars 2012

Drejton seancën plenare, kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kabinet qeveritar,
Hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare.

Prezent janë 67 deputetë, që do të thotë se mund të fillojmë punën.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës,

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta.
Diskutime në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.
Deputetët e paraqitur për diskutim, duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e marrin fjalën – në emër të grupit apo në emër të vet personal.

Atëherë, po fillojmë me diskutime. Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuari kryetar,
I nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Në Raportin final të Misionit të ekspertëve të zgjedhjeve për Kosovën të Bashkësisë Evropiane, të përpiluar më 25 janar 2011, në faqen 61 të tij, decidivisht theksohet:

“Se dyshimet për mashtrime në dy komuna e kanë tërhequr vëmendjen e delegacionit. Njëherësh delegacioni inkurajon partitë politike që të respektojnë procedurat adekuate ligjore në mënyrë që kryerësit e identifikuar të keqpërdorimeve të ndiqen penalisht, sa më shpejt që është e mundur në pajtim me ligjin, me qëllim të përmirësimit të kulturës së mosndëshkimit në Kosovë”.

Kurse, në Raportin e Ulrike Lunacek, raportuese për Kosovën, të aprovuar nga Parlamenti Evropian më 24 janar 2012, i cili në mars do të shndërrohet në rezolutë, kërkohet që të zhvillohen hetime të mirëfillta lidhur me parregullsitë në zgjedhje dhe të bëhet ndëshkimi i kryerësve të mashtrimeve të procesit zgjedhor të vitit 2010 në Kosovë.

Mirëpo, si duket, këto kërkesa të institucioneve relevante ndërkombëtare po hasin në vesh të shurdhër të gjyqësorit të ndikuar kosovar, sepse gjatë vitit 2011 nga 154 lëndë me 840 kryerës për vepra penale kundër zgjedhjeve, janë zgjidhur apo përfunduar vetëm 41 lëndë apo 26,6% të tyre.

E keqja tjetër është se edhe masat e shqiptuara ndaj kryerësve nuk janë proporcionale me rrezikshmëri shoqërore të këtyre veprave penale.

Gjyqësori kosovar, në vend të zbatimit të një politike adekuate ndëshkimore, thjeshtë ka shqiptuar sanksione penale qesharake dhe stimuluese për kryerësit potencialë.

Prej 191 personave të gjykuar - në 41 lëndë të zgjedhura, 92 persona apo 48,1% prej tyre janë dënuar me të holla dhe atë prej 250 deri 1.350 euro, ndërsa 39 persona apo 20% të tjerë janë dënuar me kusht. Ndaj 42 personave apo 21% të tyre janë marrë aktgjykime refuzuese, janë liruar nga dënimi apo në mënyra tjera kanë mbetur pa u ndëshkuar, kurse vetëm 18 persona apo 9,4% të tyre janë dënuar me burg efektiv, dhe atë pjesa dërmuese e tyre me burg prej vetëm 40 ditëve deri në 6 muaj.

Po qe se analizohen sanksionet, sipas gjykatave komunale që i kanë shqiptuar, atëherë bie në sy një fakt tjetër zhgënjyes – se nga komunat ku janë përsëritur zgjedhjet dhe atë: Mitrovica, Skenderaj, Deçani dhe Drenasi, vetëm Gjykata e Drenasit ka dënuar me burg 4 kryerës të këtyre veprave penale. Ndërsa, për befasi, në listën e numrit të të dënuarve me burg, prin Gjykata e Dardanës me 6 të dënuar të këtillë, ndonëse në Dardanë nuk janë përsëritur zgjedhjet.

Andaj, nga kjo foltore e Kuvendit apeloj te organet tona gjyqësore që të jenë më koshientë për peshën e veprave penale dhe t'i ndjekin e ndëshkojnë kryerësit e këtyre veprave penale me këmbëngulësi dhe vendosmëri më të madhe, se për ndryshe edhe më tutje do të shkruhen dhe aprovohen raporte e rezoluta me përmbajtje jo pozitive për vendin tonë, të cilat do ta vështirësojnë procesin e integritetit dhe asocimit të Kosovës në mekanizmat relevantë ndërkombëtarë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën. Lus të deklaroheni, në emër të kujt e merrni fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Arsyeja pse dola të flas në emër të Grupit Parlamentar janë pikërisht debatet që janë zhvilluar javën e kaluar, debate shumë të rëndësishme, të cilat me të drejtë kanë nxitur shqetësim jo vetëm te njerëzit e rëndomtë por edhe te përfaqësuesit e zgjedhur nga populli, e padyshim edhe të deputetëve të Kuvendit të Kosovës si përfaqësues legjitimë të popullit dhe në emër të Partisë Demokratike mendoj se këtë debat duhet ta vendosim në sfondin institucional, në sfondin kushtetues e zyrtar dhe padyshim se Kuvendi i Kosovës është institucion i thirrur për ta debatuar këtë çështje dhe Partia Demokratike është e hapur që nëse ka nevojë apo nëse kërkohet t'i përgjigjet kërkesës për një debat përmbajtësor në Kuvendin e Kosovës.

Në të vërtetë, shqetësimi ka qenë real, sepse ne po ballafaqohemi me realitetin. Pra, po ballafaqohemi me faktin se jo gjithëherë politikat ndërkombëtare përputhen me politikat vendore.

Dëshiroj të tërheq dy paralele. Paralelja e parë, që definitivisht, sa i përket Kosovës Pavarësia e Kosovës është një proces i kryer, një proces i njohur ndërkombëtarisht dhe asnjë proces ndërkombëtar nuk mund ta dëmtojë këtë proces historik, proces të koordinuar për të cilin meritat më të mëdha i takojnë popullit të Kosovës por pa dyshime dhe të miqve tanë me të cilët kemi udhëtuar bashkë, sidomos këto dy dekadat e fundit, drejt cakut tonë.

Çështja e dytë, çështja e emrit të Kosovës. Emri i Kosovës është Republika e Kosovës dhe për shtetasit e Kosovës, për institucionet e Kosovës ky është emri i Kosovës.

Fatkeqësisht, Bashkimi Evropian vazhdon të udhëheqë politikat e padrejta karshi Kosovës. Vazhdon të mos ndërtojë një unitet çfarë e kanë miqtë me të cilët ne e kemi shpallur Pavarësinë e Kosovës, dhe Kosova ka qenë midis zgjidhjeve – zgjidhjes së status quos, pra një lloj përjashtimi apo degradimi institucional në forumet rajonale dhe forumet evropiane, duke pranuar diskreditimin institucional apo duke e pranuar përfaqësimin përmes UNMIK-ut dhe Rezolutës 1244 që padyshim është një rezolutë e vdekur por fatkeqësisht nuk i është organizuar ceremonia mortore e varrimit, për shkak se Këshilli i Sigurimit e mban ashtu të vdekur funksionale.

Dhe, zgjidhja e dytë ka qenë që ne ta faktorizojmë Republikën e Kosovës dhe Republika e Kosovës të flasë në emër të vet, ta përfaqësojë veten dhe të fillojë të bëhet pjesë e komunitetit ndërkombëtar, pjesë e mekanizmave evropianë.

Në këtë kontekst, ne e shohim këtë zgjidhje provizore, të përkohshme që Kosova të bëhet partner i marrëdhënieve ndërkombëtare, të fillojë të anëtarësohet në mekanizma evropianë dhe siç e dini ne dy ditë pas kësaj marrëveshje morëm rezultatin e parë, morëm ofertën për fillimin e studimit të fizibilitetit – që është stad i parë i marrëdhënieve kontraktuale dhe me këtë u dëshmuua se jemi shtet, sepse një ofertë e tillë, të nderuar kolegë, nuk u jepet regjioneve, nuk iu jepet autonomive por iu jepet shtetit dhe të gjithë do të donim që kjo të jepej pa të ashtuquajturën fusnotë, por fatkeqësisht politikat evropiane nuk i ndërton Kosova po i ndërton Bashkimi Evropian dhe fatkeqësisht 5 shtete që s’e kanë njohur Kosovën po e pengojnë një politikë unike të Bashkimit Evropian.

Për këtë arsye, ne shohim një zgjidhje të vështirë, por të domosdoshme me qëllim të afirmimit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe me qëllim që në emër të Republikës së Kosovës të flasin institucionet legjitime të Republikës së Kosovës dhe ne të fillojmë që pavarësinë tonë ta bëjmë realitet në raport me Bashkimin Evropian dhe të fillojmë të bëhemi pjesë e mekanizmave të ndryshëm politikë, ekonomikë, socialë dhe sportivë.

Për këtë arsye, mendoj se kjo temë është një temë që nga ne kërkon një diskutim racional, diskutim kritik por edhe diskutim të mençur në mënyrë që ne assesi të mos e spostojmë debatin në një debat të brendshëm politik, në një përplasje në mes partive politike sepse mendoj që këto politika ndërkombëtare ndërtohen në relacione ndërkombëtare dhe në raporte të forcave ndërkombëtare ku Kosova, fatkeqësisht, ende nuk është subjekt që

ndikon në politikat ndërkombëtare, por ne jemi një subjekt tani i cili bashkë me partnerët tanë mund ta faktorizojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama!

ALMA LAMA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kompromiset e fundit që bëri Qeveria e Kosovës në kurriz të pavarësisë janë alarmante. Kryeministri ringjalli Rezolutën 1244 e cila, edhe pse ishte në fuqi, formalisht nuk vepronte në praktikë dhe de fakto po shkonte drejt asgjësimit.

Qeveria e Kosovës nënshkroi marrëveshje në kundërshtim me vetveten, statusin dhe vullnetin e popullit të Kosovës, marrëveshje të cilat e përjetësojnë kontestimin e shtetësisë.

Gjëja më e habitshme është se si pikërisht ata që i futën bërnylat gjithkujt vetëm e vetëm që të lexonin vetë Deklaratën e pavarësisë, po i bëjnë këto lëshime. Mbase kjo nuk do të kishte ndodhur sikur Deklaratën e pavarësisë ta kishin shkruar vetë.

Javën që shkoj është shënuar pika më negative që prej se këto bisedime kanë filluar, e në fakt që prej 4 vitesh që kur u shpall pavarësia.

Se si ka ardhur puna deri këtu, e dimë të gjithë. Një dialog i filluar pa nevojë, pa strategji, pa përgatitje. E dimë po kështu se qytetarëve të këtij vendi s'po iu jep llogari askush për këto marrëveshje. Mirëpo, secili duhet të jetë i sigurt se do t'i japin llogari historisë. Gjykimit të saj nuk i shpëtojnë dot.

Kjo Qeveri nuk e kupton ose nuk dëshiron ta kuptojë se në mënyrë që Serbia të hyjë në BE duhet të kushtëzohet Serbia e jo Kosova, që kompromiset duhet t'i bëjë Serbia e jo Kosova.

Kjo Qeveri nuk dëshiron ta kuptojë se stërzgjatja e ambiguitetit apo dykuptimësisë nuk e zgjidhë problemin. Vetëm e komplikon atë. Se pranimi i fusnotës nuk e forcon shtetësinë, por e dobëson atë. Që identiteti shtetëror dhe ai gjeografik janë dy nocione të ndryshme. Që asnjë iniciativë rajonale nuk është më e rëndësishme se vet ekzistenca e shtetit. Se të marrësh pjesë në tavolina nuk është njëlloj sikurse të të njohin rolin që je. Për më tepër, që në fakt është Serbia ajo që deri tani ka refuzuar tryezat rajonale për shkak të prezencës së Republikës së Kosovës. Pra, marrëveshja u bë për ta nxjerrë Serbinë nga qorrsokaku ku kishte hyrë që prej shpalljes së pavarësisë.

I kam dëgjuar arsyetimet e ditëve të fundit nga ana e zyrtarëve qeveritarë dhe të them të drejtën jam dukur sa komike po aq edhe tragjike. Por kaq tragjikomike sa që është edhe zëvendësimi i Republikës me fusnotë. Është po kaq tragjikomike tendenca për të

paraqitur dështimin si sukses, për ta bërë të zezën të bardhë, për të mashtruar opinionin se jemi shpërblyer nga BE-a.

Sa për informacion BE-a për vendet e rajonit ka aprovuar studimin e fizibilitetit i cili është një proces mjaft i ngjashëm me atë të Raportit të progresit para shumë viteve. Për shembull për Shqipërinë në vitin 1999, Bosnjën 2003, Serbinë 2004 e tjerë. Ndërsa, për Kosovën nuk kemi as aprovim, por siç thuhet në komunikatën e lëshuar nga Bashkimi Evropian....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jeni në emër të Grupit, a? Atëherë, ju lus të lajmëroheni me kohë!

ALMA LAMA: ... Këshilli merr parasysh qëllimin e Komisionit për të nisur një studim fizibiliteti, për një marrëveshje të stabilizim-asocimit në mes BE-s dhe Kosovës. Në fakt, këtu nuk ka asnjë garanci as për fillimin e studimit e jo më për një marrëveshje siç është MSA-s, ndërsa dialogu Serbisë i mundëson të marrë statusin e vendit kandidat, Kosovës i sjell një shenjë pozitive, siç e quan edhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian. Serbisë iu mundësua që të mbërrijë te statusi i kandidatit pa ndryshuar natyrën e marrëdhënieve aktuale me Kosovën, pra, kontestimin e pavarësisë dhe sovranitetit, si dhe pa hequr dorë nga minimi i përditshëm i funksionalitetit të Kosovës.

Ndërsa, Kosovës nuk i mbetet gjë tjetër veç se të merret me deklarata militanteske të cilat kanë shkuar aq larg sa tani edhe Rezolutën 1244 e paraqesin si të dobishme. Vetëm pak ditë më parë kryeministri i Kosovës deklaroi se nuk do ta pranonte fusnotën edhe sikur e gjithë Kosova ta pranonte. A ishte ai ato ditë antiamerikan? Sot e kemi një situatë ku e gjithë Kosova është kundër, por ai e pranoi. Arsyet e këtij ndryshimi radikal të qëndrimeve mund t'i shpjegojë vetëm kryeministri, por edhe nëse, ai si thotë – populli e di. Për më tepër, populli nuk mashtrohet. Abraham Linkoln ka thanë “Ju mund ta mashtroni një popull një herë, mund ta mashtroni dy herë, por jo përjetësisht”.

Çështja është se a do të pranonte ky kryeministër dhe kjo Qeveri marrëveshje të tilla në rast se nuk do të kishte dalë nga votat e vjedhura, në rast se mbi të nuk do ta rëndonin akuza të rënda, në rast se krimi dhe korrupsioni nuk do të ishin problemet e saj më të mëdha, në rast se nuk do të ishin bërë milionerë në mënyrë të paligjshme, në rast se do të ishte një Qeveri me duar të pastra, në rast se do të kishte kredibilitet, dije dhe vendosmëri. Por mbi të gjitha, a do t'i bënte këto kompromise në rast se do të merrte parasysh vullnetin e qytetarëve, në rast se do të merrte para sysh mendimin e opozitës, por edhe të vetë deputetëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
Flas në emër të Grupit, zoti kryetar.

Nuk e kam në plan me ju treguar se çka ka në marrëveshje. Keni me pa shpejt, por një prej provizioneve është se Kosova duhet të përmbahet prej përdorimit të filmuarit në takime rajonale, e unë i kisha propozuar Kuvendit që ta nxjerrë një ligj që të gjithë ata që e përfaqësojnë Kosovën diplomatikisht të vishen me simbole sikur flamuri, me kravata, me shalla ose me çorapa dikush. Edita e ka lehtë, se i vë syzat si flamuri i Kosovës, por diqysh duhet me u duketë si flamur këta që e përfaqësojnë se flamur s'ka me pas.

Sidoqoftë, zoti kryetar, për ta qeverisur vendin nuk mjafton vetëm me pretenduar se e don vendin. Duhet me qenë shumë i dedikuar me punuar shumë dhe me dit me qeverisë.

Kur kombinimi është që në Qeveri ka njerëz që as nuk kanë dedikim, as nuk j anë punëtorë dhe as nuk dinë me qeveris, rezultati është më zi se katastrofa.

Gjendja, në të cilën jemi ne sot, apo Kosova në të cilën është, ekskluzivisht është pasojë e keqqeverisjes së vendit, jo e forcave të jashtme, jo e konspiracioneve. Gjendja në të cilën ndodhe Kosova është pasojë e Kosovës.

Qeveria, e cila sot është në pushtet, ka ardhur në pushtet duke i premtuar vendit ulje të papunësisë, ulje të korrupsionit, luftë kundër korrupsionit, dalje nga objektet me qira, 24 orë rrymë, liberalizim të vizave – që kryeministri Thaçi ka thënë brenda 2011, për integrim të veriut.

Krejt këto janë premtime që kjo Qeveri i ka bërë për me ardhur në pushtet. Ajo çka ka mbërri me bë, është krejtësisht e kundërta. Totalisht, e kundërta.

Vetëm ne nuk kemi rrymë. Vetëm ne nuk kemi liberalizim të vizave. Vetëm ne nuk kemi kod telefonik. Vetëm ne nuk e kontrollojmë hapësirën ajrore komercialisht. Vetëm ne edhe në spital na pikon kanalizimi, pra në spitalin kryesor të shtetit – 4 vjet pas pavarësisë. Vetëm te na ma shumë shpenzohet për me i mirëmbajtur veturat e ministrave se me i mirëmbajtur spitalet. Vetëm te na... Vetëm te na është më pastër, më ngrohtë dhe hahet më mirë në burg se në spital. Vetëm në këtë Kosovën tonë.

Kosova është shndërruar në vend të cilin askush nuk e do. As nuk e donë qytetarët e vet as nuk e donë të huajt.

Aleanca, iu ka thënë në pranverë të vitit 2008 se duhet plan për integrimin e veriut. Kryeministri na ka përqeshur.

Iu kemi thënë se nuk bën me i pranuar 6 pikat. Keni thënë se ato nuk ekzistojnë.

Ju kemi thënë në vitin 2010, në shtator se po zhvillohen biseda sekrete. Na keni thënë se keni halucinacione ju. Tash po i pranoni vet, se keni pasur. Nuk keni ngu. Jeni tallë me ditë.

Në këtë foltore, ju kam thënë një herë se kjo Qeveri ia ka qitur faqen e zezë Kosovë. Po ju them edhe një herë sot: Ia keni qitur faqen e zezë Kosovës.

Kjo Qeveri ka bërë që sot Serbia me u duktë vend më civil, më i mirë, më evropian se Kosova.

Ju keni bërë që sot Kosova me u duktë vend i trafikantëve. Me u duktë vend i të korruptuarve, me u duktë vend i hajnave dhe i njerëzve që nuk e kanë asnjë lidhje se qysh qeveriset vendi.

Kjo Qeveri e ka shpenzuar Kosovën dhe fusnota është pasojë e kësaj Qeverie. Kjo qeveri e ka shpenzuar Kosovën financiarisht, se i ka shterur rezervat buxhetore dhe e ka futur borxh vetëm për katër vjet Kosovën.

E ka shpenzuar politikisht se i ka vjedhur votat e qytetarëve të Kosovës. E ka shpenzuar diplomatikisht se për çdo vendim të keq të vetin ia ka lënë fajin ose Amerikës ose Evropës – se po na bëjnë presion. Dhe e ka shpenzuar moralisht se kushdo që na e sheh fytyrën neve sot në Evropë mendon edhe një herë se jemi trafikantë, narkomanë, hajna dhe kontrabandues të njerëzve.

Kjo është Kosova që shihet diku sot dhe vetëm Qeveria e Kosovës i ka fajet, askush tjetër.

Dhe, në fund të fundit, Kosovën nuk mund ta nxjerrin prej kësaj situatë ata që e kanë sjellë. Nuk mundet sot Qeveria me thënë – prej sot domi me e luftuar korrupsionin. Kush i zë besë? Qysh munden me thënë: deri sot vjedhëm, sot e te mas nuk donë me vjedhë. A i zë besë kush kësaj pune? Nuk i zë besë.

E në të njëjtën mënyrë, nuk i zë besë dikush që prej kësaj gjendje në të cilën e kanë prurë, se munden me e nxjerrë këta njerëz. Nuk munden, nuk kanë as kredibilitet moral, nuk kanë as dije, nuk kanë as vullnet.

Mund të ju them se Kosova ka ardhur në gjendje me i thirrur forcat politike, forcat intelektuale, forcat qytetare me nisë e me i larguar këta njerëz prej pushtetit për shkak se nuk ua kemi borxh me na sjellë gjithçka zi në këtë vend.

Aleanca po ju thotë se nëse kështu ka me vazhduar, populli i Kosovës edhe më pak ka me dashtë vendin e vet. Populli i Kosovës nuk po e respekton as pavarësinë e vet, për shkak të Qeverisë, jo për shkak të forcave të jashtme. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu dhe ajo le të tregojë në emër të kujt e merr fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Kryetar, në emër timin personal.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kabinet qeveritar,

Çështjen të cilën dua ta shtroj sot, ka të bëjë me problemet pronësore të cilat janë shfaqur para një kohe në komunën e Malishevës, fshati Bellanicë dhe komunën e Suharekës,

fshati Grajkoc, të cilat janë të lidhura me nacionalizimin e pronave gjatë periudhave të ndryshme të historisë në Kosovë.

Pas vitit 1945 në ish shtetet komuniste socialiste, janë bërë forma të ndryshme të nacionalizimit të pronave të paluajtshme, përfshirë këtu edhe ish Jugosllavinë.

Në Kosovë ka pasur nacionalizim të pronave edhe në mes të dy luftërave botërore, sidomos përmes reformave agrare dhe kolonizimit. Tani shumica e shteteve socialiste e kanë nxjerrë ligjin për kthimin e pronave të nacionalizuara. Ndërsa Kosova, edhe pse është e obliguar me propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës për ta nxjerrë një ligj të tillë, këtë ende nuk e ka bërë.

Në vitin 2007 është formuar një Grup pune për hartimin e një ligji të tillë, por ajo ka mbetur vetëm në nismë. Vonesa e nxjerrjes së këtij ligji e ka bërë të pamundur procesin e kthimit të pronave pronarëve të mëhershëm, pasi që shumica e pronave të paluajtshme, të cilat janë nacionalizuar tani janë privatizuar përmes procesit të tenderimit të AKM-ës dhe aktualisht forma e kthimit është një proces i ndërlikuar dhe me shumë procedura.

Në mungesë të këtij ligji për kthimin e pronave të nacionalizuara, si gjykatat ashtu edhe organet tjera që merren me zgjidhjen e konteksteve pronësore, nuk kanë bazë ligjore për kthimin e atyre pronave.

Me këtë gjendje të mos kthimit të pronës pronarëve legjitimë shkelet Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, ku në nenin 1 të Protokollit 1 parashihet e drejta për t'i gëzuar pronat vetjake.

Në bazë të propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, Aneksi 7 - Prona dhe arkivi, neni 2, paragrafi 2.3 thuhet, citoj:

“Anëtarët ndërkombëtar të Bordit të drejtorëve kanë kompetenca, që duke vepruar bashkërisht dhe unanimisht, të pezullojnë vendimin e institucionit pasardhës të AKM-ës nëse ata gjejnë se një vendim i tillë është në kundërshtim me parimet e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe protokolleve të saj dhe ligjin në fuqi, dhe çështjen t’ia drejtojnë Dhomës së Posaçme pranë Gjykatës Supreme për të marrë vendim.

Për raste të tilla, Dhoma e Posaçme vendosë me urgjencë”.

Përveç nxjerrjes së Ligjit për kthimin e pronave, duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe atë në drejtim të përjashtimit të pronave të nacionalizuara nga privatizimi deri sa nuk krijohet baza ligjore për kthimin e tyre. Kërkoj që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vesna Nikiq.

VESNA NIKIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi poslanici,

Dame i gospodo,

Prošlo je 12 godina od sukoba na Kosovu a položaj Srpske zajednice se nije u mnogome poboljšalo.

Da je to tako, govore hapšenja prošle nedelje gde su pripadnici ROSU – specijalci na razbojnički način upali u kuće i uz neviđeno demonstriranje sile priveli šestoricu ljudi, čiji je greh jedini što 12 godina svakodnevno putuju do Vranja i na taj način obezbeđuju egzistenciju svojoj porodici.

Prilikom hapšenja, specijalci naoružani do zuba sa patkama na glavama pribegli su i opaskama tipa psovanja srpske majke, govoreći da Srbima nije mesto na Kosovu već da im je mesto u Srbiji.

U početku sam mislila da je to refleksija nezadovoljstva dela srpske vlade i dela institucija, koji je došao kao produkt pregovora između Albanaca i Srba u Briselu, ali očigledno sam se prevarila, jer smo kasnije saznali da je to zapravo produkt cinkarenja ljudi koji su došli na vlast i na opštinskim nivoima sa podebelim kriminalnim dosijeom.

To je samo dokaz koliko zakoni funkcionišu na Kosovu i ko sve može da dođe na visoko političko mesto, na visoki politički položaj.

Uhapšenima se stavlja na teret da su počinili napad na ustavni poredak Kosova i da su pribegli suprotstavljanju u vršenju dužnosti. Međutim to nije istina, jer u jutarnjim časovima ne verujem da su maloletna deca i žene i pospani ljudi mogu da pruže otpor.

Ako je gospodo kršenje ustavnog poretka to što ljudi obavljaju svakodnevno svoj posao, onda vas ja pitam da li je kršenje ustavnog poretka to što je milion Albanaca na Kosovu ima biometrijske pasoše i lične karte Republike Srbije i što u ovoj Skupštini danas među nama stoje visoki politički činovnici koji su prekršili Ustav države Kosova, uzimajući pasoše.

Ja svakoga trenutka očekujem imena da mi stignu e-mailom svih onih koji imaju pasoše, izvode i lične karte i to u prethodnoj godini.

Ja ću se obratiti na konferenciju za štampu i dati sva ta imena i zatražiti od pripadnika ROSU i Ministarstvu unutrašnjih poslova da primene istu torturu koji su primenili prilikom hapšenja nedužnih ljudi.

Da bude još gore, uhapšenima nije dozvoljena poseta porodice, niti poseta narodnog advokata i mi smo zatražili danas prijem kod obudsmara da nam objasni iz kojih razloga nije to sve dozvoljeno. Da li je to još jedan način prikrivanja fizičkog zlostavljanja policijskih pripadnika? Hvala!

KRYETARI: Deputetët, duhet të kërkojnë respektimin e rendit dhe të ligjit. Fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsedniče!

Poštovani poslanici,

Članovi Vlade,

Tragedija koja se nedavno desila u Restelici, u opštini Dragaš treba da nam posluži kao velika pouka.

Nedavno, u jednoj TV emisiji vezano za tragediju u Restelici neko je rekao: „Da je Republika Kosovo nova država i da nema dovoljno iskustva u ovakvim i sličnim nepogodama“. Međutim, ovo nije dovoljan argumenat da bi država Kosovo čekala da stekne iskustvo kroz ovakva i slične tragedije koje se odnose na ljudski život.

Upravo zbog potrebe preventivnog djelovanja za sprečavanje ovakvih i sličnih tragedija na koje može da utiče ljudski faktor, snažno pokrećemo inicijativu za sređivanje kamene Bistrijske klisure, Duv na regionalnom putu Prizren-Rečane, put koji vodi prema Prevalcu, Brezovici pa čak i do susjednoj državi Makedoniji odnosno Skoplje.

Ovo je kao što se zna putni pravac gde je prisutna velika cirkulacija u saobraćaju. Naime, veliki dio stanovništva grada Prizren a zasebno 15 sela u Župi svakodnevno je upućeno samo na ovaj pravac u komunikaciji s Kosovom. Ovaj putni pravac u dužini od nekoliko kilometara u Bistrijskoj klisuri i niže nje, pored reke Bistrice izložen je svakodnevnom odronu kamena od velikih stena koje su porozne i sklone raspadanju po gotovo posle odmrzavanja.

Zbog toga je, ne mali broj incidenata i troškova od oštećenja po saobraćajnim sredstvima a često se dogodi da putnici u njima budu i povređeni.

S obzirom na vremenske neprilike ove godine, taj putni pravac je pod velikim rizikom od rušenja stena a posledice mogu biti tragične i za život ljudi.

Također, da napomenem da ovaj putni pravac svakodnevno koriste učenici srednjih škola iz pomenutih 15 sela Župe koja nastavu pohađaju u Prizrenu.

Pored toga što i vi, uvaženi poslanici, možete potvrditi veliki rizik putovanja ovim pravcem, to mogu da potvrde i mnogi građani Kosova koji su imali priliku da prođu ovim dijelom puta, a to mogu posvedočiti i sva školska djeca celog Kosova koji autobusima prolaze ovom maršutom tokom izvođenja ekskurzije po Kosovu.

Ovo mogu potvrditi i Kosovska osiguravajuća društva koja imaju brojne zahteve za nadoknadu štete za oštećenje vozila a još bolje se može uveriti o kom se riziku radi, tako da KFOR zabranio...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën. Tre minuta janë në dispozicion.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar,
Emni e thotë esencën. Kosova Republikë, është esenca. Nofka e thotë mungesën. Në këto raste nofka, duke e thënë mungesën pretendon të bëhet cilësi. E kjo i bie pak a shumë sikur njerëzve kur i thonë me nofkë: qorri, shurdha, çeli. Kjo s'do të thotë se ata janë përnjëmend qorra, shurdhanë dhe çela, por mungesa e tyre do të bëhet esencë – emër.

Ne e kemi një problem të madh, i cili duhet të diskutohet në Parlament dhe unë besoj se kjo duhet të diskutohet në Parlament, mirëpo pa kryeaktorin nuk duhet, sepse kryeministri ynë botërisht dhe publikisht e ka marrë mbi vete autorësinë e kësaj. Dhe, e mirë e keqe, autorësia është e tij sepse ai e ka deklaruar.

Mirëpo, problemi s'është veç i tij, prandaj duhet të kalojë në institucione dhe të mos diskutohet në biseda të lira qytetare para se në institucione.

Kjo polli edhe një raport, një diskurs publik institucional e qytetar, kush është me Amerikën e me Evropën e kush nuk është. Dhe mua mu dukte se ajo parulla e vjetër Amerika e Evropa kanë me u bë proletarë si ne. Kjo është parullë e vjetër. E reja i bie përafërsisht: na i duam shumë ata dhe do të martohemi me ta për letra. Kjo është moderne. Martesa për letra s'ka në politikë dhe është qesharake e është fatale, por ka marrëdhënie në kuptimin e vërtetë marrje dhe dhënie, edhe me miq edhe me ata që janë më pak miq.

Ky diskurs nuk guxon të kthehet në diskurs politik të likuidimit, qysh ka ndodhur këtu, nga kushdoqoftë. Dhe, këtë leksion duhet ta marrë gjithkush i cili pretendon se flenë në një çadër me elefantin. Le t'ia japë leksionin këtij që s'ka fjet. Atëherë le të bëhen konkretë dhe le të flasin.

Dhe unë, dua vetëm ta përfundoj edhe me një fjalë latine: Quod licet iovi, non licet bovi. Nuk e përkthej shqip se ata që dinë, e dinë çka është kjo. Ndërsa, po e them latinisht se latinët kanë qenë antikë, mjeshtër të drejtësisë. Anglisht s'kanë ditur. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe pse e kemi tejkaluar kohën, për shkak të një gabimi që e kam bërë më herët, tash në emër të SLS dhe për Grupin e SLS, fjalën e ka kërkuar deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala predsedniče!

Uvaženi predsedniče Skupštine,
Članovi Vlade,

Ja u ovom trenutku govorim u svoje ime. Ne u ime SLS, mada se zahvaljujem što ste mi dali reč. Ja sam se uredno prijavio, međutim izgleda da je bila neka greška tehničke prirode.

Povod mog obraćanja Skupštini je nedavni tragični događaj porodice Reka u Restelici. Pričalo se nadugačko i naširoko o tom događaju, međutim posle neke informacije koje su u javnosti plasirane i u to vreme i nakon toga, a odnose na to ko je tražio pomoć, ko je vratio pomoć, i tako dalje, i tako dalje, pa sve te priče stvore nejasnu sliku u svemu ovome a samim tim i stvaraju nepotrebnu tenziju i nelagodnosti među ljudima ne samo u Gori već i šire.

Politička Partija Građanska inicijativa Gore kao odgovoran politički subjekt i subjekt koja participira u vlasti i institucijama Kosova i Goranska zajednica koja zastupa GIK je u celoj ovoj situaciji i u celom ovom događaju tragičnom bila neutralna, jednostavno mi smo pokušali da pružimo pomoć pojedinačno, onako kako ljudski to zahteva.

Međutim, želeo bih da sa ove govornice odgovorno kažem da naša Partija i naša zajednica koja zastupamo, znači Goranska zajednica na Kosovu, niti je imala mandat niti je imala zahtev da traži bilo kakvu pomoć i da takvu pomoć neko vraća ili ne prihvata.

Međutim, primarni razlog mog obraćanja Skupštini je ozbiljnije prirode, i radi se o sledećem:

Ja bih želeo da ponudim jedan predlog, jedan dobar projekat mapiranja krizinih i kritičnih područja na Kosovu. Dakle, radi se ne samo o lavinama, što je i kolega Demiri nešto govorio o tome kratko. Znači, postoje dosta poplavnih područja na Kosovu, dosta klizišta, dosta lavina, dosta odrona kamenja na putevima i sve to može da prouzrokuje opasnu veliku štetu, ali najveću štetu i najveći gubitak i ljudski život.

Ja znam da je ovaj projekat veoma skup i veoma zahtevan, ali mislim da se od nečega mora poći. Mislim da međunarodna zajednica isto može pomoći u celoj ovoj priči i u realizaciji ovog projekta, pa pozivam institucije i nadležna ministarstva i organe da krenu u celu ovu priču mapiranja kritičnih područja. Dolazeći ovamo, kod Lipljana već je izlivena velika količina vode i poplavila je dosta prostora i porodičnih kuća. Znači...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë e kemi përfunduar kohën për deklarime jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuar, për diçka tjetër, deputeti Visar Ymeri. Urdhëro, Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm desha që në emër të Grupit Parlamentar, natyrisht edhe të Lëvizjes Vetëvendosje t'i shprehë ngushëllimet më të sinqerta familjeve, po edhe shqiptarëve kudo që janë, për vrasjen e Besnik Shehazit dhe Imran Mehmetit në Gostivar, nga polici maqedonas.

Ne nuk e konsiderojmë këtë të jetë vetëm një incident i ndarë nga zhvillimet politike atje. Konsiderojmë, që krimi i djeshëm në Gostivar është rezultat direkt i mendësisë shtypëse në linjat e diskriminimit etnik, që po ndërton Gruevski me të gjitha mjetet e veta shtetërore e propagandistike, një mendësi kjo, që shqiptarët i sheh vetëm si instanca të domosdoshme, me të cilat hyn në shitblerje për të marrë e për të forcuar pushtetin e vet,

por nuk i sheh si qytetarë të barabartë, nuk i sheh si komunitet me të drejta historike, ekonomike, kulturore e kombëtare.

Po ashtu, konsiderojmë që institucionet politike e shtetërore në Prishtinë e Tiranë, nuk guxojnë të rrinë duarkryq e të shikojnë nga anash atë që po u ndodh shqiptarëve në Maqedoni. Është e domosdoshme që Shqipëria dhe Kosova bashkë dhe të koordinuara tu dalin në ndihmë shqiptarëve kudo që jetojnë dhe për çkado që kanë nevojë. Faleminderit, edhe njëherë!

KRYETARI: Faleminderit!

Ndonjë kërkesë tjetër? Nuk ka! Shkojmë në pikën e dytë të rendit të ditës,

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve. Për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund t'i parashtojë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Fjalën e ka për pyetje deputetja Donika Kadaj – Bujupi për ministrin Besim Beqaj.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pyetja për ministrin: pas kalimit të gjitha afateve të parapara për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, së fundi ju dolët me disa përfundime që në vitin 2017 do të ketë diçka nga ky projekt, ndërkohë që Qeveria Thaçi ia humbi mundësinë Kosovës që të pozicionohet në mesin e shteteve të cilat janë faktorë energjetik në Ballkan dhe rrjedhimisht do bëheshim edhe faktorë politik. Pse e keni bërë këtë, ministër? Cilat kanë qenë arsyet?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuari, kryetar i Parlamentit!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Projekti për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” është në fazën përfundimtare. Është një projekt i cili ka filluar me vite të diskutohet, por asnjëherë nuk është bërë punë konkrete e cila do t'i paraprinte një analize serioze dhe një vlerësimi studioz të një procedure për ndërtimet dhe kapacitetet të reja dhe nuk është marrë përkrahja e duhur e cila do të duhej të siguronte furnizim të rregullt me energji elektrike.

Po ju them këtë me kompetencë, sepse i kam analizuar të gjitha dokumentet që i kanë bërë të gjithë akterët paraprak dhe na u ka dashur shumë punë për ta ristrukturuar këtë projekt, për të marrë përkrahjen nga Bashkimi Evropian, për të marrë përkrahjen nga Banka Botërore, për të krijuar dokumentet të cilat do të qëndrojnë me vite të tëra dhe në bazë të kësaj të kemi një projekt i cili do t'ju mundësonte qytetarëve 3 gjëra themelore, dhe ato janë prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës: furnizimi i rregullt dhe i sigurt me energji elektrike, me energji elektrike e cila do të jetë e mundshme për tu

paguar nga qytetarët e vendit dhe energji elektrike e cila do t'i respekton standardet më të larta në aspektin mjedisor dhe nuk do ta cenon shëndetin publik të qytetarëve tonë.

Thash që të gjitha përgatitjet janë bërë dhe brenda këtij muaji, shumë shpejtë, do të shpallet tenderi dhe do të procedohet me procedura të rregullta të cilat janë, po e them edhe njëherë konform standardeve më të larta.

Ju në pyetjen tuaj keni thënë edhe për resurset, që kemi degradim të resurseve. Nuk ka degradim të resurseve atëherë kur resurset kujdesen në mënyrë maksimale nga institucionet, atëherë kur resurset përkundër vlerave minore të cilat kanë qenë të përcaktuara me tontien tantieme 0,26 euro për ton, atëherë kur Qeveria merr vendim që kjo tantieme të jetë 3 euro për ton, po ky është një valorizim ekonomik i resursit dhe është një vlerësim i resurseve natyrore të Kosovës, sepse po propagandohet dhe po thuhet që po shiten resurset pa valorizime. Pra, kemi valorizim të plotë ekonomik konform të gjitha rregullave, pra konform interesit publik të qytetarëve.

Dhe, në pyetjen tuaj keni thënë që ka prapaskena. Proceset transparente konform rregullave standarde dhe ndërkombëtare, nuk kanë asnjë lloj prapaskene, por kanë vetëm përkushtim maksimal për transaksion të suksesshëm, transaksion i cili ndodh njëherë në 30 a 40 vjet dhe ajo çka është jashtëzakonisht e rëndësishme është se ato procese që janë përcaktuar deri më tani janë harmonizuar me të gjithë akterët. Ju, së fundi keni parë që edhe Banka Botërore ka dalë me dy studimet themelore dhe ka përcaktuar se janë plotësuar të gjitha standardet të cilat janë konform këtyre. Ndërsa, sa i përket shtyrjes në vitin 2017.....

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendi,t zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Regjia, Deputetes Kada fjalën!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Që s'keni lidhje në ekonomi tregojnë barrierat ekonomike nga politikat e juaja, tregon korrupsioni në shkallën shumë të lartë. Se për çka jeni përkushtuar tregon fakti që në 4 vjetët e fundit, sepse projekti i Termocentralit Kosova e Re ka qenë i gatshëm në përfundim të vitit 2007, mirëpo ju jeni përkushtuar me ia ndërruar emrin, jeni përkushtuar me bashkëpunuar me kompaninë në kuptimin korruptiv të cilat i keni larguar nga Kosova. Të gjitha kompanitë serioze janë larguar nga Kosova, sepse ato nuk eksportojnë korrupsion.

Sot merreni me kompanitë e dyshimta me të cilat ju si Qeveri në konceptet e juaja mund të bashkëpunoni, ndërkohë që Kosovën dhe qytetarët e saj po vazhdoni me i lënë në terr, po e rritni prapë çmimin e energjisë elektrike dhe po vazhdoni me fol si OJQ.

Ne po ju shohim në vazhdimësi që në tryezat e organizuara që kushtojnë shumë shtrenjtë ju në vazhdimësi deklaroni: “duhet të ndodh kjo” dhe: “duhet të ndodh ajo”, por po

harroni që pikërisht ju - Qeveria duhet t'i bëjë këto. Është vështirë me besuar se mundeni, sepse ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Më duket që nuk ishte pyetje. Është më shumë koment dhe mendoj që për çështje debati mund të organizojmë debat, por nuk është mirë që vetëm të fyhemi, vetëm të flasim pa argumente. Zoti Beqaj, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Sa i përket, se a pretendoj të jem ekonomist, jam ekonomist dhe mund të jap leksione në fushën e ekonomisë dhe në realizim të projekteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Po e shpenzojmë edhe pyetjen e dytë të deputetes Kadaj, sa jemi te nxehtë. Vazhdoni, prapë pyetje për ministrin Beqaj.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Po. Keni folur shumë për këtë "planin e Banjskas". A mundeni me na treguar se sa vende pune janë arritur me u krijuar pas realizimit të këtij plani ose pjesërisht të realizuar? Sa vende pune, në cilat komuna, në cilët sektorë? Shumë konkret. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Plani për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, i cili është hartuar vitin e kaluar, është një ndër planet më të avancuara për zhvillim ekonomik. Jo planet qysh njerëzit janë mësuar t'i shohin me nga 500-600 faqe plane vetëm në letër për të shkruar, siç janë shkruar edhe më herët. Dhe, në këtë kontekst, janë përcaktuar mekanizma të matshëm, të cilët po mundësohen dhe po jetësohen në baza të përditshme.

Ky plan ka paraparë që të reduktohet e tërë burokracia e mundshme dhe këtu kemi mjaft të arritura, të cilat po realizohen dhe po shpjegohen për qytetarët dhe për bizneset, në mënyrë të përditshme. Njëkohësisht, projektet për të cilat po flasim, qoftë në infrastrukturë, qoftë në energji, qoftë në bujqësi, qoftë në ndarje të buxheteve shtesë për t'i përkrahur këto, janë në vijim e sipër dhe jam jashtëzakonisht i kënaqur, sepse këto procese janë duke u përkrahur nga të gjitha institucionet vendore, duke përfshirë këtu edhe komunat. Ndërsa, për shifra duhet të orientoheni drejtë statistikave, t'i shihni se cilat janë shifrat e sakta, sepse unë nuk merrem me shifra. Ministri nuk merret me shifra. Ministri merret me politika, të cilat janë për zhvillim ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetja Kadaj e ka fjalën!

DONIKA KADAJ BUJUPI: Nuk e vë në dyshim që je i kënaqur. Por, pyeti qytetarët e Kosovës a janë të kënaqur.

Inflacion zinxhiror keni mbi 20% pas këtij plani, keni 400.000 kredi të 300.000 familjeve në Kosovë. 70% të familjeve të cilat ose janë të papunë ose janë të punësuar në sektorin privat vuajnë nga rritja e çmimeve që kanë ndodhë në vitin e fundit pas këtij plani famoz dhe 50.000 biznese nga 90.000 gjithsej - janë joaktive apo janë shuar pas këtij plani famoz. Dhe, nëse kjo është për tu kënaqur, kënaquni. Por pyetni qytetarët e Kosovës a janë ata të kënaqur.

KRYESUESI: Fjalën e ka, Beqaj?

MINISTRI BESIM BEQAJ: Për hir të korrektësisë, zonja deputete, qytetarët e Kosovës në aspektin e kredidhënies janë qytetarë që më së paku kanë kredi, jo vetëm në rajon por edhe më gjerë.

Borxhi publik i Kosovës është më pak se 6% nga GDP-ia. Për të shtuar më shumë, se ky projekt i borxheve dhe makro-stabilitetit financiar po ju shqetëson, është evidente, për shkak se kemi pas një politikë mjaft konzervative në trajtimin e situatës, kur vendet tjera po falimentojnë. Pra, vende të fuqishme ekonomike po falimentojnë, ndërsa ne kemi arritur që me këtë plan të realizojmë edhe punësime, të realizojmë edhe rritje të pagave për të gjithë mësimdhënësit dhe për të gjitha strukturat tjera por njëkohësisht duke krijuar infrastrukturë të mirëfilltë për zhvillim ekonomik, dhe sigurisht që dikush do të dëshironte të gjendej në këto pozita për të dhënë lajme të mira qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë! Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministër, tash vonë është aprovuar Statuti i QKUK-ës, ku ju jeni thirr se me këtë statut po bëni reforma shumë pozitive për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Statuti i aprovuar a nuk iu përshtat boll grupeve të interesit dhe u deshtë që pas dy muajve përsëri me filluar me plotësim-ndryshim? E tash, kujt po ia përshtatni? Me këtë po krijoni privilegje dhe monopole ligjore.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë e deputete,

E nderuar zonja deputete,

Statuti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nuk është ndryshuar prej viti 2007 mu për shkak të konflikteve të këtyre grupeve të interesit, të cilat po i përmendni.

Gjatë mandatit tim kam qenë i përkushtuar që këtë situatë ta ndryshojmë dhe ta biem në vijën e reformave të përgjithshme në sistemin shëndetësor. Dhe, këtë e kemi bërë në

pajtim me ligjin, nëpërmjet iniciativës që e ka bërë drejtori i Qendrës Klinike Universitare për ndryshimin e Statutit.

Pas fillimit të zbatimit të këtij statuti, konkretisht më rastin e përzgjedhjes së drejtorëve të klinikave të Qendrës Klinike Universitare është parë se ka mungesa në këtë aspekt dhe prapë, në pajtim me ligjin, me iniciativën ligjore të drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, kemi hyrë në procesin e draftimit të statutit të ri me qëllim që t'i plotësojmë këto mungesa.

Unë, me qëllim të realizimit me një sukses të plotë të këtij synimi, e kam iniciuar një proces konsultativ, në të cilin kanë qenë të përfshirë të gjithë faktorët vendimmarrës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, përfshirë Fakultetin e Mjekësisë, Universitetin e Prishtinës, Ministrinë e Arsimit, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës e natyrisht edhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Si rezultat i këtij procesi konsultativ kemi, ardhur deri të drafti konsensual i Statutit të ri të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i cili do t'i dorëzohet, që sot, kësaj qendre për procedura të mëtutjeshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë! Regjia, fjalën Deputetes Kadriaj!

TIME KADRIJAJ: Ministër! Po ky draft i statutit prapë po kundërshtohet nga 172 specialistë, të cilët e kanë shkruar një petition dhe të cilët nuk janë të kënaqur me nenin 23, i cili nen po iu krijon privilegje një kategorie të caktuar të profesionistëve, ndërsa po e anashkalon një kategori tjetër të profesionistëve. A mundeni me na e shpjegua këtë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Konkretisht bëhet fjalë për këto kategori të profesionistëve, që po thoni, bëhet fjalë për nën thonjëza të themi "privilegjim" e punëtorëve shëndetësorë, specialistëve të lëmive përkatëse, që janë profesorë në Fakultetin e Mjekësisë dhe të specialistëve të lëmive përkatëse, që nuk janë staf i Fakultetit të Mjekësisë e që punojnë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Është ky një problem tejet serioz, për të cilin unë kam qenë shumë koshient dhe të cilin jam munduar që ta tejkaloj. Unë e kam pranuar grupin e specialistëve, të cilët e kanë nënshkruar atë petition kemi bashkëbiseduar dhe pas kësaj bisede kam organizuar edhe mbledhjen e veçantë të Komisionit, i cili ka punuar në draftimin e statutit dhe kjo zgjidhje konsensuale të cilën e përmenda është rezultat i këtyre bisedave dhe i nënkupton edhe sugjerimet e grupit të specialistëve dhe kërkesat e tyre dhe unë shpresoj që në procedurën e mëtutjeshme, kjo zgjidhje do të mirëpritet edhe nga ana e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi dy pyetje për ministrin Stavileci. Deputetja Valbona Dibra, pyetje për ministrin Stavileci.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural, që u aprovua në parim disa javë më parë, parashihet themelimi i Agjencionit kosovar për bujqësi dhe zhvillim rural si organizatë buxhetore nën ombrellën e ministrisë. Përveç kompetencave të cekura me ligj, çfarë roli ka themelimi i këtij agjencioni në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Valbona Dibra, ju falënderoj për pyetjen!

Më lejoni të ju përgjigjem!

Vendet që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian dhe vendet që janë candidate potenciale, janë të obliguara që të nënshkruajnë marrëveshje me Komisionin Evropian për rregullat e bashkëpunimit lidhur me përkrahjen financiare dhe me përpjekjet e tyre për përmirësimin e reformave politike, ekonomike dhe institucionale për t'iu ndihmuar nga Komisioni Evropian që të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian.

Duke marrë parasysh specifikat e Programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vendet që janë pjesë e politikave të përbashkëta bujqësore, pjesë e të cilave është edhe Kosova, janë të obliguara që të themelojnë strukturat e nevojshme administrative dhe një prej këtyre është edhe Agjencia e pagesave si përgjegjëse për implementimin e Programit dhe politikave, të cilën ne në Kosovë e kemi emërtuar si Agjenci për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Themelimi i këtyre strukturave me përgjegjësi të ndara, bëhet për shumë arsye. Por, më kryesoret janë: largimi i konfliktit të interesit, ku hartuesit e Programit assesi nuk duhet të jenë edhe implementues të tij, pastaj menaxhimi më i mirë dhe më transparent i Programit dhe njëra nga më të rëndësishmet - absorbimi i fondeve strukturore të IPARD-it.

Krijimi i kësaj Agjencie, për momentin nuk ka kosto shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi që njësia për pagesa e krijuar brenda Ministrisë do të kalojë drejtpërdrejtë në këtë agjenci, mirëpo, kuptohet që operacionalizimi dhe akreditimi i plotë i këtyre strukturave të reja kërkon kohë, burime njerëzore dhe burime financiare.

Vonesa në themelimin e këtyre strukturave - disa vendeve iu ka kushtuar me kufizime të mëdha në absorbimin e fondeve strukturore, që u vie në dispozicion shteteve në fazën e para anëtarësimit, por tani të gjitha shtetet candidate dhe ato candidate potenciale, i kanë të krijuara këto struktura.

Në proces të krijimit të tyre jemi edhe ne dhe siç po nënkuptohet, pasi t'i krijojmë këto, do të mund të absorbojmë nivele më të mëdha të fondeve nga Bashkimi Evropian.

Përndryshe, mosekzistimi i tyre nënkupton edhe mos absorbim të këtyre fondeve dhe, për më tepër, ne aktualisht si rezultat i krijimit dhe ekzistimit të tyre, në periudhën e ardhshme pesëvjeçare kemi siguruar një mbështetje të jashtme buxhetore deri në 15.000.000, të cilat do të jenë më së shumti në formën e granteve për agrobizneset dhe fermerët e vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Nuk ka!

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, pyetje për ministrin Stavileci. Deputete?

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryesues!

Të gjithë qytetarët e Kosovës e kanë përjetuar me dhimbje fatkeqësinë natyrore në fshatin Restelicë. Stina e dimrit dhe bora qytetarëve të komunës së Dragashit duhet t'u sjellë gëzim, duhet t'u sjellë turistë dhe të ardhura, për shkak se ekzistojnë resurse të mrekullueshme natyrore, e jo t'u sjellë frikë, fatkeqësi dhe tragjedi.

Prandaj, për t'i ikur apo për të evituar fatkeqësi të tilla natyrore, gjatë bisedës me qytetarët e komunës së Dragashit ata më thonë se i kanë të hartuara disa projekte për fshatrat e tyre, si për shembull - ekziston një projekt për pyllëzimin e zonës, që e shkaktoi rënien e orteqeve të borës, vetëm se u ka munguar ndihma financiare dhe mbështetja institucionale.

Duke marrë shkas nga kjo fatkeqësi natyrore, ia parashtroj pyetjen ministrit të Bujqësisë Blerand Stavileci:

I nderuar zoti ministër: Sa është në gjendje Ministria e Bujqësisë të përkrahë Projektin për pyllëzimin e zonës së fshatit Restelicë, aty ku ranë edhe orteqet e borës dhe shkaktuan fatkeqësi natyrore të ditëve të kaluara, që tronditi tërë qytetarët e Kosovës?

KRYESUESI: Zoti ministër?

BLERAND STAVILECI: Faleminderit edhe njëherë!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete, zonja Berisha-Shaqiri,

Fatkeqësia natyrore në fshatin Restelicë ishte një tragjedi, që na ka shokuar të gjithëve dhe njëherësh shumëkënd prej nesh e ka bërë të kuptojë se sa të pafuqishëm jemi përballë faktorëve të ndryshëm klimatik.

Megjithatë, mendojmë se ka veprime të ndryshme, me të cilat shpeshherë mund të parandalohen ato, apo të jenë me më pak vuajtje për qytetarët e vendit tonë.

Ne, si Ministri e Bujqësisë, iu kemi përgjigjur kërkesave të Komisionit komunal për emergjenca dhe komunës së Dragashit, duke iu dalë në ndihmë edhe në të kaluarën, por edhe ne fatkeqësinë e fundit në Restelicë, përkatësisht në kërkesën e tyre për të ndihmuar fermerët e fshatit me ushqime voluminoze dhe të koncentruara për bagëtinë, të cilat është dashur ta evakuojnë në mes të fshatit për shkak të rrezikut nga orteqet e tjerë të borës.

Për t'ju përgjigjur në mënyrë konkrete pyetjes tuaj, përkatësisht projektit të cilit i jeni referuar për pyllëzimin e zonës së fshatit Restelicë dhe mungesës së përkrahjes institucionale, ju njoftoj se ne si Ministri asnjëherë nuk na është prezantuar ky projekt dhe nuk na është bërë kërkesa për të financuar.

Ministria i ka bërë pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura në këtë fshat dhe ka tentuar të bëjë pyllëzime në kontinuitet, sepse ka qenë dhe është evident rreziku nga erozioni, por vazhdimisht është hasur në pakënaqësi të fermerëve të fshatit, të cilët kanë numër të madh dhe kope të shumta të bagëtisë.

Pakënaqësitë e tyre kanë qenë pikërisht për shkak se terrenet e parapara për pyllëzime janë menjëherë mbi fshat dhe po qe se ato pyllëzohen do tua pengonin atyre kullotjen e lirë të bagëtisë.

Madje, që nga viti 2004 e kënde, dy herë janë pyllëzuar disa sipërfaqe të vogla, por për arsye të dëmtimeve nga bagëtia - zhvillimi i fidanëve nuk ka pasur sukses. Ndërsa tani, para se të ndodh fatkeqësia natyrore në Restelicë, nga Agjencioni pyjor lokal është prezantuar si prioritet pyllëzimi i një sipërfaqeje prej 7 hektarëve në ngastrën numër 30 në fshatin Restelicë dhe ne e kemi aprovuar këtë prioritet dhe e kemi futur tek sipërfaqet që planifikohen të pyllëzohen gjatë këtij viti.

Por, nëse banorët e fshatit Restelicë kanë edhe projekte të tjera për pyllëzime ose janë të interesuar për rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara, ne jemi të gatshëm tua sigurojmë të gjithë materialin e nevojshëm fidanor për të gjitha sipërfaqet që ata duan t'i pyllëzojnë. Mirëpo, duhet potencuar se rreziku i mos zhvillimit të fidanëve për shkak të mos mbrojtjes nga bagëtia dhe për shkak të lartësisë mbidetare e cila shkon deri në 1.500 metra, është përsëri shumë i madh, sepse kjo lartësi për shkak që i ekspozohet erërave të fuqishme, nuk garanton sukses tek mbjellja e tyre dhe, për shkak të kushteve fitoklimatike të papërshtatshme, zhvillohen me shumë vështirësi në këtë terren. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fiks ke qenë, 3 minuta. Pyetje shtesë? Regjia, deputetes Berisha fjalën!

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, ministër!

Unë sa kuptova Ministria e juaj është në gjendje tu ndihmojë qytetarëve të Restelicës, prandaj projektet nëse nuk i kanë sjell deri më tani, do t'ua sjellin. Jam e sigurt!

Edhe diçka tjetër desha me këtë rast. Bora, ka shkaktuar dëme materiale edhe në shumë komuna të tjera, jo vetëm në Restelicë dhe janë evidentuar dëme materiale, si në: Suharekë, Rahovec, Istog, Malishevë e vende të tjera, e sidomos dëmet më të mëdha iu janë shkaktuar fermerëve, pyjeve dhe serrave që merren me kultivimin e perimeve të hershme.

Prandaj, i nderuari zoti ministër, çfarë ka bërë Ministria e Bujqësisë, respektivisht cilat kanë qenë aktivitetet e Ministrisë tuaj për ta sanuar këtë gjendje emergjente, apo edhe

cilat do të jenë aktivitetet në të ardhmen? Nëse nuk keni bërë, ose çfarë e keni bërë konkretisht, na jepni informacion.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

Edhe pse nuk është pjesë e pyetjes, por nuk ka problem dhe për hir të transparencës dhe informimit korrekt dhe të saktë ju e dini që ne gjatë gjithë kësaj periudhe, por edhe në vitin e kaluar e vitet e tjera, që besoj se i keni parë edhe angazhimet tona, e kemi ndihmuar pjesën më të madhe të fermerëve, të cilëve u janë shkaktuar dëme edhe pse jo në nivelin maksimal të dëshirueshëm nga ana e tyre. Dhe, edhe sivjet ne së bashku me ekipet komunale kemi bërë evidentimin e tyre me komisionet që ne i kemi dhe besoj që në periudhën e ardhshme të gjitha ata do t'i informojmë për mënyrën se si do të mund t'iu ndihmojmë.

Natyrisht që ju e dini, ne do të kemi edhe një proces tjetër të rishikimit buxhetor, ku besoj se ato do t'i marrim parasysh. Mirëpo, ajo çfarë unë iu them në vazhdimësi fermerëve edhe në këtë rast, por edhe në rastet e tjera, është se përveç kësaj ne do të duhet ta kemi një fond të veçantë për këto fatkeqësi, sidomos për ato të cilat i shkaktajnë dëme të drejtpërdrejta komunitetit fermer të vendit tonë, po dhe të nisim shumë shpejtë për të menduar për një iniciativë të sigurimit të kulturave bujqësore dhe të këtyre objekteve dhe pajisjeve që ata i kanë në rast të dëmtimit nga fatkeqësitë natyrore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është një pyetje për ministrin Jagcilar. Deputetja Kimete Bytyqi e bën pyetjen.

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Duke e ditur mandatin e Ministrisë, të cilën e drejtoni ju, kërkoj nga ana juaj, zoti ministër, të më përgjigjeni në pyetjen si në vijim:

Sa është e përfaqësuar gjinia femërore në shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe, në këtë kuptim, a është arritur kriteri i barazisë gjinore i përcaktuar me Ligjin për barazi gjinore?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën? Tre minuta i keni, Mahir!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Zonja deputete,

Duke ju falënderuar për pyetjen, ju informoj se sipas Ligjit për barazi gjinore, duke u bazuar në nenin 3, paragrafit 1 barazia arrihet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40%.

Ndërsa, sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, ju informoj se në administratën qendrore dhe lokale pjesëmarrja e gjinisë femërore në shërbimin civil, sipas statistikave është 67,23% për gjininë mashkullore, ndërsa 32,77% të gjinisë femërore, prej totalit nga 40.531 nëpunës civil.

Ndërsa, vetëm në administratën e nivelit qendror, pjesëmarrja është 36,12%, kurse në administratën e nivelit lokal pjesëmarrja është më e ultë, ose 22,69% e gjinisë femërore.

Duke u bazuar në të dhënat e shërbimit civil, janë grumbulluar të dhënat statistikore për strukturën etnike, gjinore dhe pozitat vendimmarrëse. Në çështjen e barazisë gjinore në nivelin e përgjithshëm për të dy nivelet, qendror dhe lokal, është shënuar rritje 0,5% në pjesëmarrjen e gjinisë femërore në administratë, kurse në pozitat udhëheqëse në vendimmarrje, të nivelit menaxherial, në çështjen gjinore, në pjesëmarrjen e gjinisë femërore është arritur 3.08%. Ndërsa, në nivelin drejtues në strukturën gjinore, në pjesëmarrjen e gjinisë femërore ka rritje 0,69%.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetja Bytyqi, e ka fjalën!

KIMETE BYTYQI: Zoti ministër,

Çka do të bëni ju në këtë drejtim që ta ngrisni domethënë, numrin e barazisë gjinore nëpër vendet udhëheqëse?

KRYESUESI: Ministrit fjalën, ju lutem!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit!

Sigurisht, kjo është çështje e të gjitha institucioneve edhe qendrore edhe lokale, sipas ligjit për barazi gjinore. Por, Ministria e Administratës Publike, promovon barazinë gjinore në infrastrukturën ligjore edhe nga aspekti i ligjeve dhe akteve nënligjore, kurse edhe përmes institutit të Administratës Publike ne jemi duke e promovuar edhe Ligjin kundër diskriminimit por, gjithashtu edhe Ligjin për barazinë gjinore. Ndërsa, prapë për t'i rritur statistikën ose numrat, duhet të punojmë të gjithë.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me 6 pyetjet që janë për kryeministrin. Më duhet t'ju sqaroj që në seancën e kaluar janë lexuar të gjashtë pyetjet. Pra, kanë qenë për t'u trajtuar të gjashtë pyetjet, e në mungesë të kryeministrit, disa janë lexuar disa s'janë lexuar.

Sipas Rregullores, deputetët mund t'i lexojnë pyetjet prapë, por pas seancës së sotme këto pyetje bien nga rendi i ditës. Domethënë, në seancën e ardhshme, nuk mund të jenë, përveç nëse përsëriten. Por, do të botohen në Buletinin e Parlamentit.

Pyetjen e parë, e ka kryetari i Grupit, zoti Ymeri për kryeministrin Hashim Thaçi. Doni ta lexoni pyetjen? Zotit Ymeri, fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Pra, siç e përmendët edhe ju, kjo është pyetje që është bartë nga seanca e kaluar, kur mungoi kryeministri edhe atëherë edhe sot.

Pra, ka të bëjë me takimet, që kryeministri i ka pas me presidentin e Serbisë, Boris Tadiqin, të fundit, për të cilën është raportuar në “Wikileaks” në selinë e OKB-së në vitin 2008, në cilësinë e kryeministrit të Kosovës.

Pyetja ime ka qenë e drejtuar rreth organizimit të takimit. Pra, ku dhe kur është marrë vendimi që Thaçi ta takojë Tadiqin? A ka qenë ky vendim i Qeverisë apo ka qenë vendim edhe më i gjerë? A ka qenë ndonjë konsensus gjithë institucional për këtë takim apo thjeshtë, krye më vete Hashim Thaçi e ka takuar Boris Tadiqin në cilësinë e kryeministrit të Kosovës?

Qartazi, kryeministri po refuzon t’i përgjigjet këtyre pyetjeve. Pra, qe dy herë në seanca po mungon në këto pyetje dhe rrjedhimisht kjo tregon që në fakt këto takime, përveç që kanë qenë - janë mbajtur, janë edhe takime, në të cilat është folur ose janë dakorduar me presidentin Tadiq për çështje për Kosovën dhe të cilat ai nuk po do me ia publiku as qytetarëve të Kosovës as deputetëve të këtij Kuvendi të Republikës së Kosovës. Por, të cilat në njëfarë mënyre apo tjetër, pasojat e të cilave ne po i shohim sot në këto marrëveshje, që tash po formalizohen me Republikën e Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Selimi e ka pyetjen tjetër. Nuk është në sallë. Deputeti Konjufca, as ai nuk është. Deputeti Aliu. Zoti Aliu e keni fjalën.

LIBURN ALIU: Po, njëjtë. Edhe pyetja ime pra ka të bëjë me takimet, që i ka pasur kryeministri me presidentin e Serbisë Boris Tadiq dhe do të donim pra, të shtjelloheshin këto këtu në Kuvend dhe jo të flitej për to vetëm nëpër media. Pra, vendi është këtu që të flitet për to.

Pyetja ime kishte të bënte në lidhje me konkluzionet, që kanë dalë nga ato takime dhe rrjedhimisht cila është ndërlidhja e këtyre konkluzioneve të atyre takimeve me kompromiset, që po bëhen sot.

Meqë s’është kryeministri këtu, thjesht, konsiderojmë që ai po ikë dhe s’po do të përgjigjet në këtë pyetje. Pra, e papranueshme është që kjo përgjigje të jepet vetëm përmes mediave kur vendi është këtu në Kuvend, që të përgjigjet në këto pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Haxhiu. Regjia, deputetes Haxhiu fjalën! Albulena Haxhiu. Shtype Albulenë atë sustën aty!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe pyetja ime është e njëjtë. Pra ka të bëjë me dy takimet e kryeministrit me Tadiqin. Me që sërish kryeministri po mungon, nuk po e parashtroj pyetjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kasolli!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pyetja ime iu referohet këtyre takimeve, që kanë ndodhur ndërmjet presidentit të Serbisë Boris Tadiq dhe kryeministrit Hashim Thaçi, i pari në vitin 2006 në Selanik dhe i dyti, që ka ndodhur në New York, në selinë e OKB-së.

Shihet qartazi se kryeministri refuzon të përgjigjet në institucione për këto pyetje, që kemi ngritur, por unë do ta përsëris përsëri pyetjen, se cilat janë personat që janë në dijeni të diskutimeve në këto takime? A janë raportuar diku këto takime? Nëse po, ku janë raportuar e kush ka qenë raportuesi? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka pyetje të tjera! Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që është,

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 31 dhe 15 shkurt.

A ka dikush vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka!

Atëherë, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më 31 janar dhe 15 shkurt 2012.

Së sallë janë 65 deputetë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është,

4. Debati parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës në Republikën e Kosovës

Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, e ka shqyrtuar peticionin e koalicionit të pensionistëve të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetaren e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, deputeten Suzan Novobërdaliu ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SUZAN NOVOBERDALIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për një nga problemet më të mëdha të trashëguara që nga paslufta.

Vërtetë, institucionet tona dhe ato ndërkombëtare me mision në Kosovë nuk kanë arritur asnjëherë që të gjejnë një zgjidhje të qëndrueshme për pensionistët lidhur me pensionet e tyre të fituara para lufte në Kosovë.

Kjo kategori shoqërore ka të drejtë të gëzojë një jetë dinjitoze, për të cilën garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, në rast ndarje shtetesh, të suksesionit, shtetet i marrin të gjitha obligimet, si ato ndërkombëtare të fituara nga shteti i përbashkët, po ashtu edhe obligimet për qytetarët e vet.

Duke iu referuar praktikave të vendeve si pjesë konstitutive të ish Jugosllavisë menjëherë pas çlirimit të tyre, të njëjtat kanë filluar organizimin e sistemit pensional vendor dhe atë akoma pa e ndarë pasurinë e përbashkët nga shpërbërja e ish RSF të Jugosllavisë. Pa përjashtim, këtë duhet ta kishin bërë misionarët ndërkombëtarë edhe autoritetet e Kosovës, e cila ishte pjesë konstituive e Jugosllavisë, përkundër që ajo nuk është përfshirë në suksesionin, sipas planit të Badinterit.

Autoritetet kosovare duhet ta qartësojnë njëherë e përgjithmonë çështjen e fondit pensional se i njëjti a është vjedhur nga regjimi serb dhe a i është kërkuar ndonjëherë në formë zyrtare me ndërmjetësim të faktorit ndërkombëtar për kthimin e tij në vend.

Kjo problematikë, pra pensionet e fituara gjatë kohës së ish-Jugosllavisë, jo vetëm që nuk janë trajtuar me ndonjë studim se si do të duhej të realizohej e drejta e pensionit të fituar gjatë asaj kohe, duke ngritur temën në nivelin e negociatave të bisedimeve bilaterale teknike në Bruksel, por, deri tash kjo çështje asnjëherë në mënyrë serioze nuk është trajtuar.

Propozoj, që pa e pritur epilogun e zgjedhjes së kësaj çështjeje, Qeveria e Kosovës duhet që me seriozitetin më të madh t'i qaset problematikës aktuale të pensioneve, me qëllim të zgjidhjes së mirëqenies së pensionistëve të Kosovës, pa pritur zgjidhjen e çështjes së fondit të lartcekur pensional.

Kolegë deputetë, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka shqyrtuar me kujdes petitionin e koalicionit dhe ka pasur shumë herë takim me pensionistë e përfaqësues të shoqatave të tyre.

Sot, nga ky Kuvend, kërkojmë që t'i miratojmë këto rekomandime, si në vijim:

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që në mënyrë urgjente të përgatisë pakon e projektligjeve lidhur me sistemin e pensionistëve dhe të invalidëve të punës.
2. Kërkohet ndryshimi dhe reformimi i skemës së pensionistëve të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe nevoja e veçimit të personave, që me vite kanë kontribuar në fondin e pensioneve të Kosovës.
3. Kërkohet nga Qeveria që pensioni mesatar të jetë 60% nga paga mesatare në Kosovë dhe çdo rritje apo zvogëlim i pensioneve të varet prej përqindjes së rritjes apo zvogëlimit të pagës mesatare në Kosovë.

4. Kërkohe nga Qeveria që për derisa nuk sigurohen pensionet reale për ekzistencë, jetë dinjitoze, për pensionistët të ketë subvencionime për pagesën e rrymës, ujit, nxehtësisë, për transportin urban, barnat esenciale, kontrollet mjekësore, shërimin, pajisjet ortopedike dhe tjera, dhe
5. Kërkohe nga Qeveria që gjatë takimeve dhe bisedimeve teknike me palën serbe të vendosë me prioritet për zgjidhjen e çështjes lidhur me Fondin e Pensionistëve të Kosovës.

Kolegë deputetë,

Ju ftoj për një diskutim të hapur dhe konstruktiv. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë a e do fjalën? Urdhëro, zoti ministër! Ministrit Rashiq fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine zamjenice predsjednika!

Poštovani kolege ministri,

Poštovani narodni poslanici,

Stvarno, Zakon o penzijama je jedan vrlo kompleksan zakon i da vam kažem ono sve što ste naveli vi, kao takođe i svi zahtevi penzionera, koje sam ja primio više puta i od više organizacija predstavnika penzionera, a takođe primio sam ih u više formi da tako kažem i ti zahtevi koje sam dobio su s jedne strane korektni u smislu da se traže u uređenim društvima, koji imaju dugogodišnji razvijen sistem, koji imaju jednu strukturu koja traje godinama.

S druge strane zatražiti u ovom momentu sad od institucija Kosova, koje stvarno imaju limitirane kapacitete, to znamo svi, je - moram da kažem - previše.

Od samog početka, znate i sami, od svih tih nadanja u vezi Zakona o penzijama, počevši od prvog zakona koji je video svetlost dana 2005. ako se ne varam, na kome je stalno bilo insistirano, došli do jedne forme, koja je prihvatljiva. Kad kažem prihvatljiva, ne samo za nas, uvek moram da podsećam i vas i samog sebe i sve ostale, da Međunarodni monetarni fond i Svetska banka su faktori sa kojima mi jednostavno moramo da sarađujemo.

Mi s tim faktorima moramo da nađemo zajednički jezik, bez obzira što oni u našim očima ponekad nemaju smisla za našu realnost, da tako kažem, za naše potrebe, ipak, ukoliko svi mi pravimo društvo, koje bi trebalo tek u buduće da se razvija a svaka dobra budućnost se zasniva na dobrom temelju, i ovaj je onaj temelj koji mi moramo da imamo.

Ja razumem i penzionere, i ja sam u svim tim sastancima, evo verujem da i oni sami mogu to da kažu, da sve sastanke koje smo držali uvek sam govorio da apsolutno razumem njihove potrebe. Ali, njihove želje i naše mogućnosti, su na žalost daleko jedna od drugih.

Mi smo zakon napravili u smislu da ispunjava bar one minimume potreba koje imaju penzioneri.

To nije sve. Uvek treba više, pogotovo kategorije, kao što su penzioneri. Mi imamo problema ne samo u tome, imamo i sa socijalom, imamo sa velikim brojem nezaposlenih. Ali ne možemo favorizovati jednu grupu u našem skromnom budžetu, da bi ove druge grupe bile nesrećne.

Mi moramo pored toga da mislimo na veliki broj mladih nezaposlenih, kojima treba dati priliku. Moramo da mislimo na veliki broj korisnika socijalne asistencije, koji takođe mora da žive bar u onom okviru koji je predviđen i Zakonom, i izveštajima, i tim humanim procenama jednog ljudskog bića.

Sve zahteve koje su predlagani, ja sam svaki od njih više puta gledao i analizirao. Biću kratak. 60% prosečne zarade u ovom momentu za penzije je apsolutno nerealno. U Zakonu, koji je i danas verovatno tu kod vas, je predviđeno povećanje i to je negde dodatnih 19 miliona, što apsolutno nije malo, garantujem vam. Predviđeno je povećanje 26,5%, što opet po procentu nije malo.

Predviđena je dinamika koja će za 2 godine da omogući kategorizaciju penzija u kome će 101 evra biti najniža penzija. A od sada će biti samo veća od toga. Znači zakon stvara dinamiku, konstanto poboljšanje uslova, konstantno povećanje penzija.

Ali, ovo mora biti prvi korak. Ne možemo očekivati da ćemo napraviti jedan idealan zakon. Nijedan zakon nije idealan. Nijedan zakon nije završen zakon. Uvek se poboljšava, uvek se unapređuje. A mi smo, dragi penzioneri, izgubili faktički 7 godina u insistiranju na nekim zakonima, koji nisu prihvatljivi za naše društvo, u finansijskom smilu, mislim. Nisu prihvatljivi za sve naše partnere. Ne upoređujmo se sa Slovenijom, sa Austrijom, sa Švajcarskom. Mi to nismo. Ali možemo da budemo, ukoliko pravimo zdrave osnove zakona, kao što je penzioni, koji imaju velike impakte finansijske, i koji pored toga omogućavaju jednu bazu za budućnost.

Svi moramo da budemo odgovorni, pogotovo vi poslanici, ali ja tražim i odgovornost sa strane penzionera. U ovom momentu ja vam garantujem da nivo, temelj povećanja koje je predviđeno, da je apsolutni maksimum naših mogućnosti.

E, ja sam za onu logiku, i političku logiku i ljudsku, i intelektualnu logiku, da svima nama, kroz dve ili tri godine će neko da ocenjuje naš rad. Ako samo dozvolite da ovaj zakon u ovoj formi koji je sređen, na kome smo radili dve, ili dve i po godine, verujte mi, ako budemo taj zakon usvojili takav, ja vam garantujem da će za tri godine, i sami penzioneri da nam kažu da je bio odličan zakon. Jer je dao baš tu inerciju, taj tempo, razvojni tempo, razvojni put je dao osnovnim pravima penzionera.

Prema tome, ja vas stvarno najiskrenije molim za odgovornost. Nismo samo danas ovde. Moramo da vodimo računa šta ćemo ostaviti i drugim generacijama penzionera a takođe,

pre svega, šta ćemo stvoriti za veliki broj nezaposlenih, koji zavise takođe od ovog našeg istog budžeta. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti Haliti, kryesues i seancës!

Faleminderit, zoti ministër,

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar pensionistë, që tani me vëmendje jeni duke na dëgjuar,

Kjo është një temë aq e rëndë, aq e koklavitur e cila e do angazhimin e përbashkët dhe përgjegjësinë e përbashkët të të gjitha grupeve dhe po ashtu e kërkon edhe përgjegjësinë e përbashkët që të gjendet një zgjedhje duke kuptuar në mënyrë reale situatën në Republikën e Kosovës dhe kryesisht të krijuar pas viti 1999 që është shndërruar në shkatërrimin e skemave pensionale të atëhershme të mbetura dhe në plaçkitjen e Fondit të Pensionistëve të Republikës së Kosovës, të cilat janë tanimë në Republikën e Serbisë.

Unë do të mundohem që pa ju lodhur dhe do t'ju kërkoj durim që të jem pak i gjatë, që të shkoj në një kronologji të shpjegimit të situatës dhe me propozimet dhe në planet se çka të bëjmë në të ardhmen.

Unë e kam parë dhe kam qenë njëri ndër bashkëpunëtorët e ngushtë të të ndjerit, të kryetarit të Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës zotit Ramë Alihajdaraj, i cili me shoqatën e cila ekziston nga viti 1947 dhe me gjithë angazhimin e tij është munduar dhe janë duke u munduar që në bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës të gjejmë një modalitet duke u bazuar me politikat fiskale që të ruhet stabiliteti ekonomik dhe garancioni financiar për këtë kategori të rrezikuar të shoqërisë.

Duke pasur parasysh një analizë kronologjike të paraqitjes së sistemit pensional në Kosovë siç dihet duke filluar nga viti 2001 UNMIK-u e ka futur një ligj apo një rregullore në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, një kornizë për të stabilizuar një situatë të fondeve pensionale dhe si pasojë këto i ndaj në 3 shtylla: pensionin bazë për të gjithë banorët e Kosovës, kursimet pensionale të obligimeve të obligueshme për punëtorët e shkallës së dytë dhe pensionet plotësuese vullnetare të shkallës së tretë.

Në nenin 2, të këtij ligji përcaktohet metodologjia e caktimit të lartësisë të pensionit bazë sipas shportës ushqimore me kalori minimale për nevojat ditore, shporta prej 2100 kalori në ditë që i përfshinë artikujt ushqimorë dhe vlerat referuese të përcaktuara nga Ministria e Financave në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe strukturat për konsum të nevojave elementare bazë në Republikën e Kosovës. Ministria e Financave lypset që t'i garantojë Qeverisë jo më vonë se deri më 1 dhjetor çdo vit të përcaktojë lartësinë e shportës të shpenzimeve ditore në Kosovë. Kjo shportë prej 2100 kalorive caktohet me artikujt bazë të domosdoshëm që e nënkupton edhe kufirin e varfërisë në Kosovë.

Në vitin 2002 ka qenë 0,93 euro në ditë dhe për 30 ditë ka qenë 28 euro dhe ka qenë ajo forma kur është miratuar për herë të parë, dhe tanimë ka shkuar në 45 euro, që është pensioni mujor në vitin 2009.

Nga viti 2010 deri në vitin 2011 nuk kemi pasur rritje të pensioneve. Arsyeja kryesore pse nuk ka pasur rritje të pensioneve është hartimi i Projektligjit për skemat pensionale ku me këtë projektligj është paraparë harmonizimi dhe rritja e pensioneve. Gjithashtu në këtë projektligj është caktuar dhe metodologjia e rritjes së pensioneve ku përgjegjësinë për përcjelljen e pensioneve, të shpenzimeve jetësore dhe rritjen e pensioneve me ligj i takon Ministrisë së Financave.

Pritet që me Ligjin për pensionet, i cili posa të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të rregullohet edhe harmonizimi i pensioneve në të ardhmen.

Si rezultat i luftës, pas vitit 1999 rezulton shkatërrimi total i sistemit pensional të Kosovës dhe si pasojë e plaçkitjes së Fondit pensional nga regjimi serb. Pensionet në Kosovë nuk paguhen prej vitit 1999.

Pas kësaj periudhe në vitin 2001, Kosova do të shkëputet përfundimisht nga sistemi pensional i aplikuar në ish-Jugosllavi dhe me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, duke iu përshtatur reformave integruese, do të krijohet sistemi i ri pensional i reformuar bazuar në kërkesat që njihet si sistem i ndarë në 3 shtylla.

Shtylla e parë e financuar nga të hyrat e përgjithshme të buxhetit të Kosovës përfshin disa skema pensionale: pensionet bazë, pensionet e personave me aftësi të kufizuar nga 18 deri më 65 vjeç, pensionet e parakohshme të minierave të kompleksit Trepça, pensionet e ish Trupave Mbrojtëse të Kosovës, pensionet e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve civil të luftës.

Shtylla e dytë: pensionet e kursimeve individuale, i detyrueshëm, në trustin e kursimeve pensionale me 5% punëdhënësi dhe me 5% punëmarrësi, përveç përparësisë ekonomike dhe demografike dhe përgjegjësisë individuale, investimeve sidomos në rastet e krizave financiare, pasiguria e lartë lidhur me nivelin real të pensioneve në të ardhme, ky nivel është i varur nga rezultatet afatgjate të investimeve në kontributet e kursyera. Mangësi tjetër është në rastet kur paaftësitë, lëndimet apo fatkeqësitë në punë sidomos në rastet kur periudha e punësimit dhe akumulimit është e shkurtër dhe kjo mund të reflektojë në kursimet individuale për të siguruar pensionin invalidor. Shpenzimet administrative mjaft të larta gjeneron po ashtu edhe në formë e pensionimit të kursimeve.

Në shtyllën e tretë, sistemi pensioneve suplementare, plotësuese, vullnetare, i stimuluar me lehtësim tatimor nga shteti, sistemi suplementar në Kosovë aktualisht nuk është konkurruar sepse në treg ekziston vetëm një fond - Fondi Slloveno-Kosovar.

Rregullorja e UNMIK-ut në 2003 me plotësimin e vazhdimet të Rregullores 2005/20 e ka mundësuar ndryshimin e sistemit pensional në Kosovë që të ndahet në 3 shtylla. Shtyllën e parë të financuar nga të hyrat e përgjithshme të buxhetit të Kosovës, që kjo tregon se

Kosova nuk ka politika monetare, dhe me mekanizmat e politikave të veta fiskale ka arritur të ruajë stabilitetin. Prandaj, kanë qenë të detyruar që duke u bazuar në politikat fiskale të ruajë stabilitetin e vetë buxhetor.

Skemat pensionale të shtyllës së parë të cilat në bazë të akteve ligjore i zbaton, implementon dhe menaxhon Departamenti i Administratës Pensionale të Ministrisë të Përkrahjes dhe Mirëqenies sociale, skema e pensioneve bazë, që skema e pensioneve bazë e përfshinë tërë popullsinë e Republikës së Kosovës të moshës mbi 65 vjeç për të dy gjinitë. Kjo skemë ka filluar nga viti 2002 bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 të plotë dhe të Ligjit të 2002/1 mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit, bazë që fillimisht ishte caktuar 28 euro ndërsa aktualisht në vitin 2010 ka arritur lartësinë në 45 euro.

Pagesa është lineare. Numri aktual i përfituesve të kësaj skeme qershor të 2010-ës ka arritur në 113.010 persona, ku buxheti aktual në vitin 2010 është 64.850.000 euro.

Draft ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, me qëllim për draft ligjin e tanishëm i cili nuk është aprovuar, do të flas me qëllim të reformimit të arriturës së një shkallë më të lartë gjithëpërfshirëse, përmirësim të gjendjes ekonomike të pensionistëve dhe njëkohësisht duke tentuar të ruajë qëndrueshmërinë financiare Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka hartuar Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili është kthyer nga Parlamenti për Qeverinë, për shqyrtim të mëtejme.

Në bazë të këtij projektligji është paraparë edhe rritja ku për personat: pensionet kontributive apo kontribuesdhënëse që aktualisht është në 80, të shkohet në 101 euro ku për këtë rritje është një rritje prej 25%. Ndërsa, për pensionet bazike aktualisht 45 euro të shkohet me 50 euro ku kjo rritje është 11%.

Skema do të menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Administrata Pensionale e Kosovës. Do të financohet nga Buxheti i Kosovës ku në këtë ligj do të përfshihen: skema e pensioneve bazike të moshës që janë diku 111.000 pjesëmarrës, skemën e pensionit të aftësisë së kufizuar që janë 19.000 pjesëmarrës, skemën e pensionit të parakohshëm që janë 5.300 pjesëmarrës, që është kryesisht për ish-minatorët e Trepçës, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare që janë 19.000 dhe kontributiv që janë aktualisht 32.000. Benificion shtesë për shfrytëzuesit e skemës së pensionit bazik të moshës dhe skemën e pensionit të parakohshëm, të cilët dëshmojnë që i ka së paku 10 vjet apo më shumë stazh pune deri me vitin 1998.

Unë propozoj, sepse ne kemi diskutuar shumë seriozisht në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, se ky është një problem jashtëzakonisht sensitiv edhe kompleksiv dhe duke parë që në Republikën e Kosovës për ta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë për Shaip Mujën!

SHAIP MUJA: Ne propozojmë që të krijohet një komision, përkundër propozimeve të rekomandimeve, rekomandimet kërkojnë një bazë ligjore e cila duhet të bazohet mbi bazën e një ligji, por që të krijohet një komision më i zgjeruar multi disiplinar i cili do të ndihmojë edhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë së Financave jetë e implikuar e po ashtu edhe Ministria e Bujqësisë, për çka kemi një numër, një përqindje të madhe të personave në pjesët rurale ku janë raste sociale dhe të cilët duhet të ndihmohen duke rritur aftësinë punuese atje dhe t'i heqim nga skema e përkrahjes sociale dhe njëkohësisht të hyjnë në skemën normale të përkrahja sociale.

Prandaj, kontributi juaj, besoj do të jetë pozitiv dhe i arsyeshëm, që ne të krijojmë një komision më të zgjeruar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Shaip! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës fjalën e ka deputetja Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ - BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës i përshëndes përfaqësuesit e shoqatave të pensionistëve të Kosovës që janë këtu prezent.

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka pranuar një peticion nga Koalicioni i Pensionistëve të Kosovës për një debat parlamentar dhe e kemi përkrahë plotësisht, e po ashtu, edhe rekomandimet e tyre të cilat janë shumë me vend.

Sepse, të nderuar deputetë, gjendja sociale e popullatës së Kosovës çdo ditë e më shumë po përkeqësohet. Sot kemi rreth 40% të popullatës së papunë, 18% varfëri ekstreme. Sot qytetari ynë vuan nga mungesa e rrymës, mungesa e sigurimit shëndetësor, mungesa e barnave esenciale. Pra qytetari ynë jeton në një amulli, duke dëgjuar vetëm fjalë boshe e asnjë realizim, e sidomos pensionistët tanë, të cilët janë kategoria më e përbuzur në shoqërinë tonë.

Në janar të vitit 2011 Qeveria e Kosovës i paralajmëroi pensionistët se duke filluar nga janari i vitit 2011 pensionistët do t'i marrin në mënyrë retroaktive pensionet. Po as kjo nuk ndodhi, pra ka kaluar një vit nga ky premtim dhe ministri shumë mirë e di.

Më bëri përshtypje fjala e ministrit kur tha se neve duhet të bijmë në dakordancë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, mirëpo po e harron ministri një fakt që mungesa e Ligjit për skemën pensionale të Kosovës është paraparë edhe në Raportin e Progresit si një ngecje e Qeverisë. Pra është dhënë sugjerim që ky ligj të vjen sa më parë në Parlamentin e Kosovës.

Ju e sollët një ligj, i cili s'kishte asgjë brenda tij, ishte bosh pra fare dhe për atë arsye ne e kundërshtuam si Lidhje Demokratike e Kosovës, sepse ligji asnjë kërkesë të pensionistëve nuk e plotësonte. Pra nuk kishte substancë fare në të, ishte vetëm mashtrim

optik apo më mirë të themi disa rregulla të cilat ishin shkruar në formë të amendamenteve.

Ministri e përmendi Zvicrën. Zoti ministër, nuk kemi nevojë ta krahasojmë Kosovën me Zvicrën, por krahasojeni me vendet e rajonit. Nëse e bëjmë një krahasim pensionistët e Kosovës janë më të papaguarit në Ballkan. Qeveria vazhdon t'i ndajë mesatarisht nga 62.6 euro për pensione në muaj apo 10 fish më pak se sa paguhet një pensionist slloven. Nëse e krahasojmë me Shqipërinë, atëherë në Shqipëri pensioni mesatar është pothuajse 3 fish më i lartë dhe sillet rreth 163 euro, në Bosnje e kemi 170 euro, në Maqedoni 185 euro, në Serbi 240, në Kroaci 310 në dhe 580 në Slloveni.

Pra, zoti ministër këto janë vendet të cilat na rrethojnë dhe nuk kanë GDP shumë më të madhe se sa Kosova, ndërsa pensionet janë shumë më të larta.

Për dallim nga Kosova pensionet në vendet tjera të rajonit janë pothuajse 50% të pagës mesatare, ndërsa në Kosovë pensionet janë rreth 25% të pagës mesatare.

Duke e parë këtë gjendje të rëndë pensionistëve të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që sa më parë të hartohet Ligji për pensionet dhe jo të krijohen komisionet siç u kërkua nga Partia Demokratike, sepse nuk ka nevojë të krijohen komisione për zgjidhjen e çështjeve të pensionistëve.

Qeveria është dikasteri kryesor dhe ministria përkatëse e cila duhet që sa më parë ta hartojë ligjin që t'i zgjidh këto probleme kryesore. Sepse, nëse krijojmë ne komisione dhe harxhojmë kohë duke bërë analiza të tilla për kategorizimin e pensionistëve tanë, atëherë kjo i bie që kjo Qeveri nuk është e interesuar ta zgjedh çështjen e tyre.

Pra, Lidhja Demokratike e Kosovës i bën thirrje Qeverisë që këtë çështje ta merr seriozisht dhe ta sjell ligjin sa më parë në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po duket, se ka replikë. Atëherë, vazhdo, për 2 minuta, ministri Rashiq, e pastaj Shaiqi.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Gospođo Rita, ja morama da vam kažem da u najmanju ruku razočaravajuće je da vi tako mladi da insistirate na nečemu što stvarno nije realno u ovom momentu. I zakone sve, koje smo bili doneli, su bili apsolutno tehnički doterani. I na žalost, obračam se i vama ali obračam se i penzionerima. Ja računam da će oni verovatno najbolje da shvate.

Stvarno je nepošteno u najmanju ruku, dragi penzioneri, nepošteno u najmanju ruku od strane političara da se zarad neke popularističke politike, da se zloupotrebljavaju vaši interesi. Najveći paradoks u politici je kad se neko poziva u vaše ime, da radi u vaš interes a taj rad u većem interesu će apsolutno, baš naprotiv, da direktno ugrozi vaš interes. Apsolutno tvrdim, da ukoliko dođe do toga da se insistira na zakonima, odnosno na beneficijama koje su u ovom slučaju, po meni, mnogo iznad onoga što možemo da pružimo, sigurno ću takođe opet ja, isti ja, pošto je to kompetencija Ministarstva za rad,

morati takode opet da dodem i da opet trazim povlacenje zakona, zbog toga što jednostavno nisu mogli da se sretnu ti zahtevi od strane vaše, od strane poslanika i ispunjenje od strane vlade.

A da ne bi došlo do toga, ja uporno pričam, jer vama je u interesu da opet odlažemo zakon na još tri godine. Ako mi kažete da je to, onda i ja ću. Onog dana sam rekao, ako to rešava pa i ja ću da izađem sa vama transparent da uzmem, i da kažem hoću penziju. Ali neće da reši problem to gospodo, samo će...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ju lutem, ministrit!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: OK! Neću da dužim. Još jednom ću da ponovim ono što sam rekao.

Ja sam vas slušao i slušam svakog od vas kad pričate o bilo čemu. Da vam kažem. Kad ste zakon vratili u ovaj, u vladu, kad ste ga vratili u ministarstvu, toliko ste žučno polemisali ovde a dokument je došao ovde, evo ja ću bukvalno da kažem to treba da znaju i pensioneri, da je došao gde kaže samo vraća se „në ripunim kthehet, në Ministrinë e Punës“, bez i jednog predloga. Ako imate nešto, dajte bar predlog pa da razmatramo predlog.

KRYESUESI: Deputetja Hajzeraj, kundërreplikë!

RITA HAJZERAJ: O zotni ministër, na nuk jemi tu bo politikë populliste, po ju jeni tu bo politikë populliste, se e sjellni një ligj e tani doni me e ndreq problemin e qytetarëve, apo të pensionistëve të Kosovës. Ju e dini shumë mirë, që ligjin që e keni sjellë bosh me disa amendamente, mos të themi rregulla, ju keni thënë që ky ligj duhet të zbatohet prej vitit 2016, çka i bie që as për tri vitet e ardhshme ato rregulla bosh ju nuk do të...

E tash tregoni se cila është politikë populliste, ne që po japim argumentet, faktet dhe alternativat se si duhet të zgjidhet problemi i pensionistëve apo ju që thoni duhet ta zgjedhim çështjen e pensionistëve me një ligj bosh?

Ju nuk keni tregu dhe po ashtu keni qenë të vetëdijshëm, që fondi i pensioneve është plaçkitur. Por, megjithatë ju keni premtuar që do ta sillni ligjin dhe do ta zgjidhni çështjen e pensionistëve.

Po ashtu ua përmenda unë shumë mirë deklaratën që e keni bo me 6 janar të vitit 2011, që do të ju kthehen retroaktivisht pensionet. Pse nuk u kthyen zoti ministër?

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Shaip Muja!

SHAIP MUJA: Zoti kryesues,

Unë jam dakord që ne mos të përdorim më fatkeqësinë e situatës financiare që është në Republikën e Kosovës dhe kjo shportë financiare e cila falë kësaj qeverisje ka arritur që të përgatis një ligj dhe unë e thash fillimisht në prezantim në emër të Partisë Demokratike që të jemi kontribuues pozitiv me miratimin e ligjit dhe Ministria e Financave të jetë në çdo 1 dhjetor të vitit paraprak përgaditës i shportës së shpenzimeve.

Prandaj, nëse duam ne që në emër të kësaj situatë të pensionistëve të fitojmë, atëherë secili duhet të mendojë se nesër kur të vijë në qeverisje apo i përgatit vetit probleme apo po zgjedh probleme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, zonja Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Pikërisht për fatkeqësinë financiare që e përmendi zotnia unë i them që Lidhja Demokratike e Kosovës ju ka paralajmëruar juve që do ta keni një fatkeqësi financiare në buxhetin e hartuar të Kosovës. Dhe, po ashtu unë pare e replikova, sepse apo më mirë të them e përmenda diskutimin e tij, sepse ju gjithmonë kur doni t'i leni punët vazhde apo që të mos i kryeni ju krijoni komisione dhe kërkonit të bëni komisione.

Ju e dini shumë mirë që çështjet zgjidhen me ligje, Parlamenti i Kosovës është për të hartuar ligje dhe miratuar ligje jo për të bërë komisione për çështjet që s'ka nevojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Aliu e ka fjalën. Vetëm një kundër replikë është me rregullore!

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Po bëhen pra 12 vjet që Kosova nuk ka sistem pensional të mirëfilltë, nuk ka Ligj për sigurime pensionale dhe invalide dhe rrjedhimisht nuk ka kujdes për gjeneratën më të vjetër.

Ky sistem nuk i respekton të vjetërit, ky sistem nuk i respekton të varfrit. Edhe aty ku ka ligje edhe aty ku diçka paguhet nuk ndryshon përgjatë viteve ose ndryshon tejet pak dhe ai mos ndryshim prapë arsyetohet tek ligjet.

Pra, në rast të krizave nuk do të doja të them këtu fjalën fatkeqësi financiare sepse kur thuhet fatkeqësi nënkuptohet që ka ndodh rastësisht dhe nuk ka faj askund, kjo është krizë dhe termi “fatkeqësi financiare” është tejet i gabueshëm dhe përpiket me e heq fajin dika dhe në rast krizash, pra në rast se dikush e pëson këto kategori janë të parat ato që e pësojnë. Inflacioni pra rritet lartë e më lartë, ndërsa pensionet, asistencat sociale ngelin aty ku janë, aty ku ishin edhe para sa vitesh.

Dhe mbi të gjitha, është arsytimi prapë tek ligjet dhe kur flasim për hartim të ligjeve që lidhen me çështjet sociale, gjithmonë kohëve të fundit kemi mundur ta shohim që në përfundim të tyre hasim gjithmonë në pikën ku tërë ligji dhe anët eventuale të tij pozitive

i kufizohen planit buxhetor dhe të drejtës apo kompetencës së Qeverisë që t’i kufizojë ato duke u arsyetuar në kufizimin nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Shembull do të doja të marr edhe Projektligjin për skemën e ndihmës sociale që po trajtohet tani, e po ashtu edhe atë për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e po e njëjta gjë po synohet edhe me ligjin e tanishëm, me projektligjin që synohet të vinte për pensionet i cili s’është gjë tjetër vetëm se një arnim në situatën aktuale.

Dhe kur flasim tek ligjet, kur flasim për pensionet gjithmonë e lidhim këtë me indeksin e çmimeve, respektivisht me shportën e konsumatorit. Parimi i tillë është i mbrapshtë. Parimi i tillë do të duhej të ishte kundër dhe do të duhej të lidhte çdoherë edhe me rrogat minimale edhe me rrogën mesatare, edhe me përqindje në raport me rrogën mesatare.

Dhe të gjitha këto sido që t’i marrësh në fund të të gjitha këtyre është ajo pika e cila prapë të kufizon. Pra, te këto ligje vendoset pika e cila i jep të drejtën Qeverisë që të bëjë kufizimet. Ku të bëjë kufizimet? Pra te këto raste, te kategoritë sociale, te pensionistët, te skemat e ndihmave sociale. Pra, nëse prapë sërish themi “ndodh kriza” kush do të jetë ai që do ta bartë mbi vete, mbi supet e veta këtë krizë? Mbi kë do të vlejné ato shkurtime buxhetore? Këta janë pikërisht pra pensionistët, janë pikërisht ata që marrin ndihmën sociale e të tjerët.

Pra, ky sistem është i padrejtë, sepse nuk i trajton baraz qytetarët. Ky sistem nuk i mbron pensionistët, me përjashtim të atyre rasteve që sistemi i mban me punë dhe u jep rroga pse kanë kaluar moshën, ata të tjerët posa që t’i mbushin 65 vjet e fillojnë përfundimin e jetës së tyre me frikën që do të mund të mbijetojnë, a do të mund të mbijetojnë duke e ruajtur dinjitetin që e kanë pasur më herët.

Është tejet e tmerrshme të shikosh pleqtë që të paktën e patën një jetë të dinjitetshme në moshën kur ata ishin produktivë, e që sot hedhen në pozita tejet të tmerrshme ku ata frikohen nga mbijetesa dhe humbja e dinjitetit të tyre. Dhe, është pikërisht dinjiteti ai që i mban ata të mos dalin në rrugë. U vjen turp, u duket që kërkojnë lëmosh edhe pse kërkojnë atë që u takon. Ata shpeshherë heshtin se dinjiteti i tyre i pengon të ngritin zërin, ata janë modest. Dhe pushteti e keqpërdor këtë heshtje dhe e keqpërdor këtë modesti, vazhdon pra t’i lërë ata ashtu në atë gjendje.

Dhe kur vjen puna për te zgjedhjet ka premtime dhe ka gënjeshtër. Kryeministri aktual nuk priton të nënshkruajë të ashtuquajturat “memorandumet e mirëkuptimit” kur i duhen votat e të gjitha këto memorandume natyrisht përfundojnë si gënjeshtër e radhës.

Ndarja në mes gjeneratave tek ne është bërë në mënyrë të padrejtë. Është e domosdoshme të ndërtohet një solidaritet mes gjeneratave dhe këtë solidaritet duhet ta ndërtojë shteti dhe të mos e lërë që ky solidaritet të ndodh vetëm brenda familjeve, pra të ketë solidaritet mes fëmijëve ndaj prindërve të tyre.

Pensionet janë një e drejtë, është diçka që atyre u takon. Nuk është lëmosh që ua jep Qeveria. Ata, pra prindërit tanë, ndërtuan dhe u takon sot që shteti të kujdeset për ta. Po

të mos ishin prindërit tanë ata që e ndërtuan, pushteti sot nuk do të kishte pas as çka të shiste. Të gjitha ato pasuritë që Qeveria sot i shet ata i krijuan.

Bazën e vetëdijes popullore kombëtare sot, që i krijoi kushte për Republikën që sot po e falni ata e bënë. Po të mos ishin ata, ju sot nuk do të ishit në gjendje të falnit nëpër negociata. Pra, ju sot që po mbijetoni duke i shitur vlerat që ne i kemi, nuk mund të mbijetonit po të mos ishin ato gjeneratat e vjetra që ndërtohen këto vlera e që ju sot keni çka me shit.

Zotërinj, kur ecim rrugëve sot çfarëdo që shohim që është në rregull është diçka që është ndërtuar nga gjeneratat para nesh.

Universitetin, e ato qindra ndërmarrje e fabrika, solidaritetin popullor që e kishim, vetëdijen përmes atyre dhjetëra organizatave ilegale - gjeneratat para nesh e bënë. Dhe, sot ata janë zemërgjerë. Nuk duan shpërblime. Ata kërkojnë atë që u takon, ata duan që sot të ketë një solidaritet të pakt në mes gjeneratave, ata duan që kushtet e tyre të jenë më të mira në mënyrë që të vazhdojnë jetën e tyre të dinjitetshme të tillë çfarë e patën.

Ne sot mundemi të bëjmë një gjë të tillë. Kërkesat e tyre nuk janë të paarritshme dhe nuk janë astronomike. Ne sot mund të ndërtojmë një sistem të drejtë pensional në vend se të merremi me arnime siç po veprohet tani.

Sistemi aktual e kemi të qartë se duhet të ndryshojë, por ajo që nuk guxon të jetë e re nuk guxon sërish pra të jetë një arnim i ri. Duhet të ndërtojmë sistemin pensional i cili bazohet në solidaritetin mes gjeneratave, pra zgjidhjen duhet gjetur brenda nesh dhe për këtë edhe ne kemi një plan.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Isufi. S'ë ke shtyp sustën hiq Ahmet.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Është një temë jashtëzakonisht e ndjeshme për një kategori të shoqërisë sonë që ka mbet në një gjendje të mjerueshme pikërisht për shkak se s'është bërë avancimi i politikave të mirëfillta sociale dhe ekonomike në Kosovë.

Pensionistët, të cilët kanë kontribuar për dekada me radhë, janë mbet në një bazë ligjore e cila ka filluar në vitet e pasluftës në vitin 2002 dhe ka mbet në atë shkallë pa një përkujdesje të mëtutjeshme të ndryshimit të ligjeve dhe kategorizimit të pensionistëve të cilët kanë kontribuar për shoqërinë tonë.

Pensioni themelor, i cili është krijuar për herë të parë, ka qenë baza e parë që është dashur të niset, por për 12 vjet mos bëhen ndryshimet e duhura që pensionistët që kanë kontribuar ta kenë të drejtën e një pensioni së paku moralisht të justifikueshëm, është e pakuptueshme për shoqërinë tonë për këtë Qeveri.

Po ashtu, pensionet invalidore të punës, pensionet e parakohshme edhe pensionet tjera janë e vetmja bazë që ka mbet nga koha kur administrimi i UNMIK-ut ka qenë fuqia kryesore në Kosovë dhe PSSP-ja autoriteti i fundit që është dashur t'i nënshkruajë këto ligje. Hajde, për atë kohë ka pas një arsyetim se s'po mundemi për shkak se ka pasur trysni edhe nga faktorët që i përmenda. Mirëpo nga 2008 të mos bëhen reformimet e duhura ligjore që të bëhet kategorizimi, që të bëhet një vlerësim i punës së gjithë atyre që kanë bërë për vite të tëra kjo është e pajustificueshme, sepse ne s'kemi të drejt i ankohemi tjetërkujt përveçse ta shohim vetveten ku jemi me këto veprime. Në vend se Qeveria e Kosovës në bisedime teknike të shkojë për pensionet e grabitura në Kosovë, të shkojë në kursimet e qytetarëve të cilat janë grabitur, kjo ka ndodhur botërisht, shkojnë bëjnë bisedime për ta nënvlerësuar nivelin institucional të Kosovës. Shkojnë për tematika tjera dhe nuk përballen me ato që janë tematika themelore të jetës së qytetarëve të Kosovës.

Po ashtu kjo Qeveri, nga koha kur është pavarësuar Kosova, nuk ka pretenduar që Trustin Pensional ta bëjë me ligj në nivel Kosove, por ende është me Rregullore të UNMIK-ut dhe po ashtu në varfërinë tonë, buxheti i Trustit Pensional ekziston në banka ndërkombëtare. Nuk është për shfrytëzim për qytetarët e Kosovës, nuk është që t'u kthehet nderi dhe morali atyre të cilët kanë investuar, por përkundrazi sot pasurohen të tjerët në varfërinë tonë.

Po ashtu, mashtrimi më i madh që i është bërë pensionistëve, është nga koalicioni qeveritar, që para zgjedhjeve, në fushatën parazgjedhore, ka nënshkruar edhe memorandumet, kanë marr Qeverinë dhe kanë premtuar se do të japin pensionet në mënyrë retroaktive, do t'i rrisin pensionet. Ku janë fjalët, ku është përgjegjësia e kësaj Qeverie nëse në kategorinë më të rrezikuar të shoqërisë nuk janë në gjendje ta realizojnë fjalën e tyre? Po flas për Qeverinë e cila ka nënshkruar memorandumet dhe sot është në pushtet dhe nuk bën veprimin tillë. Çka duhet bërë me këtë Qeveri më shumë për te se për ta quajtur Qeveri abuzuese me një kategori e cila meriton shumë.

Dhe unë përfundimisht po ju them, nëse ka justifikim për periudha kur ka mundur të vendosë tjetërkush, tani nuk ka justifikim. Në Qeverinë Rexhepi ka filluar, por nuk ka vazhduar më tutje mbi këtë bazë të **ngritën** ligje të cilat vërtet e kishin bërë më të dinjitetshëm pensionistin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Pasi jam vetëm këtu, edhe unë i kisha thënë nja dy-tri fjalë.

Ne sot i kemi nga Komisioni përkatës pesë rekomandime dhe ju kisha lutur që diskutimet të jenë në përputhje me këto rekomandime dhe Komisioni, a ka komunikuar me Ministrinë dhe me të gjithë ata që janë të kyçur për këtë çështje për t' i bërë këto rekomandime dhe për të biseduar, jo tash, mos ta shndërrojmë këtë foltore në fushatë për pensionistët që e meritojnë një jetë dhe kushte më të dinjitetshme se sa që janë dhe këtu besoj që të gjithë jemi dakord. Por, a keni hulumtuar, Komisioni, a ka hulumtuar dhe mundësi tjera dhe, sa po e shoh në raport me rekomandime, nuk ka hulumtuar dhe unë mendoj që janë disa mundësi.

Ne e dimë se janë disa mjete të privatizimit. Nga privatizimi 20% merren për punëtorët, ndoshta duhet shikuar mundësinë që një 10% i mjeteve të privatizimit që të shkojnë në Fondin e Pensionistëve. Kjo kishte me qenë një çështje që konsideroj mund të arrihet. Edhe një çështje tjetër që Komisioni ndoshta është dashur ta diskutojë mundësinë që gjenerata t' i ndihmojë gjeneratës edhe unë mendoj që edhe kjo mundësi ekziston dhe kështu edhe Qeveria edhe Kuvendi do ta kishte mundësinë për të krijuar mundësi që vërtet pensionistët të kenë të ardhura më të dinjitetshme dhe ne mos të flasim veç sa për të thënë, por pensionistët na janë drejtuar neve për ta zgjidhur çështjen e tyre, jo për të bërë fushatë.

Unë konsideroj që ne si Kuvend, jemi të obliguar të komunikojmë me Qeverinë, por edhe me ndonjë faktor tjetër. Komisioni do të duhej ta dinte, në mënyrë që ne vërtet ta bëjmë në zgjidhje që është e pranueshme dhe që është në interes të moshës së tretë, po themi kështu në mënyrë që ata ta kenë një jetë më të dinjitetshme.

Unë mendoj që i thashë të gjitha këto fjalë, ne i kemi rekomandimet, të flasim për rekomandimet e Komisionit, se në fund të fundit, ne duhet të votojmë, por edhe kur t' i votojmë rekomandimet, duhet t' i dimë mundësitë se a i kemi gjetur burimet e financimit për pensionistët, këtë duhet ta dimë sepse nuk mund ne tash të **udhëheqim** nga dëshirat tona, që dëshira jonë është që ndoshta mesatarisht një pensionist t' i ketë të ardhurat 500 euro në muaj, por ne duhet vërtet t' i gjejmë burimet dhe kjo çështje të mos na vjen më në Kuvend. Kjo është detyra e Kuvendit dhe ne duhet të bisedojmë, që të ketë zgjidhje dhe mbi bazën e këtyre rekomandimeve që i kemi përpara. Faleminderit! Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Meqë ishte një pyetje nga ana e juaj se Komisioni e ka ftuar ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dua t' ju njoftoj se nuk e kemi ftuar pikërisht për arsye të cilat i cekim në seancë, e arsyet ishin se nuk kemi mundësi. Ne besojmë se pensionistët do të na kuptojnë dhe këto arsye u janë thënë pensionistëve me vite të tëra dhe kemi menduar se është mjaft dhe pas peticionit, të nënshkruar prej 15 mijë e 267 nënshkrimeve, ne e kemi marrë vendim në mënyrë unanime që çështja të radhitet për debat parlamentar.

Pas këtij debati besojmë se Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, si Ministri përkatëse, duhet ta zgjidhë këtë problem të pensionistëve, siç thatë edhe ju zotëri kryetar, një herë e përgjithmonë, të mos ta kemi më çështje në Kuvend. A do ta formojë Komisionin, a do të ketë ekspertë dhe do të zgjidhni çështjet qysh edhe i tha kryetari i Kuvendit, në mënyrë, a do të ndahet prej Trustit, a do të ndahet nga gjeneratat në gjeneratë, atëherë ju pastaj, ajo është punë e juaja, ju duhet ta zgjidhni këtë problem? Ju faleminderit shumë..

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Nëse e kanë kryer grupet, unë e marr fjalën. Por nuk di a e kanë kryer të gjithë? Atëherë, posa ta kryejnë grupet, unë e lyp fjalën.

KRYETARI: Mirë, radha ka qenë për Grupin Parlamentar Kosova e Re. Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Po më vjen keq që sa më erdhe, më është dashur të ndërhyj unë, në bazë të Rregullores, një herë shefat e grupeve, mandej jepja fjalën nga dy-tri herë.

Përshëndetje për dy ministrat që janë këtu dhe për të gjithë deputetët.

Duke marrë parasysh se sot kemi një rekomandim, i cili vjen nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe duke marrë parasysh se e kemi koalicionin e pensionistëve mbropa, ulur, atëherë në mënyrën më të drejtë të mundur, si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe rekomandimet të cilat ai ka sjell Komisioni parlamentar, thuhet që të kërkohet nga Qeveria të përgatisë pakon e ligjeve lidhur me sistemimin e pensionistëve dhe invalidëve të punës.

Qeveria një herë e solli dhe ai ligj u kthye. Kishte me qenë më mirë të thuhet, ndoshta nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, së bashku me ministrin e Financave, i cili pak më parë mu duk që ishte këtu, por tash për momentin nuk është këtu, që të jenë te dytë në harmoni, për arsye se u potencua edhe nga kryeparlamentari, po do të potencohet edhe nga deputetët tjerë, se problemi është te çështja e financave. Sa ka buxheti i Kosovës financa, qysh po shihet për miratimin e kërkesave të pensionistëve, pa marrë parasysh, a është koalicioni i pensionistëve se pensionistë nesër do të jemi edhe ne, metodat janë, mundësitë janë ministër. Fatkeqësisht që nuk është ministri i Financave këtu. Njëkohësisht në bazë të standardit jetësor çfarë e ka Kosova, që të sigurohen ndoshta edhe subvencionet si janë paraqitur prej Komisionit në mënyrë shumë esenciale për pensionistë se këta janë edhe baballarët edhe nënat tona, që do të thotë se çka do të flasim, nuk do të jetë çështje politike, por do të jetë çështje e cila duhet të zgjidhet për këta persona, se e meritojnë. Se ne jemi produkt, u tha edhe nga parafolësit, se sot jemi ulur këtu nga këta njerëz të cilët e kanë shtruar ndoshta rrugën që ne sot të kemi mundësinë edhe të debatojmë edhe të diskutojmë brenda Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të SLS-së, a e do dikush fjalën? Jo.

Në emër të Grupit parlamentar “6+”, deputetja Mufera Shinik.

MUFERA SINIK:

Faleminderit, kryetar!

Sayın Başkan, milletvekilleri, bakanlar ve bugün Meclisimizde misafir buluan emekliler derneği üyelerini saygıyla selamlıyorum

Yıllardır Kosova emeklilerininin maddi manevi durumlarında zorluk yaşandığını hepimiz görmekteyiz. Ancak bu zorluğu en çok yaşayanlar yani kandileri bilir. Yıllardır süre gelen bu sorunu 2010 yılında Emeklilere ait Yasa üzerinde ciddi bir şekilde çalışıldı. Bu da 2011 yılının bütçe planlamasına 1 Ocak 2011 yılından yürürlüğe geçmesi gereken Dünya Bankası ve Uluslararası Para Fonu ile yapılan sözleşmeye göre, öngörülen

mevlağın ödenmesi maalesef yürürlüğe geçmediği görülmektedir. Bu sorunlar Kosova Emekliler Kanununun olmamasından kaynaklanmaktadır. Bundandır Kosova Emekliler Yasasının ivedilikle işlenmesi gerekmektedir. Ancak bu Yasanın Kosova Hükümetinin sunduğu Yasa Tasarısı önerdiği şekilde değil, çünkü bu Yasa Tasarısında önemli eksikler görülmektedir.

Öyle ki Kanun önergesinin emeklilerin talep ettiği şekilde düzelinceye kadar, bir kararnameyle söz verildiği şekilde yüzde 26'lık zam 2012 yılının ocak ayından itibaren geri dönüşümlü verilmesi gerekmektedir.

Kosovada Emeklilik Fonunun henüz yürürlükte olmadığı için, emekliler tarafından talep edilen emekli maaşlarının ödenmesi şu anda imkansız olsa da, buna kısa zaman içerisinde farklı formüller üzere farklı kaynaklar yaratarak, bir düzelmeye gidilmesi gerekmektedir. Günümüzde Kosovanın farklı anlaşmalarını göz önünde bulundurursak, bazı yasal süreçlerin tamamlanması gerekmektedir. Bunların arasında Emekliler Yasasıdır.

Dünyanın birçok demokratik ülkelerinde olduğu gibi, örneğin, İsviçrede çalışmış Kosovalı vatandaşların emekli maaşı ve sosyal sigorta primlerini alamaması, Kosovadaki Sigorta ve Emeklilik Yasasının olmayışındandır.

Sırbistanla yapılan görüşmeler üzerinde Emeklilik Fonunun Kosovalı vatandaşlara geri iadesi için çabaların sunulması gerekmektedir.

Emeklilik Yasasıyla birlikte, emeklilerin sorunlarını tamamıyla ortadan kaldırmak için ekonomi kalkınmaya yönelik stratejilerin yaratılması gerekir. Örneğin, yeni yatırımlarla işyerlerinin açılmasıyla gençlere iş istihdamını yaratmak. Böylece Kosova Emeklilik Fonu birikmesine gençler çalışarak ve primleriyle katkı sunacakları en önemli çözüm yollarından biridir, ki Kosova Hükümetinin en kısa zamanda bu konuyla ilgili çözüm üreteceğine inanıyorum. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar i Kuvendit dhe ju ministra që jeni këtu,

Kolegë deputetë,

Po përpiqem të jem konkret duke pasur përpara meje rekomandimet që i ka dhënë Komisioni funksional.

Po them menjëherë në fillim që në kuptimin e formulimit i përkrah të gjitha këto rekomandime. Çështja është që çfarë duhet të bëhet që këto rekomandime të bëhen vepër, mos të mbeten një deklaratë e një diskutimi okazional ose të rastit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Fjalinë e parë edhe të fundit që do ta kisha në kuptimin e përgjithshëm për temën e madhe që po diskutojmë sot është, që pensionistët nuk kanë nevojë edhe nuk donë

edhe nuk lypin mëshirë, por lypin të drejtë dhe kjo është deviza themelore për një trajtim normal në një shoqëri normale të një shtrese njerëzish që kanë punuar shumë.

Duke u nisur nga ky formulim universal për këtë problem, unë do të kaloj në këto pika.

Pika numër 1, që kërkon që çështja të zgjidhet me ligje e jo me deklarata voluntariste, qofshin ato të natyrës paraelektorale, elektorale ose mbas elektorale, nënkupton hartimin e ligjeve dhe përtej kësaj, hartimin e ligjeve të zbatueshme, sepse ju mund të krijoni letra të bukura sa të doni, nëse s'ka mbështetje financiare, ligjet mbeten shkronjë në letër që nuk bëhet jetë. Pra, të hartohen ligjet duke gjetur burimet për aplikimin e tyre, zbatimin e tyre dhe kjo bëhet me dy ligje, unë do të thosha. Ne e kemi pasur një variant i cili nuk ka kaluar që të diferencohet. Ajo që quhet pension moshe, ajo s'është pension moshe, ajo është shtesë, ndihmë moshe. Pensionistë janë ata që janë kontributdhënës në ndërtimin e asaj që quhet pasuri e trashëguar e Kosovës dhe e fondeve për pensionistë.

Tash ne i kemi dy probleme, që këto dy burime po shkrihen. Njëri po shkrihet në tipin e privatizimit ku pensionistët dalin nga loja dhe tjetri është fondet e pensionistëve, të cilat në një moment janë grabitur, po askush nuk ka bërë llogari të vërtetë ajo grabitje sa ka qenë, askush nuk e ka trajtuar si duhet që ai fond është bërë bosh meqë me decenie nuk ka hyrë asgjë aty dhe e treta, që kurrkush nuk do ta bisedojë. Sa është numri i pensionistëve që duke shfrytëzuar të drejtat e tyre të ligjeve pozitive që quhen edhe i kanë marrë pensionet dhe nesër jepet përgjigja që ato të holla kanë dal nga ai fond i paragjykuar.

Çfarë duhet të them? Duhet të them që problemet janë komplekse dhe duhet të studiohen me germë dhe me shumë. Kjo ka të bëjë me ata që janë, edhe një herë thashë, që kanë dhënë shumë për këtë vend dhe e kanë bërë, dhe e kanë ndarë mundin e vet për këtë vend dhe për Fondin.

Dhe brenda kësaj, unë mendoj që duhet meqë ky është i shkallëzuar edhe kjo ofertë jetësore e punës, atëherë të krijohet një variant i pensioneve të veçanta për të cilët unë kam një ide dhe e kam një projekt të cilin do t'ia propozoj Kuvendit kur të vjen koha, që do të hyjë ose kapitull në ligj ose do të propozoj ligj të veçantë dhe unë sot nuk do ta zhvilloj më tutje, po ai është domosdo. Kjo kishte me ndryshimin e pikën 2, pra e përkrah.

Pika 3 që ofron një shumë 60% të pensionit të rrogave mesatare dhe ta ndjekë këtë në lëvizje kohore. Është e domosdoshme, domethënë është kërkesë reale, në këtë shoqëri ndodhë kjo, po pa u krijuar fondi, fondi nuk ka shans që të bëhet kjo. Kosova duhet të ndërtojë fondin, duhet të gjejë burimet. Tash, prapë unë po them duhet, por nëse ne e shkruajmë që pensioni mesatar të bëhet 60%, po, pra duhet të gjenden burimet. A janë tash këto burime të pjesëve të privatizimeve, sepse është djersë e këtij brezi, një pjesë e Trustit Pensional të sigurimeve të cilat janë sigurime personale, po edhe të detyrueshme, a ka mundësi Qeveria të marrë, unë nuk jam ekonomist, por a ka të marr borxh e të tjera, këto i takojnë Qeverisë që të merret për krijimin e fondit inicial,

i cili bën llogaritë e sakta, sa pensionistë kontributdhënës i ka, sa i paguan dhe sa bëhen nëse shumëzohet me këtë shumë?

Edhe pikën e pestë, këtë problemin me bisedimet me Serbinë që është bërë pak si formulë e pastudiuar, unë mendoj që duhet të bisedohet, veç edhe duhet të bisedohet me shifra e me letra, jo me slogane. Mos të del mbasandaj se ne po flasim shumë dëshira që nuk mbështeten në realitete edhe në...

Pika e katërt, që prapë e mbështeti, mua në princip nuk më pëlqen shumë, se është pikë e reagimit kur ende në mënyrë sistimore nuk e ke zgjidhur problemin. Unë do ta mbështes edhe katërshin, pa dëshirë, sepse nuk zgjidhen problemet e kësaj shtrese, me vlera, me kontribute nëpërmes asaj që do të ndihmojë ta kryesh një punë më lehtë. Është mirë, ajo është emergjente, po edhe një herë po them, kjo është kategori që i ka vlerat dhe ne as shoqëria nuk duhet të sillet me mëshirë, por me vlerësim dhe me të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani është radha e deputetëve për të diskutuar.

Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Ju faleminderit!

I nderuar, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, duhet ta ngrit problemin e pensioneve të punëtorëve të arsimit të cilëve nuk u njihet statusi i pensionistit në bazë të kontributit të dhënë, problem, të cilin po e ngrit unë, është konform me rekomandimin numër 2, të cilën e ka dhënë Komisioni.

Si pasojë e mos njohjes së përvojës së punës, shumë punëtorëve të arsimit ju ndodhë që kur të pensionohen, nuk e gëzojnë pensionin si kontributdhënës por pensionin e pleqërisë, njësoj sikurse të gjithë qytetarët tjerë që nuk kanë bërë asnjë ditë punë, por e fitojnë të drejtën e pensionit vetëm në bazë të moshës së pleqërisë.

Unë mendoj se mosnjohja e statusit të pensionistit në bazë të kontributit të dhënë, për punëtorët e arsimit, të periudhës së lartpërmendur kohore, është një padrejtësi e shumëfishtë. Pra është fjala për periudhën 91-99. Së pari ata kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ruajtjen e vazhdimësisë së arsimit dhe edukimit në gjuhën shqipe, por i njëjti ishte ndaluar nga regjimi pushtues serb.

Së dyti, shumë punëtorë të arsimit shqip të asaj kohe, u ndoqën dhe pësuan në mënyra të ndryshme nga regjimi serb, mu për shkakun se nuk ju nënshtruan regjimit serb.

Se treti, ata dhanë një kontribut të veçantë dhe në planin kombëtar sepse e organizuan dhe e zbatuan procesin e arsimit dhe edukimit mbi baza kombëtare, duke i refuzuar plan programet nënshtruese serbe.

Së katërti, ata shpeshherë punuan dhe pa pagesë dhe ishin të gatshëm të sakrifikonin gjithçka, vetëm për ta mbajtur të gjallë arsimimin shqip në Kosovë. Mbase ka edhe të thuhet edhe shumëçka tjetër për punëtorët e arsimit që punuan gjatë periudhës së lartpërmendur kohore ndër më të rëndat në historinë më të re të Kosovës, por po kufizohen me këto që thashë më lart duke kërkuar që kësaj kategorie të nderuar të shoqërisë sonë, t'u njihet statusi i pensionistit në bazë të kontributit të dhënë në këto vite të rënda dhe të jashtëzakonshme të punës.

Mendoj se duke e bërë një veprim tillë, do t'i nderojmë më shumë institucionet e shtetit tonë dhe më pak këtë kategori të nderuar të shoqërisë sonë, të cilën do ta nderonim ashtu si duhet vetëm nëse ua njohim këtë stazh apo përvojë të punës të beneficuar. Prandaj mendoj se njohja e statusit të pensionit në bazë të kontributit të dhënë, është minimumi i asaj që duhet të bëjmë për këtë moment, për këtë kategori. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Ju faleminderit!

Historia jonë nuk është mohuar vetëm me ndërrim flamujsh e të simboleve, por edhe me sistemin pensional, i cili ka nisur prej fillimit thua se nuk ekziston e kaluara fare. Pra, është bërë prerje absolute në kohë, athua se kemi lindur në vitin 2000, athua se kemi ardhur në jetë vetëm pas luftës.

Pikërisht kjo mënyrë na ka tëhuajësuar prej fondit tonë pensional, të plaçkitur prej Serbisë. Përgjithësisht, përgjatë bisedimeve, negociatave me Serbinë pas përfundimit të luftës, e në veçanti në dialogun aktual me të në Bruksel, kthimi i Fondit pensional, pra kthimi i kontributeve, nuk ka qenë parakusht i dialogut me Serbinë dhe madje as temë e këtij dialogu.

Qeveria vazhdimisht na flet neve qytetarëve dhe deputetëve për obligimet e Kosovës së pavarur ndaj miqve ndërkombëtar, por asnjëherë nuk ia përmend as miqve ndërkombëtarë dhe as Serbisë, borxhin që ajo na e ka, plaçkitjen që kjo e fundit na e ka bërë. Sipas një sindikate të pensionistëve, fondi i plaçkitur i kontributeve është mbi 2 miliardë euro.

Në vend se ta mbajë lart çështjen e Fondit pensional të plaçkitur nga Serbia, qeveritë e pasluftës me në krye UNMIK-un e deri te kjo e sotmja, e kanë vazhduar punën e Serbisë. Plaçkitja e kontributeve të punëtorëve është pasuar nga grabitja e djersës së punëtorëve përmes privatizimit të egër. Punëtorëve iu është vjedhur e ardhmja si pension që ata e kursyen dhe iu është vjedhur e kaluara si ndërmarrje që ata i ngritën.

Në Kosovë, paga mesatare është sa katërfishi i pensionit. Kjo s'ndodh askund në botë. Ky shtet thua se dëshiron që t'i vrasë pleqtë, sepse me 45, përkatësisht 80 euro pension, kemi veçse vrasje të ngadalshme me paramendim. Pleqtë janë e kaluara midis nesh dhe ky shtet që po ndërtohet duke e zhdukur të kaluarën, natyrisht që nuk i do pleqtë. Rritja e pagave, pa rritje të pensioneve e ka konfirmuar këtë gjë. Prandaj, pensioni në Kosovë që në të vërtetë është asistencë sociale dhe jo pension, sërish nuk është asistencë sociale për jetë më të gjatë, po për vdekje më të shpejtë. Me 45, përkatësisht 80 euro, gjithsesi mbetesh thellë nën pragun e varfërisë.

Sistemi pensional që i nevojitet Kosovës, është sistemi pensional solidar, sepse vetëm ai lloj sistemi pensional i kontribuon kohezionit social duke bërë lidhjen e fuqishme midis brezave. Pa solidaritet të brezave, pa solidaritet të punëtorëve, mbetet vetëm solidariteti familjar që kur del në sferën publike shndërrohet në nepotizëm.

Problemi themelor qëndron se në Kosovë kemi dominimin e diversitetit dhe jo të solidaritetit, të tolerancës e jo të bashkëpunimit, të shitblerjes si një kontakt pa raport, ku nuk ka marrëdhënie midis njerëzve, por kontakt që mundësohet nga paraja, nga instant-shkëmbimi, e jo nga solidariteti që vjen prej shtetit, prodhimit, punëtorëve, zhvillimit.

Fjalja e parë në Planin e Ahtisarit thotë: "Kosova duhet të jetë shoqëri multietnike" Kjo është shumë interesante, sepse paraqet premisën e ndërtimit të shtetit të Kosovës, sot dhe kjo premisë nënkupton që shoqëria tashmë është këtu, por duhet të diversifikohet, të bëhet multietnike e jo nëpërmjet solidariteti ta ndërtojmë dhe forcojmë shoqërinë tonë. Prandaj besoj që defekti themelor, le të themi edhe teorik i shtet ndërtimit në Kosovë, është që ai është i bazuar mbi diversitetin që nis me dallimet dhe jo mbi solidaritetin që konsiston te universalja.

Prej këtyre pesë kërkesave kryesore të pensionistëve, të peticionit të tyre, mund të themi që kërkesa e pestë tashmë është plotësuar, për shkak se po e mbajmë këtë seancë. Po ashtu edhe kërkesa e parë është plotësuar, sepse draftligjin diskriminues për skemat e pensioneve të financuara, ia kemi kthyer mbrapsht Qeverisë, ndërkaq për kërkesat: 2, 3 dhe 4, sërish i përket Qeverisë që t'i zbatojë ato. Por, po përfundoj duke thënë që problemi themelor është modeli i shtet ndërtimit që nuk e ka për bazë solidaritetin, por diversitetin në llogari të solidaritetit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar,

Të nderuar deputetë,

U bënë 12 vjet që prej përfundimit të luftës e pensionistët kosovarë po përballen me një pozitë diskriminuese, në të cilën pozitë i ka vënë Qeveria e Kosovës.

Ata që kanë punuar deri në moshën e pensionimit të tyre, marrin 80 euro në muaj, ndërsa ata që nuk kanë punuar gjatë jetës së tyre, marrin një shumë prej 45 eurosh në muaj. Kjo shumë e pensionit aktual është e pamjaftueshme për të siguruar madje edhe ekzistencën fizike. Sipas kësaj, ky pension nuk i mbulon kërkesat e pensionistëve së paku për të mbijetuar. Kërkohen: ngrënia, pija, rrobat dhe medikamentet. Pensioni prej 80 eurosh nuk mjafton për t'i mbuluar kërkesat e një pensionisti.

Qeveria e Kosovës në largim, në fillim të muajit janar vendosi rritjen e pagave për kategoritë që paguhën nga buxheti i Kosovës, ndërsa kryeministri në dorëheqje, Hashim Thaçi, paralajmëroi rritje të pensioneve. Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pensionet, gjithçka do të jetë e rregulluar dhe rritja e pagave edhe për pensionistët do të hyjë në fuqi me hyrje në fuqi të Ligjit për pensionet, tha kryeministri Thaçi. Ne kemi kërkuar që pensionet të startojnë me 40% të mesatares të ardhurave personale të vitit të kaluar dhe të përcillen me përqindjen e inflacionit. Është kërkesë e pensionistëve, këta nuk e kanë marrë parasysh dhe është përgatitur një skemë pensionale e cila nuk mund të quhet ligj. Ne mendojmë që pas 11 vjetëve që u çliruar prej Serbisë, Kosova ka resurse për të pasur jetë më të mirë për pensionistët dhe për të tjerët.

Kosova kishte një fond pensionesh i cili është tërhequr nga administrata serbe në përfundim të luftës në Kosovë. Askush nuk e di me saktësi numrin e pensionistëve, për shkak se nuk ka pasur regjistrim të popullsisë, por vlerësohet se në Kosovë ka mbi 120.000 pensionistë, mbijetesa e të cilëve vështirë se mund të sigurohet me skemën aktuale që na është ofruar.

Përfaqësuesit e organizatave humanitare në Kosovë, thonë se pensionistët radhiten në mesin e kategorive më të rrezikuara të popullsisë dhe se me pensionet që sillen prej 35 deri në 80 euro në muaj, Kosova është e fundit në krahasim me të gjitha vendet e tjera të rajonit.

Gjendja aktuale e pensionistëve parqet shkelje të drejtave të njeriut dhe të dokumenteve në fuqi. Pensioni, si e drejtë personale, materiale, është pronë personale, ndërsa këtu te ne, ajo vlerësohet si diçka e cila është dhuratë nga dikush. Kjo nënkupton shkeljen e dinjitetit të njeriut si bazë për të gjitha të drejtat dhe funksionimin e shtetit në përgjithësi. Por, duhet theksuar se me të gjitha këto vështirësitë serioze të jetës së pensionistëve, pensionistët dhe anëtarët e familjeve të tyre jo vetëm që kanë ruajtur dinjitetin njerëzor dhe integritetin moral të personalitetit të tyre dhe të familjarëve, por asnjëherë nuk kanë pasur reagime agresive ndaj organeve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. Andaj, Qeveria duhet të niset nga etika që duhet ta kenë ndaj një qytetari të moshuar, ndaj një pensionisti i cili ka punuar deri me 40 vjet dhe ka paguar kontributin edhe ka humbur dhe i cili nuk e ka humbur identitetin dhe nuk dëshiron ta humbë identitetin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Jeton Svirca, e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga paslufta e këndej, pensionistët e Kosovës, nuk janë ndalur së reshturi duke kërkuar trajtim më të mirë nga Qeveria dhe shoqëria në përgjithësi. Këta pleq që një pjesë të madhe të jetës së tyre e kanë kaluar duke punuar, sot kur më nuk janë vital dhe të aftë që të punojnë, thonë se pak ne interesohemi për ta.

A nuk jemi ne të aftë që këtyre të moshuarave, që edhe ashtu janë në përfundim e sipër të jetës së tyre, t'ua japim tretmanin e merituar. Banorët e Kosovës që kanë pasur fatin t'i mbushin 65 vjet, nuk mund të kënaqen me ditët e tyre të pleqërisë pasi ndihma sociale, siç e quajnë ata në shumë prej 40 – 80 eurosh, nuk u siguron atyre as gjërat elementare për ushqim, barëra dhe shkurt e shqip pleqëri të rehatshme. Duhet përmendur edhe kontributet e tyre disavjeçare që pa të drejtë ligjore, Serbia i mban. Kjo temë duhet të jetë në agjendën e dialogut me Serbinë e që patjetër duhet të kthehen këto kontribute, që sipas informatave janë shuma të mëdha.

Deri në momentin e themelimit të Fondit të Pensioneve, e që ne si parti e konsiderojmë si zgjidhje të drejtë për situatën aktuale, kërkojmë që me ligjin e ri të skemave pensionale që është kthyer në ripunim në Qeveri, të parashihet ndërlidhja e fondit të Trustit Pensional me Fondin Pensional, me çka do të mundësohet ngritja e pensioneve deri në 60% të pagës mesatare mujore, pa e cenuar stabilitetin buxhetor të vendit.

Jemi të bindur se kjo zgjidhje do të mbështetet nga shumica e qytetarëve të Kosovës, sepse do të mbështetet në ripërtëritjen e parimit të solidaritetit ndërmjet gjeneratave që ka qenë vlerë e veçantë e shoqërisë kosovare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TETUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Shumë të respektuar pensionistë që jeni sot këtu me ne

Ishte bukur e dhimbshme të shihet që në ditët e janarit, në një kohë të ftohtë dhe me borë, t'i shohësh pensionistët duke mbledhur nënshkrime nëpër Prishtinë.

Ishin njerëz të cilët ne i njiheshim, njerëz të cilët e kanë udhëhequr Kosovën, institucionet e ndryshme Kosovës, njerëz shumë të respektuar dhe të zot në kohën e tyre, njerëz të cilët ndërtuan Universitetin, e ndërtuan këtë sallë këtu ku jemi sot, e ndërtuan infrastrukturën shumicën e tyre, nëpër të cilët ne sot udhëtojmë, komunikojmë. Është e dhimbshme që ata të jenë të detyruar të dalin në rrugë për një të drejtë të tyre legjitime, për një jetë të dinjitetshme, për atë që do të duhej t'u takonte apriori e sidomos kaq vite pas luftës edhe pas pavarësisë.

Mbledhja e mbi 15.000 nënshkrimeve për katër ditë tregon se ata që kërkojnë, me të vërtetë e meritojnë edhe që është jo vetëm disponim, por është nevojë e të gjithë qytetarëve që kjo kategori e njerëzve me të vërtetë ta ketë një jetë të dinjitetshme.

Thuhet që ai që nuk ka respekt për të kaluarën, nuk e meriton respektin për të ardhmen e fatkeqësisht është ajo të cilën ne po e bëjmë edhe është përsëri e pajustificueshme që sa vite pas luftës dhe pas pavarësisë, ende t'i kemi vetëm dy kategori, kategorinë e ndihmës prej 45 eurosh edhe në kategorinë në të cilën futen të gjithë pensionistët, pa marrë parasysh stazhin të cilin e kanë pasur, pa marrë parasysh pagat të cilat i kanë pasur, pa marrë parasysh kontributin të cilin e kanë dhënë edhe kjo është me të vërtetë e pajustificueshme.

Shumë herë u përdor fjala “fushatë”, por po mendoj që sot jemi në këtë situatë këtu pikërisht për shkak të fushatës në të cilën pensionistët janë përdorur në shumicën e zgjedhjeve, të cilëve u kanë premtuar rritje e rrogave edhe të cilët rritja e pensioneve dhe për të cilat në fakt e gjithë ajo çka është arritur, ka qenë një zyre e tyre dhe fjalët boshe, por në asnjë mënyrë zgjidhje. Ministri i Punës, zoti Rashiq nuk ka faj, nuk kanë qenë premtimet e tij, por sipas detyrës eksoficio atij i takon t'i dëgjojë këto fjalë. Ai e arsyeton mungesën me buxhet, arsyeton mungesën e miratimit prej FMN-së, po ai harron se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave pikërisht më 21.1.2010 ka deklaruar që do të ketë rritje edhe ato retroaktive prej vitit 2011. Është kjo e njëjta Qeveri, me të njëjtin kryeministër edhe me të njëjtit njerëz të cilët kanë qenë në Ministrinë e Financave. Ajo që nuk është e njëjtë, është që kjo ka qenë kohë në të cilën janë bërë rivotimet edhe në të cilën është kërkuar secila votë në mënyrë që të grabitet Qeveria, edhe me premtime false është grabitur Qeveria, e cila sot kërkon tash Kuvendi t'i zgjidhë problemet të cilat i ka shkaktuar ajo vetë.

Është fer që ministri Rashiq të tregojë që këto kanë qenë premtime false, jo serioze dhe jo sinqerta. Është fer që të tregojë se tema e pensioneve kurrë as nuk ka me qenë si temë e bisedimeve me Serbinë.

Është fer që të tregojë që në buxhetin e Kosovës janë të parapara për çdo vit shumë vetura për ministri, çdo vit ndërrohen veturat për të cilat paguhet një sasi e madhe e parave. Për ato nuk kërkohet miratimi i FMN-së apo nuk ka problem buxhetor.

Është mirë që Qeveria e cila vetë ka premtuar, e cila ka shkaktuar këtë problem, e cila në vazhdimësi fushatë për fushatë, ofron fjalë të cilat nuk është gjendje që t'i përmbushë, më në fund të heqë dorë prej atyre lukseve të pakuptimta edhe të mbajë premtimin. E dimë që premtimet veç jepen edhe kryeministri shumë herë i ka ndërruar fjalët, po kësaj here është radha që Qeveria të mbajë fjalën edhe ta plotësojë atë premtimin të cilin e ka dhënë, të gjejë zgjidhje edhe t'ia afrojë atë zgjidhje Kuvendit. Të mos shkakton vetëm probleme, po të shkaktojë zgjidhje të këtyre problemeve të cilët i kemi borxh këtyre pensionistëve që janë këtu edhe që secili prej nesh i kemi nëpër shtëpia.

KRYETARI: Faleminderit!

Unë po ju njoftoj që për diskutim janë të lajmëruar 22 deputetë. Po ua tërheq edhe një herë vërejtjen ne mund të vajojmë sa të doni, por si Kuvend dhe si institucione, kemi obligim vërtet ta zgjidhim këtë çështje dhe ju lutem, ne nuk po flasim për premtime se në fushata të gjithë, këtu me ju thanë të drejtën për pensionet veç “Vetëvendosja” kanë të

drejtë me fol, ju të tjerët gati s'keni as të drejtë me fol se të gjithë keni kaluar nëpër qeverisje edhe keni qeverisur keq tërë kohën, i lëmë ato çështje.

Po i lus deputetët nëse kanë diskutuar këtë çështje në grupet parlamentare, në partitë e tyre dhe e kanë formësuar qëndrimin e partisë politike që e përfaqësojnë, le të na bien si dalim nga kjo zgjidhje. Një, ju lutem, një thashë se është 10% a 20% i Fondit të Privatizimit, pak solidariteti, gjenden forma dhe të bëhet fondit, pa e bërë fondin, cila do të jetë, kah me i marrë ato të holla për t' i shpërndarë. Ne si Kuvend, si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, kemi për obligim ta formojmë Fondin. Prandaj, ju lutem.

Fjalën e ka deputetja, Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Fillimisht dua të shfrytëzoj rastin që t' i falënderohem të gjithë pensionistëve e Republikës së Kosovës, që për mendimin tim janë sakrifikuar po thuaj se deri në vetëmohim vetëm për hir të situatave nëpër të cilat ka kaluar vendim ynë, por, në të njëjtën kohë ndjejë një dëshirë që kësaj kategorie t'iu kërkojmë edhe falje publike edhe pse jam në mandatin tim të parë si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse e konsideroj që nuk kemi bërë mjaftë për mirëqenien e tyre.

Pensionistët e Kosovës kanë qenë shumë të durueshëm për hir të situatave politike, por ka ardhur koha që përgjegjësitë të merren më seriozisht, me zhvillimet e politikave sociale. Ka ardhur koha që neglizhenca, paaftësia për zhvillimin e këtyre politikave të mos arsyetohet më duke u fshehur pas politikave ndërkombëtare apo të ashtuquajtura çështje madhore, aq më tepër që për mendimin tim edhe dinjiteti i kategorive që përfshihen në këtë peticion, i takon çështjeve madhore, sepse një popull pa dinjitet brenda nuk mund të kërkojë trajtim të dinjitetshëm nga jashtë.

Me gjithë përpjekjet të Qeverisë aktuale për përmirësimin e situatës së pensionistëve dhe kategorive tjera të ndjeshme të shoqërisë, e trashëguar nga qeveritë e kaluara në fushën e politikave sociale janë ende evidente.

E kaluara, qoftë nëse ajo lidhet drejtpërsëdrejti me qeverisjet e mëhershme, qoftë me situatat në përgjithësi, nuk mund që vazhdimisht të shërbejë si arsyetim për situatën aktuale.

Një shtet që synon përparim duhet të ketë kuadro përkatëse për zhvillimin e politikave përkatëse. Urgjentisht duhet të gjenden zgjidhje për përmirësimin e jetës sociale në vendin tonë, prandaj, është koha e fundit që krijimi dhe zhvillimi i politikave sociale në agjendën e politikave shtetërore, të trajtohet me prioritet më të lartë, sepse të gjithë e dimë se pensionistët dhe kategoritë tjera të përfshira në këtë peticion, mbijetuan vetëm falë strukturës dhe traditës shoqërore të këtij populli, përndryshe ata do ta kishin të pamundur të mbijetonin.

Pajtohem plotësisht që peticioni i dorëzuar duhet të trajtohet me seriozitetin më të madh, plotësisht përkrah edhe kërkesën për futjen me urgjencë në agjendën e bisedimeve me

Serbinë edhe çështjen e fondeve pensionale të Republikës së Kosovës. Edhe pse Qeveria nuk e ka anashkaluar këtë çështje, megjithatë, shpresojmë dhe besojmë se në të ardhmen, në bisedimet me Serbinë, do të ushtrohet presion maksimal për kthimin e kontributeve pensionale të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po ashtu përkrah plotësisht kërkesën për trajtim të veçantë të pensionistëve kontribuues në këto fonde. Nuk guxojmë të vazhdojmë me praktikën e mëhershme e cila për shkak të mungesës së vizionit ka unifikuar gjërat.

Ka ardhur koha që t'i shmangemi njëtrajtshmërisë, sepse kjo formë në aspektin afatgjatë ndikon shumë negativisht në perceptimin gjithë shoqëror.

Pensionistëve mund t'ju them se kam besim të plotë se çështja e tyre nuk do të neglizhohet nga kjo Qeveri, por do të trajtohet me seriozitet dhe do të bëhet gjithçka që është e mundur që situata e tyre të shënojë përmirësime në vazhdimësinë e proceset e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Do ta filloj diskutimin tim me një thënie të Hemingueit, e cila thotë: "Pensionimi është fjala më e shëmtuar në fjalor", ndërkaq unë do të shtoja se nuk besoj se vlen ndokund më shumë se te ne, kjo thënie.

Me arritjen e moshës së pensionimit, individit si qenie shoqërore duhet të pajtohet me statusin e rendit të dytë në shoqëri apo edhe më keq si në të shumtën e rasteve në shoqërinë tonë, me statusin e rastit social.

Këtu rrethana dhe fakti se medoemos i pensionuari shndërrohet në barrë për njerëzit përrreth, kanë efekt negativ psikologjik që rezulton pastaj dëmshëm edhe në shëndetin fizik të individit.

Prandaj, nuk është për t'u befasuar me thënien se pensionimi vret më shumë njerëz se sa që ka mundur ta bëjë ndonjëherë këtë puna e rëndë.

Shtrohet pyetja- A duhet të jetë pensionimi shpërblim për punën e rëndë që është bërë një jetë të tërë, apo duhet të jetë dënim për këtë?

Në rastin e pensionistëve kosovarë, pa asnjë dyshim se është një dënim, madje, dënim shumë i rëndë. Mundi dhe djersa e derdhur në vitet e rinisë i është kthyer me përbuzje, denigrim social, nëpërkëmbje, humbje të dinjitetit. Dhe jo nuk janë aspak patetike këto epitete, por janë reale madje, ndoshta edhe jo të mjaftueshme për të shprehur se si e ndjen veten një person që i ka kontribuar 40 vjet një shoqërie dhe sot në moshën e pleqërisë duhet të mendojë se a ka mundësi për t'i blerë ilaçet e domosdoshme.

I vetmi fat në këtë fatkeqësi është se te ne ende kultivohen vlerat e familjes dhe pensionistët mbështeten nga fëmijët e tyre, se përndryshe do të mbeteshin në mëshirën e fatit dhe do të përballeshin me luftën për mbijetesë.

Dua të theksoj se pikërisht këta pensionistë të sotëm ishin dje: mësues, mjekë, inxhinierë, juristë, ndërtimtarë, ekonomistë, gazetarë, politikanë, shkencëtarë, që secili në mënyrën e vet e hodhën nga një gurë në themelin e shtetit që e gëzojmë sot. Ndërsa, ata si kundërvlerë për kontributin e tyre shumëvjeçar morën pozitën në margjinat e shoqërisë dhe ndjenjën e njeriut të fyer që do ta bartin në supet e tyre deri sa të kenë jetë. Për të qenë korrekt është një moment kur zhvendosen nga margjinat e shoqërisë dhe vendosen në fokus, është kjo koha e fushatave elektorale, por premtimet që marrin mbesin vetëm shpresë, madje i lënë ata që ndihen edhe më keq, të tradhtuar.

Të nderuar deputetë,

Ashtu si kontribuuan këta njerëz për vendin e tyre dhe për një ardhmëri më të mirë në kohën kur ishin të rinj, ashtu të matur edhe me mentalitet shtet ndërtues që duhet të shërbejnë si shembull për shumëkënd, vazhduan të jenë edhe në periudhën e pasluftës.

Kërkesat e tyre gjithmonë ishin modeste duke qenë të vetëdijshëm për sfidat e vendit të tyre të dalë nga lufta, madje edhe kërkesat e këtij peticioni janë plotësisht të arsyeshme.

Jam e vetëdijshme që diskutimi im mund të tingëllojë shumë sentimental, por motivi është shumë racional, sepse konsideroj se trajtimi i tillë i kësaj shtrese të shoqërisë është pikërisht rezultat i mungesës së ndjeshmërisë së Qeverisë ndaj tyre. Po të ekzistonte kjo ndjeshmëri dhe qasja në raport me pensionistët gjatë planifikimit të buxhetit, do të ishte shumë më rationale. Qytetarët më shumë se për asfalt, kanë nevojë për kujdes rreth çështjeve elementare të jetës së tyre.

Prandaj, ne si Lëvizje për Bashkim, i përkrahim rekomandimet e Komisionit që janë rezultat i peticionit, të nënshkruar nga pensionistët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja, Donika Kadaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Ndoshta ne po dalim ngapak prej teme po me të vërtetë po nxitemi. Unë tash s'po kuptoj, deri tash, megjithatë ishte një person përgjegjës, tash shkoi edhe ai ministri dhe erdhi ministri i Infrastrukturës. Njerëzit të cilët duhen të dëgjojnë këtu se çka po flasin deputetët dhe me i marrë rekomandimet e tyre, sepse me gjithë respektin i nderuari kryetar, ne nuk mund të dalim nga kjo zgjidhje përderisa ai që është përgjegjës për këtë nuk vjen këtu të dëgjojë dhe të gjejë zgjidhje.

Prandaj po kthena te ajo se u tha disa herë po thuaj se u konsumua debati, mirëpo nga ajo çka Qeveria ka afruar deri më tash dhe çka dëgjuam nga ministri, vazhdon me qenë fakti që pensionet deri sa kjo Qeveri të jetë në pushtet, do të sillen nga 50 deri në 100 euro. Nga një llogari e thjeshtë del se një pensionist brenda ditës duhet të jetojë më 1.66 centë dhe me këtë duhet të blej: bukë, ilaçe, drutë, të paguaj rrymë, ujë dhe taksa të tjera. Dhe

në rast të sëmundjes, që është krejt normale për moshën e tyre, për shembull të problemeve kardiake, që është shumë e zakonshme në moshën e tyre, ata duhet të paguajnë edhe për kardiografi që kushton rreth 800 euro edhe për stenda që iu kërkojnë rreth 4000 – 5000 euro edhe pesmejker që në QKU i lypin 2000 euro ose përndryshe nëse nuk kanë, vdesin. Domethënë, këtë u ofron sot Qeveria Thaçi. Mos të harroj se ju ka ofruar edhe një memorandum që nuk kam qare pa e përmendur, sepse është i shkruar dhe thotë: “Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes të Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës dhe PDK-së ka qenë se nëse kjo parti politike arrin në pushtet të japë mbështetje të plotë për pensionistët” Me këtë rast Hashim Thaçi ka premtuar se deri më 31 maj 2008, do të aprovohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës, Ligji mbi sigurimet pensionale dhe invalide, e ka thënë ai kryeministri, nuk po e themi ne.

Sot ai nuk është këtu, që të japë llogari për të thënat dhe të pavërtetat që i ka thënë, i ka premtuar dhe nuk po i mban, sepse sa herë që vjen në pushtet Qeveria vetes i jep prioritetet të tjera dhe mashtrimin e bën me çdo kusht për të ardhur në pushtet, pa zgjedhur metoda, madje edhe duke mashtruar pensionistët me qëllim të marrjes së votës së tyre. A është e mirë e pavërteta të cilën e kanë sjell përmes këtij dokumenti gjatë fushatës e që quhet memorandum? Nuk është e mirë. Ne duhet me lypje llogari, sepse jemi deputetë dhe këtë po e bëjmë, po skemë askujt t’i lypim llogari, i nderuari kryetar, sepse sot këtu nuk janë njerëzit të cilët janë përgjegjës. A është mirë që i keni mashtruar për t’iu marrë votat dhe sot shumë paskrupullt keni ikur nga Kuvendi kur duheni me u ballafaqua me këta njerëz? Nuk është mirë. A është mirë që po kërkon që njerëzit që janë këtu, deputetë të Kuvendit të Kosovës, përmes projektligjit i cili fatmirësisht është tërhequr, po i cili po shpresoj pas këtij debati nuk guxon të sillat pa ndryshime edhe pse nuk jam fortë optimiste pas asaj se çka dëgjova nga ministri Rashiq, i cili shkoi. Po vazhdon qasja mashtruese ndaj pensionistëve dhe kërkon që këta asistencë sociale të votohet dhe të jetësohet nga ana e Kuvendit. Unë mendoj që nuk guxon me ndodhë kjo.

Përsëri do t’i kthehem Kuvendit dhe me qëllim të ngritjes së kërkesave të pensionistëve të cilat i kemi marrë, unë mendoj që duhet bashkë si Kuvend të dalim nga kornizat e interesave të ngushta partiake dhe të votojmë për ndryshimet siç është, të rishikohet kategorizimi dhe të bëhet përmirësimi i skenave që pensioni mesatar të jetë i barabartë me 60% të pagës mesatare në Kosovë, që përveç pensionit bazë, pensionistët të kenë lehtësira tjera shtesë të cilat lidhen me kujdesin shëndetësor dhe funksionimin normal. E di që do të thonë prapë që ka pengesa me FMN-në dhe Bankën Botërore, por këto institucione nuk janë prej sot, është dashur me ditë që ka me pas pengesa edhe atëherë kur këta njerëz janë shfrytëzua për qëllime të tjera.

Gjithashtu, me theks të veçantë do të përmendja bisedimet që po ndodhin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, edhe pse përsëri personat përgjegjës nuk janë këtu. E dimë që Kosova kishte një fond pensionesh, i cili është tërhequr nga administrata serbe, në përfundim të luftës. Do të ishte më e rrugës dhe më e mbarë që në vend që sjellim fusnota të ndryshme, të sjellin një vendim apo një marrëveshje e cila do të bënte që Kosovës t’i kthehet ky fond pensional përmes së cilit këta njerëz e që janë, a janë 120 mijë, 150 mijë apo 170 mijë, nuk ka rëndësi, janë prindërit tanë, të cilët e kanë shkrire

jetën e tyre në shërbim të këtij vendi, të mund të jetojnë me dinjitet dhe të mund të vdesin me dinjitet? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Mendoj se është shumë mirë që sot po bëjmë një debat të tillë, megjithatë është mirë vërtet që të përqendrohemi në situatën konkrete dhe në mundësitë konkrete, në mënyrë që të ofrojmë zgjidhje. Në këtë drejtim i përkrah propozimet e kryetarit të Kuvendit, sepse, natyrisht që ne mund të përdorim një debat të nxehtë politik edhe të akuzave, por problemi duhet të zgjidhet, ka pasur mundësi të zgjidhet, por qasja ndaj këtij problemi nuk ka qenë serioze.

Sistemi ekzistues i pensioneve nuk është fajtor për këtë situatë, domethënë sistemi i ndërtuar në bazë të praktikave të avancuara, në pajtim me parimet e ekonomisë së tregut nga viti 2001 dhe 2002 e këndeje, është një sistem pra që i valorizon këto praktika dhe ai paraqet një shkëputje radikale nga ish sistemi Pays you go, ku kontribuuesit real financojnë pensionistët. Kjo është një zgjidhje e mirë për ata që kontribuojnë në Fondin e Pensioneve, së paku për 10 vite, sepse rritet vlera e tyre edhe në këtë mënyrë shoqëria nuk vjen në krizë që t'i servisojë pensionistët. Mirëpo, ky ligj ka dështuar, sepse edhe nuk e ka adresuar problemin e pensionistëve të sistemit të kaluar.

Në këtë drejtim ky problem mbetet i pazgjidhur, pra për 12 vite edhe mendoj se ka qenë një neglizhencë e panevojshme që ky problem të mos zgjidhet. Vendet tjera që kanë inkuadruar sisteme të ngjashme me sistemin tonë të pensioneve, sikurse që janë Sllovenia apo Maqedonia, kanë gjetur zgjidhje specifike për ish pensionistët ose për ata njerëz që janë në punë, por shkojnë në pension në disa vitet e ardhshme, domethënë, të zëmë për 5 vite, kanë gjetur zgjidhje duke ruajtur një formë të kontributeve, duke ruajtur një formë të solidaritetit. Në Kosovë kjo asnjëherë nuk është trajtuar në mënyrë serioze edhe pse pensionistët gjithmonë kanë bërë kërkesa dhe kanë bërë ankesa.

Në këtë drejtim gjithmonë në Kosovë është adresuar ky problem tek fondi i uzurpuar i ish sistemit të pensioneve, fondi i uzurpuar i Kosovës në vitin 1990, jo më vonë, domethënë ky fond është uzurpuar prej vitit 1990 dhe është konsideruar se atje këta duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre, por pensionistët, nuk mund të komunikojnë me regjimin serb dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre. Ata janë qytetarë të Kosovës dhe Qeveria e Serbisë, natyrisht që, me qenë se ka uzurpuar fondin, është përgjegjëse për këtë problem, por Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës dhe institucionet janë përgjegjëse për pensionistët e Kosovës dhe duhet të gjejnë zgjidhje.

Sa i përket këtij fondi të pensioneve, i uzurpuar nga Serbia, mendoj se duhet të informojmë Kuvendin sot se ky problem është adresuar në bisedimet e Vjenës dhe është prezantuar në bisedimet e Vjenës, kur janë bisedua nga grupet e ekspertëve, çështjet e spastrimit të llogarive ekonomike dhe llogarive tjera midis Serbisë.

Sipas analizave që janë bërë atëherë, në bashkëpunim me dy organizatat e pensionistëve dhe ekspertët, dëmet ndaj pensionistëve dhe Fondit të Pensionistëve deri në vitin 2005, kanë qenë 825 milionë dhe këto, 146 milionë dëme nga kontributet e fondit dhe asetet e Fondit, ndërsa 679 milionë borxhe ndaj pensionistëve të Kosovës, nga ai fond.

Prandaj, edhe unë plotësisht mendoj se kjo çështje pa të drejtë neglizhohet që të shtrohet në bisedimet teknike në Bruksel. Kjo ka mbetur çështje që duhet të trajtohet. Dhe plotësisht i përkrah ato diskutime që duhet të trajtohen, por ne edhe pensionistët nuk mund të presim derisa Kosova të zhvillojë dialogun me Serbinë dhe t'i bëjë këto zgjidhje për arsye se ne i dimë se Serbia asnjëherë nuk do t'i përgjigjet seriozisht kësaj në qoftë se nuk detyrohet. Mendoj se kjo është edhe çështje e reciprocitetit. Ne po e këqyrim reciprocitetin bërë disa çështje triviale apo banale, por çështjet e reciprocitetit me Serbinë, kanë një dimension shumë më serioz se sa që disa e mendojnë.

Në këtë drejtim, në ndërkohë ne duhet të gjejmë zgjidhje, zgjidhje të caktuar, e ato zgjidhje kanë të bëjnë jo me 120 mijë pensionistë, siç flitet këtu, kanë të bëjnë me 35 mijë deri 40 mijë njerëz, 30 mijë deri 40 mijë njerëz, të cilët prej 80 eurove ose 45 eurove, duhet të ju krijohet një pension dinjitoz.

Në këtë drejtim mendoj se kryetari i Kuvendit me të drejtë e ka përmendur sot një burim të cilin ne në analizat ekonomike derisa kam qenë në **Riinvest** e kemi theksuar shpesh, Fondi i Privatizimit duhet të destinohet me një pjesë të tij për të ngritur këto pensione, sepse këta pensionistë e kanë një kontribut në asetet që po privatizohen dhe gjithsesi ky duhet të jetë një burim.

Burimi tjetër, siç e përmendi edhe kolegu Sabri Hamiti, mund të jetë edhe një solidaritet, ai solidaritet mund të krijohet me një taksë të posaçme, qoftë në alkool, qoftë në duhan, qoftë në karburante duke i zëvendësuar disa tjera dhe mendoj se kjo çështje duhet të zgjidhet përfundimisht. Është bërë e tepërt që ne të bëjmë një retorikë shterpë, po, po një luftë politike rreth kësaj çështje.

Ky Kuvend duhet ta mbajë veten përgjegjës që të zgjidhë këtë çështje, për arsye se tash ne kemi një diskriminim të këtyre njerëzve dhe ky Kuvend e ka tërë pushtetin, tërë përgjegjësinë, tërë obligimin që të evitojë diskriminimin ndaj pensionistëve. Dhe mendoj se duhet patjetër të gjendet një zgjidhje, konkluzat janë të mira, a do të jetë 60%, a 70%, a 40%, kjo duhet të shihet pas shqyrtimit të këtyre burimeve për të cilat folëm, po mendoj në mesataren e pagës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që fillimisht t'i falënderoj edhe përfaqësuesit e Shoqatës së Pensionistëve që janë sot këtu dhe janë më meritoret që ka ardhur edhe kjo çështje në debat, me kërkesën e vazhdueshme që problemi i tyre të trajtohet.

Fillimisht duhet të theksojmë edhe një herë që njëra nga projektet që Qeveria në janar të vitit 2008 ia ka bartur Qeverisë Thaçi I, për t'i respektuar marrëveshjet dhe obligimet që ka pasur edhe proceset që kanë ndërmarrë, ka qenë që shkalla e rritjes së pensioneve sipas rekomandimeve të Bankës Botërore, të respektohet, po kjo ka ndryshuar, për arsye që prioritet i është dhënë rritjes së rrogave sektorëve të tjerë. Sektori i parë në të cilën është ... që është ndërruar, sektori i energjisë, sektorë të tjerë edhe te pensionistët është parë që nuk ka nevojë dhe si i tillë është ndërruar dhe pas 4 vjetëve ne po flasim pse është ndërruar, sepse sikur të respektohej shkalla e ngritjes çdo vit sipas këtyre rekomandimeve, sot gjendja ish më tjetër.

Nën dy, bisedimet e Vjenës kanë përfunduar dhe profesori Mustafa e përmendi edhe njëra nga çështjet që është lënë, e tjetër çka që Serbia nuk e ka pranuar Pakon e Ahtisarit, ka qenë që Kosova dhe Serbia, çështjen e Fondit Pensional dhe problemet e Fondit Pensional t'i zgjidhin në biseda të drejtpërdrejta, pas zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Serbia e ka refuzuar, se ka pranuar se si i tillë ka mbetur i hapur dhe është parë që nuk është njëra nga prioritetet, por në Vjenë, në nivelin më të lartë, ekspertë më të mirë që Kosova i ka pas se njëri nga ata u tha profesori Mustafa ka qenë, është që ne fondin akt e kemi paraqitur, Fondi Pensional i Kosovës ka filluar të degradohet të plaçkitet nga viti 1990. Serbia i ka afruar shënimet e saja se sa pensionistë prej vitit 1990 deri 1999 i kanë marrë mjetet edhe ata i kanë shënimet.

Kështu që gjithçka një ditë do të barazohet, po problemi është që numri më i madh i pensionistëve që kanë qenë dje gjallë, që kanë pasur të drejta sot nuk janë, dhe ne duhet të jemi falënderues, sepse puna e tyre dhe angazhimi i tyre Kosovën deri në këtë shkallë e kanë zhvilluar apo e ka bartur në këtë gjeneratë që është sot.

Ministri Rashiq e dinë shumë mirë që partneri social më i rëndësishëm i çdo vendi edhe në Kosovë janë pensionistët. Unë kam bërë ftesë publike që dialogun social të hapet nga ana e Qeverisë nivel më të lartë. Sot kryeministri është në udhëtim zyrtarë, 6 zëvendëskryeministrat e tij nuk janë këtu, sepse këtë problem, këtë debat nuk e shohin të rëndësishëm, nuk u intereson dhe e kanë lënë vetëm ministrin Rashiq, që çështjen e pensionistëve ta trajton apo ta dëgjojë. Nëse ministri Rashiq debatin e dëgjon me qasjen që e filloi në fillim, atëherë pensionistët duhet ta dinë që kjo Qeveri nuk e ka ndërmend që t'ua zgjedh problemet para vitit 2016, sepse propozimi i tij është që në vitin 2016, të fillojë zgjidhja e problemit të pensionistëve.

Kontributdhënës dhe zhvillues të Kosovës kanë qenë kjo gjeneratë që sot s'ka të drejtën në Kosovë. Unë jam solidar me ta, jam njëri nga deputetët që do të angazhohem maksimalisht që kjo çështje e tyre të zgjidhet drejt dhe kur ka vullnet politik, mos harroni, kur ka vullnet politik zgjidhet. Ne u kemi dhënë pension pjesëtarëve të TMK-së, në disa raste me ligj të veçantë, ne i u kemi bërë pension e për minatorëve të Trepçës, ne i kemi bërë pension kategorive të caktuara që kanë dalë pasluftës, ne i kemi dhënë

pension kujt kemi dashur me vullnet politik. Po mungesa e vullnetit politik edhe prioriteti i kësaj Qeveria nuk po e zgjidh këtë problem. Nga buxheti i drejtpërdrejt katër kategori kanë marrë pension dhe zoti Muja i përmendi. Vetëm që tha duhet me bë një fond të përbashkët dhe duhet mu zgjedh kjo çështje. Atëherë kur Kosova ka vendosur prioritet, ju ka dhënë pensione kujt ka dashtë edhe 30 vjeçarët kanë marrë pension, se është demilitarizuar nga UÇK-së edhe 35 vjeçari është demilitarizuar nga TMK-ja, ka marrë pension edhe minatorët që janë gjeneratë e dhimbshme, po ashtu edhe ata e kanë marrë një lloj pensioni për ta kaluar këtë problem.

Atëherë duhet me i vendos në rrafsh të drejtë edhe me ja bë një vlerësim të drejtë dhe dialogun social duhet me hapë ministri e jo me pru në Kuvend. Ministri duhet me bisedua natë e ditë me shoqatat e pensionistëve, me këto grupe të veçanta të popullatës tonë dhe me gjet një zgjidhje e cila jep formë ligjit dhe rregullohet me ligj. Nuk ka rrugë tjetër, nuk ka formë tjetër, nëse vazhdoni me mbajt dialogun social me sindikalistë vetëm edhe me ble qetësinë sociale, me ble duke ju premtuar, një ditë kjo qetësi sociale kthehet në bumerang dhe natyrisht ky kthim nuk do të jetë i lehtë, sepse është, do të jetë i dhimbshëm edhe për opozitën. Opozita e sotshme ka qenë në qeverisje deri në janar të vitit 2008, i ka dhënë qasje po sa i ka dhënë dhe bazën e ka vendosur.

Avancimi i këtyre të drejtave nuk është realizuar dhe fajtoje ekskluzive mbetet kjo Qeveri sot e cila vazhdon me hudh fajin të qeveritë të kaluara që nuk qëndron. Ne e kemi themeluar bazën, e kemi bërë skemën dhe kemi kërkuar që me gjet një zgjidhje tjetër. Nuk është respektuar shkalla se sot pensionistët me atë shkallë të Bankës Botërore që Qeveria e ka pranuar, sot pensionistët e kishin 150 euro të ardhura mujore. E kanë thyer atë parim dhe i ka vendosur duke u thënë që ne kemi për t'ua zgjedhur për 6 muaj, për 5 vjet, për 2 vjet. Propozimi i juaj për këta pensionistë që sot janë këtu është viti 2016, dhe kjo duhet bërë e qartë. Ne po ju themi, kapeni ligjin në dorë, uluni me shoqatat e pensionistëve, diskutoni, gjeni zgjidhjen, sepse nëse ka vullnet ju mund ta bëni një zgjidhje dhe unë si deputet do ta mbështes nesër çfarëdo forme që vjen. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Replikë, Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Zoti, kryetar,

Unë në fillim të hyrjes në emër të Partisë Demokratike dhe Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kur u mundova të sqaroj, nuk desha ta politizoj këtë çështje, por për opinion duhet të sqarohet që kjo kërkesë është nga Partia e Pensionistëve të Kosovës që vjen si rekomandim dhe mendoj që Komisioni. Dhe është një kërkesë tjetër në Qeverinë e Kosovës nga Bashkimi i Pensionistëve të Kosovës, e cila është organizata kryesore me disa amendamente shtesë për ligjin. Dhe duke parë këtë arsye marr shkas që frustrimi që të politizohet kjo çështje për çështje politike siç thatë edhe ju edhe po i dëgjoj shumë bashkë deputetë këtu, më jep të drejtën të kuptoj se nuk e kuptojnë sistemin fiskal. Kur thashë që mekanizmat monetar që i mungojnë Republikës së Kosovës dhe shkëputja e fondit e cila ka ndikuar, ne nuk jemi duke fol që kemi ndërpre, nëse janë mjetet financiare në kuletën e buxhetit të Republikës së Kosovës, le të na tregojnë, është duke i fshehur dikush apo jo, por politikat fiskale të Republikës së Kosovës nuk janë autonome dhe ato

duke mos qenë autonome në një krizë të tillë globale që dikush këtu përmendi edhe problemin kur thashë që kemi një fatkeqësi dhe fat në këtë situatën ekonomike të krijuar globale, ne hiq më larg se sa dje Fondi Monetar tha u rrit edhe vlera e energjisë, e naftës, që ajo do të ketë direkt manifestim edhe në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pensionistët kanë qenë shqetësim, vazhdojnë të jenë shqetësim dhe ligji duhet të miratohet patjetër. Unë propozova që krahas ligjit që do të ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikën, përcaktoni fjalët, ne vazhdojmë më tej.
Fjalën e ka deputeti, Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Shpresoj që ky debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës në Republikën e Kosovës, të jetë në funksion të kontributit të mundësive dhe alternativave në shërbim të kësaj kategorie të ndjeshme të shoqërisë.

Ne jemi përgjegjës për të bërë ligje të cilat do ta rregullojnë në formën më të mirë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve tanë të gjitha shtresave. Por, në kuadër të kësaj, në forma të ndryshme herë të pavetëdijshme e shumë herë të pa përgjegjshme, shfrytëzohen apo përdoren nga politika kategoritë e ndjeshme të shoqërisë si mjet për të bërë propagandë politike ndaj palës tjetër.

Ndërsa ana esenciale, siç është zgjidhja e çështjes mbetet jashtë vëmendjes, shumë herë për arsye të qëndrueshme, fatkeqësisht nuk e përjashtoj edhe neglizhencën.

Natyrisht se shumë gjëra varen nga faktorët e zhvillimit ekonomik të vendit. Përkundër rritjes së vazhdueshme ekonomike Kosova ka filluar vonë të zhvillohet dhe të krijoj një stabilitet të rritjes së qëndrueshme, andaj edhe rritja e mirëqenies sociale të familjeve apo pensionistëve në veçanti, është reflektim i kësaj situatë.

Kategoria e pensionistëve, pa dyshim se është njëra nga kategoritë e ndjeshme të shoqërisë sonë, a e meritojnë një ligj më të mirë pa dyshim se po, a meritojnë pensione më të mira, pa dyshim se po, a ekziston dëshira të gjithëve shpresojmë se po, se ne të gjithë i kemi pjesë të familjeve tona ata?

Duke pasur parasysh mundin e tyre një jetë të tërë, ku shumë prej tyre jetën kanë pasur mbijetesë për shkak të kaluarës së këtij vendi dhe sistemit që ishte aplikuar në të.

Duke përfshirë këtu moshën jetësore dhe pamundësinë e tyre për të bërë diçka për veten, janë të kuptueshme vështirësitë e kësaj kategorie në mungesë të një ligji, i cili do të krijonte lehtësira të tyre për: rrymë, ujë, nxehje, kontrollat mjekësore, transport, pajisje

për invalidë e marrjen falas të barërave esenciale për ta edhe benifite të tjera që aplikohen në shtetet bashkëkohore.

Është e natyrshme se mungesa e fondeve pensionale e vështirëson situatën shumë për të menaxhuar me këtë kategori. Kjo është shumë barë e madhe edhe për buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Gjetja e një konsensusi edhe me FMN-në dhe Bankën botërore dhe gjithë akterëve tjerë vendimmarrës për t'i trajtuar me dinjitet këtë kategori, është domosdoshmëri dhe përgjegjësi institucionale e të gjithëve, si e atyre që janë në Qeveri, edhe pjesës tjetër,

duke përfshirë Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në veçanti, Parlamentin si organin më të lartë dhe Komisionin përkatës në të.

Të shfrytëzohen të gjitha kapacitetet për të bërë ligjin me standarde evropiane që përfaqëson denjësisht këtë kategori duke përfshirë edhe rritjen e pensioneve.

Nëse u krijojnë jetë të dinjitetshme në këtë vend, gjyshërve, prindërve tanë. do të krijojnë një sistem vlerash për ne edhe për ata që do të vijnë pas nesh. Edhe kjo kategori e shoqërisë është një faqe e dukshme e saj se çfarë shteti po ndërtojmë ne. Kjo është përgjegjësi e të gjithëve bashkërisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Japim pauzë deri në orën 15:00

* * *

(Vazhdon seanca pas pauze)

(Drejton seancën nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë dhe deputete,

Po vazhdojmë me seancën.

Deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky debat pa dyshim se është i qëlluar kur kemi të bëjmë me një shtresë të shoqërisë e cila fatkeqësisht ka ngelur shumë prapa. Jeta e një pensionisti në Kosovë është jeta më e rëndë që mund të jetohet.

Të nderuar,

Ne kemi mbi 120 mijë pensionistë, mbi 120 mijë nëna, baballarë, motra apo vëllezër të cilët sakrifikuan me vite në çdo lloj forme që ne sot të kemi një shtet, që ne sot të flasim në këtë Kuvend, po që edhe ne sot të bëjmë diçka konkrete për ta. Pa dashur të jem kritike ndaj një qeverie apo tjetre, pa dashur të nxis debat me akuza dhe kundër akuza,

unë sot kam një lutje për të gjithë ne. Ju lutemi të mendojmë seriozisht për problemet e tyre dhe në vend se të hyjmë në garë se cila parti po ja kalon tjetrës, të punojmë bashkërisht që të përmirësojmë sadopak jetën e vështirë të pensionistëve të cilët radhiten ndër kategoritë më të rrezikuara të shoqërisë sonë.

Është turp për të gjithë ne nëse këtë shtresë të shoqërisë e përdorim vetëm për fushata elektorale sa për t'i arritur qëllimet tona politike.

Kosova radhitet në vendet e fundit nga shtetet e ish Jugosllavisë, për sa i takon trajtimit të pensionistëve. Nuk mund të paramendoj që mundi dhe sakrifica e viteve të tëra, sot të këta njerëz shpërblehet me 45 deri 80 euro.

Kosova kishte një fond i cili është tërhequr nga administrata serbe, në fund të luftës, do të ishte më e drejtë sikur kjo problematikë të shtrohej në dialogun me Serbinë dhe ai fond t'i kthehet Kosovës, duke sanuar sadopak gjendjen e rëndë të pensionistëve.

Puna dhe djersa e pensionistëve nuk është dhënë që sot të jepet një lloj lëmoshe mbi ta, por puna dhe djersa e tyre ishte sakrifica më e madhe në vitet më të rënda që kaloi shoqëria jonë.

I njëjti angazhim i nevojitet edhe invalidëve të punës, të cilët në vendet e tyre të punës kanë lënë pjesë trupi dhe sot nuk e gëzojnë siç duhet aq lirinë e fituar me mund e sakrificë.

Asistenca sociale që ata e marrin u pamundëson blerjen e ilaçeve, e lere më sigurimin e gjërave të veçanta që i nevojitet për një jetë më të mirë.

Nuk mendoj se duhet zgjatur për më shumë, sepse problematikën e njehni të gjithë dhe gjendja e tyre e vështirë nuk mund të pasqyrohet me një debat. Por, të jemi të sinqertë dhe konkret, të mendojmë se pensionistët dhe invalidët e punës na ndjekin përmes ekranit, me një pikë shpresës se do të bëjmë diçka të mirë për ta. Atyre nuk i nevojitet garë e debateve politike, nuk i nevojitet as triumfi i njëjës parti apo tjetrës, por atyre më shumë se kurrë i duhet zgjidhja për një jetë më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zonja Afërdita Berisha – Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pensionistë,

Kategoria që ka nevojë më së shumti për përkujdesjen e shoqërisë, janë pensionistët e Kosovës. Ata janë të pakënaqur me shoqërinë e në veçanti me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe me Qeverinë e Kosovës, të cilët po thuaj se i kanë harruar fare.

Ata kërkojnë nga Qeveria e Kosovës një trajtim më ndryshe, më mirë kuptohet. Dikur këta pleq kanë punuar dhe e kanë ndërtuar këtë vend, ata vazhdimisht kanë folur, por për çudi, nuk është vepruar asgjë.

Ne i dimë përafërsisht problemet dhe mundësitë e buxhetit të Kosovës, por si u gjetën mjetet për rritjen e pagave të punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë, administratës publike e të tjerëve? Edhe pse pensionistëve me dhjetëra herë u është premtuar rritja e pensioneve, natyrisht kjo është bërë para fushatës së votimeve.

Lirisht mund të thuhet se pensionistët apo banorët e Kosovës që kanë pasur fatin t'i mbushin 65 vjet, nuk janë të kënaqur me ditët e tyre të pleqërisë pasi që pensioni nuk u siguron atyre as gjërat elementare, ushqimet dhe barërat për mirëmbajtjen shëndetësore.

Vazhdimisht dëgjojmë nga Qeveria se prioritet do të jetë: arsimi, shëndetësia, lufta kundër korrupsionit, por asnjëherë nuk po përmenden edhe ndonjë nga problemet e rënda sociale, siç është çështja e pensionistëve. Edhe sikur të mos ishte obligim ligjor rregullimi i çështjes së pensionistëve, është obligim social dhe njerëzor që këtë çështje ta rregullojnë në mënyrë më adekuate.

Shtrohet pyetja, si mund të jetohet me 80 euro? Shumica e pensionistëve të vetmin burim e kanë pensionin, me këto mjete që marrin shumica e pensionistëve së paku 1 euro e shpenzojnë për barëra, 1 euro për bukë edhe për një litër qumësht. Ku janë mjetet për nevojat e tjera siç janë: rryma, veshmbathja e të tjera, e mos flasim edhe për personat me asistencë sociale që e kanë edhe më të vështirë?

Të shpresojmë se nuk do të zgjidhet kjo çështje mbas 10 - 15 viteve, kur më shumë se 50% e pensionistëve nuk do të jenë në mesin tonë. Prandaj, unë si deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne si Lidhje Demokratike kemi kërkuar të kthehet ky ligj me qëllim të hartimit të një ligji më të përshtatshëm për pensionistët e Kosovës. Edhe shpresojmë që të punohet në këtë drejtim dhe në skemën e re të pensionistëve, punëtorëve të arsimit t'u numërohet stazhi i punës 10 vjeçare ku ata mbajtën gjallë sistemin e arsimimit në Kosovë. Dhe mendoj që ka ardhur koha për të nxjerr një strategji zhvillimore për politikën sociale, sepse pa një strategji të mirëfilltë dhe zhvillim të harmonizuar ekonomiko-social nuk ka përparim të një shteti. Pra, zhvillimi ekonomiko-social janë dy anët e një medalje dhe kërkojnë zhvillim të balancuar në mënyrë që të mos e pengojnë njëra- tjetrën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë dhe kolege deputete,

Është një temë shumë sensitive, jashtëzakonisht e ndjeshme, shumë prekëse dhe pavarësisht prej aksentëve që dëgjuam tash, secili prej nesh e ka përjetuar rënd temën dhe nuk mjafton vetëm emocioni dhe ndjenja tash të shfaqet, të investohet këtu.

Unë për veten time do të fokusohem në kërkesën të drejtuar Qeverisë e cila duhet të përgatisë ligjin sa më shpejtë dhe ta bie në Parlament sa më parë dhe neve si duket është një disponim i përgjithshëm njëzëri ta kalojmë me formulime nga më të mundshmet, në bashkëpunim me ministrin e Financave dhe Ministrinë e tij, që këtë edhe mundësitë buxhetore të mbulohet gjithë ajo që kërkohet, të formulohet në këtë Kuvend dhe të mbështetet, ashtu siç u diskutua njëzëri dhe pa as më të voglën ikje prej obligimeve.

Unë për veten time një përshëndetje të veçantë dëshiroj t'ia përcjell pensionistëve këtu që janë të pranishëm, me keqardhjen që për momentin nuk mund ta trajtojmë në nivelin e duhur këtë nevojë të tyre për arsyet që i takojnë aspekteve ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Deri tash u përmendën shumë gjëra për çështjen të cilën po e diskutojmë sot, pra për gjendjen e pensionistëve në Kosovë. Dhe, unë mendoj që të gjitha këto që u thanë edhe shumë tjera që i kemi dëgjuar, natyrisht që nuk janë që po i dëgjojmë për herë të parë. Secili prej neve natyrisht që ka kontakt me një pensionist aktual dhe e din se në çfarë gjendje janë ata. Dhe nuk mendoj po ashtu që lotët e krokodilit këtu do t'i ndihmojnë ata, por ata do të ndihmohen me hapa konkret dhe vendime konkrete, gjë që edhe kanë kërkuar përmes peticionit të tyre.

Por, cilat janë ato çështje të cilat duhet të diskutuar? Deri tash nga disa diskutime i dëgjova këtu, por edhe nga ministri edhe përgjithësisht e dëgjojmë nga Qeveria e Kosovës, çështjen e mundësisë. Pra, si parimi kryesor ose baza kryesore, është mundësia, a kemi mundësi a nuk kemi mundësi? Dhe, natyrisht po që se nismi nga kjo qasje, atëherë kurrë nuk do të gjejmë kurrfarë zgjidhje, se përherë do të na mungojnë mundësitë. Pra, ne do ta dimë që mundësitë përherë do të jenë të kufizuara dhe është vullneti politik e çka është më me rëndësi parimi politik në të cilën ndërtojnë shtetin, ai që do t'i zgjedhë çështjet.

Unë mendoj që veçanërisht në çështjen aktuale që po e diskutojmë sot, pra në sistemin pensional të vendit, duhet të kemi parime, në bazë të cilave e ndërtojmë atë. Po që se nuk i kemi këto parime, atëherë përherë do të gabojmë dhe përherë do të na duhet të veprojmë siç kemi vepruar deri tash këtu në Kosovë, duke tentuar që të arnojmë me vendime ad-hoc aty për aty që të zgjidhim çështje të cilat kemi tentuar të paktën t'i zgjidhim kur kanë qenë para shpërthimit, por jo edhe që të zgjidhim çështje edhe të kemi zgjidhje afatgjate për to.

Dhe cili është parimi i parë? Parimi i parë është natyrisht solidariteti, pra nuk ka shoqëri e cila nuk bazohet në solidaritet. Dhe, natyrisht ne sot këtu në Kosovë kemi solidaritet, por e kemi një solidaritet të privatizuar dhe këtë duhet ta ndryshojmë. Cili është ky solidaritet i privatizuar? Sot kemi solidaritet në familje. Djali i ndihmon babës, apo vajza i ndihmon prindërve, dhe ky është solidariteti familjar, është i privatizuar, ndodh

përbrenda familjes, ndodh me ato mjete të familjes dhe ky natyrisht që është i mirë dhe është i domosdoshëm, mirëpo ky nuk është solidaritet shoqëror.

Dhe kemi tjetër lloj të solidaritetit, i cili po ashtu është i privatizuar kur e kemi e ky çmohet shumë lart nga mediat tona publike, veçanërisht nga RTK-ja, kemi parë shpeshherë në lajme, një biznesmen i pasur ia ndërton shtëpinë një të varfëri dhe kjo është po ashtu shumë mirë, shumë që një biznesmen i cili i ka punët mirë financiarisht, i ndihmon dikujt që ka nevojë për të. Po, megjithatë kjo është marrëdhënie private mes dy individëve, pra solidaritet i privatizuar, ne për ta ndërtuar shoqërinë, na duhet solidariteti i institucionalizuar dhe i bërë publik dhe ky solidaritet natyrisht që krijohet përmes ligjeve e përmes institucioneve që e garantojnë dhe kushtëzojnë një solidaritet të tillë. Pra në vend se t'ia lëmë vendimin një individi nëse ai ka vullnet që të bëhet i mirë dhe t'i ndihmojë dikujt tjetër, ne duhet këtë ndihmë dhe këtë si të them ashtu shpërndarje të pasurisë, prej njërit te tjetri, ta bëjmë të institucionalizuar dhe të obliguar dhe njëjtë siç po veprojmë me tatimet, duhet të veprojmë edhe me kontributet tjera.

Dhe cili është parimi tjetër që është i domosdoshëm për pensionistët? Parimi tjetër është që drejtësia, pra çështja e drejtësisë, duhet ta kemi parasysh një gjë, pensioni nuk është lëmshë dhe pensioni nuk është favor që pushteti ja bën pensionistit, pra duke u nisur nga ky parim ne e kemi parë se si Qeveria e Kosovës, vazhdimisht, jo vetëm kjo, por edhe të kaluarat, kreken me përqindjen e rritjes që i kanë bërë pensione. Pra, thonë i kemi rritur pensionet 25% e shihni se ne çfarë Qeverie e mirë jemi edhe sa dorëshirë jemi. Duhet ta kemi një gjë parasysh që pensioni është e drejtë dhe kur është e drejtë aty më nuk ka diskutim nëse Qeveria po do t'i ritë ato apo jo, por kjo e drejtë është e drejtë të cilën e gëzon secili pensionist dhe është e drejtë të cilën duhet ta realizojë secili pensionist. Pra, po që se i ikim këtyre dy parimeve në ndërtimin e sistemit tonë pensional, por edhe përgjithësisht të shtetit, atëherë natyrisht që do ta ndërtojmë një shtet i cili nuk do të jetë i joni dhe për ne, por një shtet i cili do t'i shërbej dikujt tjetër, kujtdo qoftë ai.

Një çështje tjetër që u dëgjua këtu e s'po kam qare pa e përmendur, është edhe çështja e financimit të Fondit Pensional. Pra, u propozuan disa mënyra të financimit të Fondit Pensional, njëra prej tyre ishte edhe prej Fondit të Privatizimit. Pra, një fond i cili potencialisht do të ishte fond i Kosovës, para të gatshme ta përdorim për t'i financuar pensionet. Kjo natyrisht po them që nuk ka asgjë të keqe në këtë, por duhet ta kemi parasysh një gjë, që ky fond do të shpenzohet. Pra ne duhet të krijojmë fonde pensionale të cilat financimin e kanë të garantuar edhe afatgjatë, jo të njëanshëm, se ati natyrisht që shpenzohet, pasi që t'i shpenzojmë këto 100 mijë euro prej privatizimit për pensione, çka do të bëjmë pastaj, ku do t'i marrim 100 mijë euro të tjera? Ne nuk mund ta ndërtojmë pasurinë tonë vetëm duke e bazuar në shitje. Pra, ne duhet ta ndërtojmë pasurinë tonë duke e bazuar në produktivitet, jo të shesim prona po të shesim produkte, të cilat pastaj na pasurojnë.

Shpenzimi i pasurisë aktuale, pa kurrfarë plani, për ta shtuar atë natyrisht na bën tamam si foshnje, vetëm mendojnë se si të hamë pa e qarë kokën fare se prej nga vjen ushqimi edhe si vjen ai. Pra, na vendos përjetësisht në atë që psikanaliza edhe Frojdi më saktësisht

e ka quajtur faza orale e zhvillimit të njeriut. Faza orale është faza e parë, kur fëmija vetëm do të hajë dhe nuk e qanë kokën fare prej nga po i vjen ushqimi, a ka ushqim, kush po e siguron atë ushqim? Ndërkohë që ne si shtet dhe si shoqëri duhet të mendojmë si ta krijojmë ushqimin dhe pastaj si ta hamë, kush po han dhe si po han.

Sistemi pensional ekzistues në Kosovë, u përmend këtu disa herë e ka bërë një prerje të menjëhershme nga sistemi i gjeneratave në atë të vetëfinancimit duke e lënë kështu anash një gjeneratë të tërë të pensionistëve ekzistues. Pra, sistemi aktual për këto vite nuk është zhvilluar në mënyrë adekuate duke lënë të krijohet një monopol mbi kursimet pensionale në Kosovë, që kanë rezultuar joefikas në mbledhjen e kursimeve nacionale dhe ka shkaktuar humbje të vazhdueshme të vlerës së parasë së investuar dhe nuk ka qenë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne si lëvizje “Vetëvendosje” besojmë që një sistem pensional të qëndrueshëm, solidar dhe të barabartë, i cili do të garantonte pensione stabile dhe të mjaftueshme, si për gjeneratat e ardhshme, ashtu edhe për pensionistët aktual, është e mundur ta ndërtojmë dhe përmbi këtë, është e domosdoshme ta ndërtojmë.

Pra, ne duam ta ndërtojmë një sistem pensional, i cili e forcon dimensionin solidar të sistemit aktual të pensionit nëpërmjet të cilit përmirësohen ndjeshëm situata e pensionistëve aktual. Po ashtu e zgjeron bazën e kontributeve dhe kontribut-dhënësve në fondin e pensioneve nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit dhe reformimit të tregut pensional si dhe e përdor Fondin Pensional në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit, pra ato kursime të cilat mund t'i gjenerojnë në Fondin Pensional t'i investojnë pastaj në ato resurse strategjike dhe sektorë strategjikë të cilët do ta zhvillonin vendin, do të krijojnë vende të reja të punës, pra në një farë mënyre do të krijojnë mundësi të krijimit të pasurisë e jo vetëm shpenzimit të saj.

Ne mendojmë që krijimi i një sistemi pensional të qëndrueshëm dhe të barabartë që garanton pensione stabile, të mjaftueshme dhe të dinjitetshme për dy kategoritë e pensionistëve ekzistues dhe gjeneratave të ardhshme, nuk është aq vështirë të bëhet siç po proklamohet nga Qeveria, është e mundur vetëm duhet ta kemi vizionin dhe vullnetin politik për ta bërë një gjë të tillë.

Reformimi i sistemit pensional duhet ta ketë për qëllim krijimin e një sistemi të mirëfilltë tri shtyllash, pra duke synuar zhvillimin dhe avancimin e sistemit pensional me një sërë masash do të krijojnë një sistem pensional të kombinuar të vetëfinancimit dhe solidar, i cili do të ishte i qëndrueshëm duke bërë tranzicion adekuat në mes të sistemit të gjeneratave dhe sistemit të vetëfinancimit. Ky proces do t'i përfshinte natyrisht në vija të trasha këto 5 hapa.

Pra në një, Ligji për sigurime pensionale dhe invalidore. Draftimi i një ligji të tillë do të ishte integruar dhe do të merrej me gjithë sistemin e jo që t'i kemi ligjet e ndara për sektorë ose pjesë shtylla të ndryshme të sistemit pensional. Pra, qasje të integruar në temë e jo të fragmentuar siç është sot.

Qe 12 vite ne nuk kemi qenë në gjendje si shtet dhe si institucione më mirë të them , që ta bëjmë një gjë të tillë, pra ta bëjmë një ligj i cili do t'i mbulonte të gjitha shtyllat dhe i cili do të garantonte integritet të këtyre shtyllave. Deri tash është dëgjuar disa herë dhe dëgjuam edhe sot që arsyetimi kryesor është barra buxhetore dhe ne mendojmë që po që se do të ndërtohej sistemi pensional sipas hapave tonë , atëherë kjo do të nënkuptonte që barra buxhetore në fakt do të zvogëlohej për pensione dhe si do ta ndërtonim këtë, natyrisht duke e propozuar, duke e futur një kontribut shtesë në sistemin aktual të pensioneve, pra përmes 5% të futet edhe një kontribut shtesë i cili do ta krijonte një fond të ri pensional, fond ky i cili do të bazohej në solidaritetin mes gjeneratave dhe do të paguajë pensione për pensionistët aktual të financuara këto nga ata qytetarë të Kosovës, të cilët sot janë të punësuar dhe të cilët kontribuojnë në këtë sistem. Pra, kjo nuk do të nënkuptonte që do të financoheshin vetëm pensionistët aktual, po me këtë fond do të financoheshin edhe pensionistët, gjeneratat e ardhshme të cilët dosido do të dalin në pension.

Kur ta kemi fondin e ndarë pensional, kjo ja pamundëson pastaj Qeverisë cilësdo Qeveri, që të luajë lojëra me pensionistët duke ju premtuar rritje të pensioneve apo ulje të pensioneve karshi nivelit të buxhetit edhe të hyrave buxhetore, për shkak se ky fond pensional do të funksiononte si i ndarë nga paraja publike, pra e buxhetit dhe si e tillë do të ua garantonte pensionistëve që pensionin ta gëzojnë si të drejtë dhe pensionin ta kenë të dinjitetshëm të garantuar dhe të një niveli të caktuar, nivel ky që do t'ua mundësonte atyre një jetë të dinjitetshme e jo një jetë çfarë e kanë sot buzë varfërisë.

Themelimi i Fondit Pensional po ashtu e ka një të mirë tjetër për shkak se do të ishte edhe një fond tjetër i kursimeve nacionale të cilët pastaj do t'i mund t'i përdornim në zhvillimin ekonomik të vendit.

Një çështje tjetër që duhet të ketë parasysh është edhe pastrimi i listës së pensionistëve, pra ky pastrim i listës së pensionistëve do ta determinonte qartë se kush është pensionist dhe sa pensionistë i kemi në Kosovë dhe do ta pamundësonte pastaj edhe mundësinë e cila ekziston aktualisht të keqpërdorimit të fondeve pensionale për ata persona të cilët nuk e gëzojnë një të drejtë të tillë.

Dhe pika e pestë, të cilën desha ta përmend, është edhe përshkallëzimi i llogaritjes së pensioneve. Ne aktualisht i kemi vetëm dy shkallë, dy shtresa të pensionistëve këtu

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pensionistët kosovarë vazhdojnë të përballen me një gjendje shumë të vështirë materiale. Pensionistët që aktualisht marrin një pagë jo të mjaftueshme për ekzistencë, me 45 euro

në muaj, sot nuk mund të blejnë as barëra për shërim. Me këto pensione në vlerë prej 80 euro, Qeveria në këtë mënyrë po fyen moralin e pensionistëve kontribut-dhënës.

Pensionistët dhe invalidët e punës së Kosovës, vazhdojnë të diskriminojnë nga të gjitha institucionet më të larta shtetërore të vendit, për faktin se nuk po përmbushen kërkesat legjitime të tyre, të cilat i kërkojnë tash e 12 vjet.

Gjendja e pensionistëve është mjaftë alarmante, po thuaj se në kufijtë e durimit, sepse atyre sot ju janë shterur të gjitha mundësitë institucionale për zgjidhjen e problemeve me të cilat ata po ballafaqohen me dita - ditës. Ata gjithashtu përveç pensioneve tepër të ulëta, po përballen edhe me mungesën e benificioneve për pensionistë dhe invalidë të punës, si për shembull në komunikacionin publikë në shëndetësi dhe në lami të tjera të jetës shoqërore.

Mendoj se deri më tani shoqëria e Kosovës ka dështuar në kthimin e të drejtës në pension, pensionistëve, invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensioneve familjare.

Kjo kategori e njerëzve të merituar në mesin e të cilëve: punëtorë, inxhinierë, profesorë, juristë, minatorë, artistë dhe akademikë, jo vetëm që injoruan u nënçmuan dhe u përbuzën nga kjo Qeveri, por mjerisht janë magjinalizuar, po injorohen, po nënçmohen dhe po përbuzen përtej çdo norme ligjore të moralit, të etikës njerëzore, duke u shkelur dinjitetin dhe uni i tyre stoik dhe duke i sjell ata pa të drejtë në skamnorë dhe lypsarë.

Njeriu gjatë gjithë jetës së tij punon me mund e djersë për të marrë një ditë dhe për tu shpërblyer me sakrificën e tij jetësore, por fatkeqësisht kjo Qeveri, përkundrazi asnjëherë nuk mendoi në interesat e tyre.

Këto kategori , pra pensionistët dhe invalidët e punës nuk po kërkojnë asgjë më shumë se sa t'u kthehet dinjiteti, ata nuk po kërkojnë lëmoshë por të drejtat e tyre të fituara me punë bazë ligjeve legale të asaj kohe. Kërkojnë kthimin e statusit të humbur dhe dinjitetin e tyre. Ata, gjithashtu po kërkojnë premtimet e dhëna gjatë fushatave elektorale që asnjëherë nuk u përmbushën. A thua atëherë a mendoi Qeveria e Kosovës se nuk kishte buxhet, kur sot ministri po mendon dhe po thotë duke dashur ta mbrojë këtë Qeveri, ku përgjegjës është edhe vetë ministri i cili nuk ka buxhet, por në ato momentet kur u bënë marrëveshjet asnjëherë nuk u mendua se a do të ketë buxhetin, por u premtuan dhe u lajt me dinjitetin e vet pensionistëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani poslanici, poštovani penzioneri,

Uzimajući u obzir preporuke Komisije i njenu zabrinutost za penzionere i invalide rada na Kosovu, kao i slušajući pojedine poslanike i njihovu zabrinutost za penzionere, pojedini poslanici pokušavaju da svojom političkom retorikom dobiju jeftino dnevno

političke poene, a ne uzimajući u obzir realno stanje i realne mogućnosti sadašnjeg penzijskog fonda u čemu je govorio ministar Rašić.

Usvajanje ovakve preporuke demantovali bi sami sebe za to što smo na početku godine, usvojili budžet, a budežet predstavljala realnu sliku našeg trenutnog stanja u kome se sada nalazimo.

Poštujući penzionere, moramo biti realni i ne izlaziti sa nerealnim obećanjima ispred njih, nego moramo biti prvo odgovorni i postupiti krajnije realno i reći da u ovom trenutku, usvajanjem ovakvih preporuka, nije realna slika naših mogućnosti i da moramo biti nažalost veoma strpljivi jer samo tako možemo doći do rezultata. Hvala!

KRYESUESI: Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, poštovani predsedavajući, Vladini predstavnici, Uvaženi gosti penzioneri koji danas pratite našu seancu, Poštovani poslanici,

Trebamo jako ozbiljno shvatiti Vladin predlog, odnosno predlog ministra Ministarstva za rad i socijalnu politiku, koji nam je prezentirao stvaranje jedne nove zakonske osnove koja se temelji na konstantno povećanje penzija koje će ići u kontinuitetu, a uz to poboljša će se ekzistencionalna mesečna primanja naših penzionera.

Ono što je još važnije za sve naše građane i naše države jeste to što ovaj novi zakon obezbediti svetliju budućnost novim generacijama penzionera, tako da ćemo u potpunosti podržati ovaj Nacrt zakona i u potpunosti glasiti za njega. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: I nderuar kryesues,
Ministër,
Kolegë dhe kolege,

Dikush tha se po diskutojmë për pensionet për herë të parë, nuk është e vërtetë. Për çështjen e pensionistëve dhe për pensionet është debatuar dhe është biseduar në çdo mandat, duke filluar në këtë Parlament pra, duke filluar nga koha kur në mënyrë lineare u vendos që të kemi pensione për të gjithë të moshuarit, 28 marka gjermane. Atëherë, assesi, asnjëri nga deputetët nuk është ndier mirë, sepse kjo nuk ishte as lëmoshë, por kjo ishte një mundësi e vetme.

Këtu kemi diskutuar kur edhe këto pensione u rritën dhe u bënë edhe 45 euro si bazë ose 70 euro. U diskutua edhe me Ligjin e propozuar, të ardhur në Parlament, kur u tha se për vetë kontribuuesit mund të ketë pensione 105 euro. E dimë se këto janë shumë pak dhe nuk e plotësojnë shportën e nevojshme dhe të domosdoshme dhe sigurisht që këto mjete hyjnë në ndihma sociale.

Deri sot institucionet tona nuk kanë arritur ta përmbushin obligimin shtetëror për pensionet dhe të drejtën e garantuar të njeriut, i cili kontribuon dhe në fund të moshës, e meriton atë që ka kontribuar. Kjo që është bërë, është minimumi i minimeve të mundshme dhe në kuadër të buxhetit që kemi, natyrisht i pamjaftueshëm.

Arsyetimet

Sigurisht, pensionistët nuk duan t'i dëgjojnë arsyetimet, por ato janë reale dhe shumë të vërteta. Koha shumë e gjatë e menaxhimit të institucioneve të Qeverisë, me shumë embargo, ka të bëjë edhe me moslejimin e themelimit të Fondit Pensional, pastaj kornizat e ndryshme, domethënë, që iu vunë shtetit dhe mos qasja ose keq këshillimi në qasjen e sigurimeve pensionale.

Vjedhja e Fondit, padyshim e fondit për të cilin të gjithë flasim dhe për të cilin pajtohem me disa kolegë që thanë se meriton një diskutim të veçantë, Fondit të vjedhur pensional, e që ka të bëjë me aparteidin, segregacionin, përjashtimin masovik të punëtorëve nga puna dhe sigurisht lidhet edhe me Pakon e Ahtisarit edhe me bisedimet që po zhvillohen dhe natyrisht me shumë probleme tjera dhe kryekëput lidhen edhe me të drejtat e njeriut.

Mos formimi i Fondit pensional, sigurisht ka ndikuar më së shumti. Trusti Pensional, nuk është fond pensional, ai është një kursim i detyrueshëm pa na pyetur askënd i cili nuk hynë në kuadër të gjithë kësaj që u tha. Në katër do ta kisha përmendur mungesën e një vizioni për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe këtu sigurisht mendoj se, në rend të parë në këtë vizion mungon njohja e politikës sociale që është një politikë më e rëndë se politika a jashtme, se politikat tjera ekonomike e tjera, e tjera. Sepse, mosnjohja e politikës sociale mund të kthehet si një bumerang në gjithë ata që mund ta kishin ndërtuar. Insistoj dhe i drejtohem ministrit që merret me këtë çështje, se Ministria për Çështje Sociale ka nevojë për ri trajnim dhe njohje më të mirë të politikave sociale, natyrisht kur i njeh ato dhe mund ta ngrisë edhe zërin dhe të gjejë mundësi për t'u zgjidhur ato.

Personalisht jam angazhuar gjatë këtyre, domethënë të gjitha mandateve që kam qenë në Komisionin për Çështje Sociale dhe jam ballafaquar me problemet e shumta sociale, në veçanti për problemin e pensionistëve dhe kujtoj që kur flitet për pensionistët, në rend të parë këtu as nga njëri nuk u tha mungon ligji bazik. Ligji bazik është Ligji për sigurimet shoqërore, ligj për të cilin askush nuk foli, e në të cilin ligj hyn edhe Ligji për pensionet, hyn edhe Ligji për formimin e fondit pensional dhe një mori ligjesh tjera.

Fondi pensional që tani shteti ynë duhet të marrë iniciativën dhe sa më parë të themelojë, dikush thotë se ne nuk kemi mundësi, nuk kemi bazë materiale. Unë them se kemi, sepse mund të mendojmë se mund të ishte fondi i grabitur që shumë vështirë të kthehet, por mund të jenë edhe paratë e Trustit, për të cilat duhet të vendos ky Kuvend, ndoshta pse jo të vendosim me një plebicit të qytetar në bazë të solidaritetit që ai të derdhet në Fondin e pensioneve, natyrisht të shkojë në favor të secilit që i ka kursyer.

Fondi i Privatizimit duhet të ndajë një pjesë të mjeteve që do të shkonin në fond, natyrisht Qeveria duhet të ndajë mjete, pse jo edhe të merr ndoshta edhe kredi të buta dhe të kërkojë ndihmë që këtë çështje ta zgjidhë më mirë.

Qeveria është vërtetuar se ka bërë përpjekje që pensionet në kuadër të mundësive të rriten, por edhe çështjes se pensione t'i qaset ndryshe. Për herë të parë ne kemi parë ndarjen e pensione në pensione bazike dhe në favorizimin e pensione të kontribuuesve, por ky propozim nga Qeveria, për fat të keq u refuzua nga vetë pensionistët dhe nga ky Kuvend. E them për fat të keq, sepse personalisht kam menduar se kjo do të jetë baza për harmonizimin e pensione të vetë-kontribuuesve, në bazë të viteve të punës, në bazë të përgatitjes profesionale dhe titujve që ata mund t'i kenë. Po e përsëris, pa Ligjin për sigurimet shoqërore, nuk ma merr mendja se mund t'ia dalim zgjidhjen e problemit të pensione.

Vendi ynë nuk ka mundësi, domethënë, t'ia dalë kësaj çështjeje ndryshe. Nuk ka mundësi as t'i përgjigjet kërkesave të pensionistëve që të drejtën në pension e kanë siguruar në shtetet tjera dhe tani në pleqërinë e vet duhet të kthehen në Kosovë. Ju keni parë problemin që ka lindur me pensionistët në Zvicër dhe kjo për arsye se pa Ligjin për sigurimet shoqërore, Ministria, Qeveria jonë nuk ka mundësi të lidhë kontrata ndërshtetërore, prandaj ky ligj duhet urgjentisht të vjen në Parlament dhe të nxirret. Është hera e parë që po i qasemi këtij problemi ndryshe.

Ky ligj, Ligji për sigurimet shoqërore na nevojitet edhe për shkak se është ligj obligativ edhe për integritet evropiane. I përshëndes të gjithë pensionistët të cilët më janë drejtuar, qofshin ata nga Gjakova, Prishtina, veçmas do t'i veçoj ata nga Mitrovica, të cilët kanë kërkuar që ta ngris zërin edhe në emër të tyre. Çështja dhe problemi i pensionistëve nuk është vetëm problem i pensionistëve, ai gjithsesi është problem i secilit prej nesh, i këtij Parlamenti, i Qeverisë, i Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, i zëvendëskryeministres, zonjës Edita Tahiri, është problem i shumë ministrive tjera.

Numri i pensione që ka Kosova, është ndër numrin më të vogël që kanë shtetet, sepse ne kemi pasur popullatë të re dhe kemi pasur një numër të vogël të njerëzve të punësuar. Më lejoni në fund të them se, të shpreh disa fjalë optimiste, kujtoj se ky problem ka zgjidhje. Duke qenë se punoj gjatë në çështjet sociale dhe e njoh këtë problematikë, qoftë si gazetarë kur kam punuar për 9 vjet me radhë dhe jam interesuar për problemet sociale, për pensionet, qoftë si deputete, unë kujtoj se zgjidhja ndodhet pikërisht në gjetjen e një vizioni ndryshe. Jam angazhuar si deputete që të nxjerr, të jap propozim -ligjin, të nxjerr një ligj të ri e që quhet ligji, domethënë, për sigurimet shoqërore duke u mbështetur edhe në përkrahjen e ekspertëve dhe besoj që ë së shpejti, këtë ligj do t'ia propozoj Kuvendit, si një iniciativë parlamentare, pasi të marr edhe pëlqimin e Qeverisë dhe kjo mund të jetë zgjidhja. Ju faleminderit! Kërkoj përkrahjen e juaj pasi të njoftohemi me këtë.

KRYESUSI: Ju faleminderit!

Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar nënkryetar, zoti Haliti,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Është për keqardhje pse për problemin dhe pozitën materiale të pensionistëve, sot po e debatojmë nën presionin e peticionit me 18.000 nënshkrime.

E them për keqardhje, me qenë se kjo çështje duhet të jetë preokupim i përhershëm, pasi që kjo gjeneratë i ka meritat e veta që Kosova të jetë këtu ku është tani. Por, pikërisht kjo gjeneratë nuk po i gëzon frytet e punës dhe kontributit që ka dhënë, për më keq, ata që punuan dhe paguan kontributet për 40 vite, tash kanë kategori sociale, meqenëse Qeveria aktuale, por as ato të kaluarat, asnjëherë nuk u morën seriozisht me këtë problem. U mjaftonte konstatimi se fondet e krijuara nga paratë e tyre u plaçkitën nga shteti okupues edhe me këtë, liroheshin nga përgjegjësitë që kanë.

Janë të qarta a problemet e trashëguara dhe se tash po ndërtohet një sistem i ri pensional, por po ashtu janë të dukshëm edhe problemet që ka buxheti për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të krijuara edhe pas premtimeve elektorale. Nga ana tjetër, na kujtohet vrap i partisë në pushtet, për votën e pensionistëve duke u premtuar plotësimin e kërkesave, përkatësisht se problemet e tyre do të zgjidhen një herë e për gjithmonë.

Ishin të interesuar për 182.000 vota, kurse premtimet u harruan menjëherë pas mbylljes së kutive të votimit. Nuk u bë asnjë hap drejt zgjidhjes së këtij problemi, vjet kur Qeveria e Kosovës miratoi rritjen enorme të pagave të punëtorëve dhe kishte premtuar se do të gjendet zgjidhje edhe për pensionistët, mirëpo nuk ndodhi asgjë.

Pensionistët u detyruan që në këtë moshë të shtyrë dhe shumica e tyre me shëndet të rrezikuar, të përdornin format e ndryshme të presionit, vetëm që hallet e tyre të debatohen në këtë Kuvend. Kam frikë se edhe ky debat do të bëhet me qëllim që formalisht të shqyrtohen kërkesat e pensionistëve, kurse do të mungojë zgjidhja konkrete, rritja e pensioneve dhe sigurimi i minimumit të kushteve për ekzistencë. E them këtë pasi nuk vërej ndonjë indikacion që më bind se Qeveria ka zgjidhje konkrete për këtë problem. Por, arsyetimi se duhet pritur Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, në të njëjtën kohë së paku sipas mediave, ajo është nën presion për reduktimin dhe shpenzimeve dhe kjo i frikëson pensionistët.

Këtë e kam vërejtur edhe gjatë takimit me ministrin Rashiq, i cili u ka premtuar një rritje prej 6 deri 21 euro, kjo është shumë larg kërkesave të tyre. Në këto rrethana, pensionisti kosovar mbetet më i varfëri në rajon me qenë se mesatarisht ai merr 65 euro në muaj, do ta bëjë një krahasim me vendet në rajon, ndërkaq ai në Shqipëri merr 145 euro në muaj, në Mal të Zi 290 euro, në Bosnje 170 euro, në Serbi 250 euro, në Maqedoni 162 euro.

Është vërtetë se këto vende nuk kanë trashëguar një situatë çfarë kemi pasur ne, përkatësisht se ato kanë ruajtur fondet dhe tash e kanë më lehtë të përballen me këtë problem. Mirëpo, edhe ne kemi pasur mundësi që me shumë para të ndajmë për çështje sociale, ndoshta duke marrë edhe ndonjë përqindje nga rritja e pagave që

ndodhin në vitin a kaluar. Ndërkaq, nga tabelat buxhetore del qartë se edhe për shumë vite nuk do të investohet më shumë në kategoritë sociale, sipas tyre sivjet për transfere sociale parashihen 247 milionë euro, në mot, në vitin e ardhshëm 252 milionë euro, kurse në vitin 2014, 258 milionë euro. Nga kjo del se në mot, këto ndarje do të jenë 25 më të larta, kurse në vitin 214, as 5%, përkatësisht vetëm 4.5%.

Nga kjo del se ndarjet buxhetore janë duke u bërë në dëm të kategorive sociale. Për të pasur më të qartë se sa të mëdha janë këto shpërputhje në krahasim me vendet e rajonit, po citoj një publikim të Bankës Botërore, nga shtatori i vitit të kaluar. Sipas tij, sigurimet sociale në shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në Kosovë, marrin pjesë 13%, ndërsa pagat 24.4%. Ky proporcion në Shqipëri, për sigurime sociale 29.3%, për pagat 18.1.

Në Maqedoni për sigurime sociale është 35.4% , kurse për paga i ndan 22.6%. Në Mal të Zi për sigurime sociale është 29%, kurse për paga është 23.5%. Edhe në Serbi për sigurimet sociale është 42.7%, e për paga është 22.6%.

Pra vetëm në Kosovë ndarjet për sigurime sociale janë dukshëm më të ulëta se ato për paga. Është e vërtetë se ne ende nuk kemi arritur të rumbullakojmë sistemin social dhe ende na mungojnë shumë ligje, por është e vërteta tjetër se shumë ngadalë po punojmë në këtë drejtim.

Kjo del nga dokumentet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila në mesin e pesë prioriteteve për sivjet ka edhe krijimin e një sistemi pensional të shtyllës të drejtë funksional me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga e drejta pensionale për të gjitha kategoritë e pensionistëve.

Kur e lexon këtë, duket mirë, por realiteti është krejt tjetër. Ende jemi larg nga ndërtimi i sistemit së gjeneratës së shtyrë, përkatësisht pensionistëve u garanton se në pleqëri të mos shndërrohen në lypsar .

Nisur nga kjo, unë them se kërkesa e pensionistëve që pensioni mesatar të jetë 60% e pagës mesatare është reale, ndërsa Qeveria e Kosovës duhet të dalë me ofertë konkrete për rritjen e pensioneve, ndërkaq gjatë këtij viti t'i komplotojë të gjitha ligjet nga pakoja sociale, në mënyrë që në vitin 2013 të startojmë me një sistem social i cili krijon mbulesë të arsyeshme për të gjitha shtresat e popullatës, të cilat nuk përfitojnë nga kontratat e punës. Ju faleminderit!.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Mendoj se problematika e pensioneve është një çështje që duhet të diskutohet në shumë aspekte dhe padyshim se kategoria e pensionistëve është kategoria pothuaj se më e

dhimbshme e të punësuarve në sektorin publik, sepse kërkesat për pensione dinjitoze dhe kredibile, nuk janë kërkesa për lëmoshë, por janë kërkesa për njohjen e meritave që kanë pasur të punësuarit gjatë karrierës së punës.

Janë katër kritere që kanë shkaktuar këtë gjendje jo të mirë në sistemin pensional. Padyshim, arsyeja e parë është ë shkatërrimi dhe plaçkitja e fondeve pensionale në Kosovë. Arsyeja e dytë janë problemet e dhimbshme që ka sjell ekonomia e ergut, përkatësisht kalimi nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut. Arsyeja e tretë është privatizimi, një proces i cili ka qenë i pamëshirshëm ndaj punëtorëve dhe nuk kanë mundur konsolidimin e fondeve pensionale dhe arsyeja e katërt janë efektet anësore të tranzicionit ekonomik.

Dëshiroj të përkujtoj një fakt se Republika e Kosovës, në nenin 7 të saj, është përcaktuar si shtet i drejtësisë sociale, si shtet social dhe shtetet demokratike gjithmonë e kanë shumë parasysh komponentin sociale. Ndër vlerat themelore të Kushtetutës së Kosovës, është edhe vlera e një shteti social, e një drejtësie sociale e një shteti solidar, e një shteti i cili bazohet në parimin e humanitetit dhe në parimin e ndihmës reciproke.

Unë do të prezantoj 5 mundësi të konsolidimit të komplet sistemit pensional, e para është vullneti politik që nuk mungon tek ministri. Ministri ka demonstruar vullnet politik për të punuar në konsolidimin e rindërtimit të sistemit pensional dhe është vullnet politik edhe i Qeverisë, për shkak se vlerësoj se, nëse është bërë shumë për kategoritë tjera, për të cilat është gjetur zgjidhja ligjore, besoj që edhe për pensionistët ka hapësirë, ka hapësirë të demonstrohet vullnet politik i cili është edhe vullnet pragmatik, sepse të investosh në konsolidimin e sistemit pensional, është një gjë e mirë për secilin shtet pa marrë parasysh mundësitë.

Mundësia e dytë është krijimi i ekuilibrave dhe e baraspeshave të caktuara buxhetore. Ka mundësi që brenda planifikimeve buxhetore edhe vjetore edhe atyre të kornizës afatmesme, të ndërtohen aso balanca buxhetore që të drejtpeshohen drejt skemave pensionale dhe drejt krijimit të mundësive për konsolidimin dhe formimin e këtyre fondeve pensionale. Padyshim një mundësi që mund të shfrytëzohet pa dhimbje dhe pa dridhje ekonomike, është vendosja e tatimeve në produktet e luksit. Çdo kund, secili shtet ka tatime shtesë. Një pako duhan në Perëndim nuk kushton aq sa e ka çmimin, por duhani është produkt i luksit, alkooli është produkt i luksit, deri dikund edhe disa produkte janë tjera luksit dhe, nëse shkoni zë Zvicër dhe në Gjermani do të paguni pesëfish apo gjashtëfish këto produkte se në Kosovë dhe pikërisht këto mundësi duhet shfrytëzuar deri në maksimum.

Natyrisht, skema pensionale nuk mund të përmirësohet me një veprim qeveritar, me një ligj qeveritar, por me një politikë që në kontinuitet të përmirësohet edhe fondi edhe kuadri ligjor, besoj që mund të arrihet një standard çfarë e kanë vendet tjera evropiane dhe momenti i fundit është se reformimi i domosdoshëm i skemës së trustit të pensioneve. Në fakt Trusti i Pensioneve që akumulon kontributet e punëtorëve të arritura me ndjerës, në një mënyrë tjetëron ata nga disponimi i pjesës legjitime të tyre dhe domosdoshmërisht ne do ta gjejmë momentin e përshtatësh edhe politik që brenda

konceptit të Trustit të Pensioneve, pensionistët të kenë benificione edhe në politikat e kreditimit, por dhe në segmentet tjera financiare e jo sikur tash që pensionisti në fakt edhe pse e plotëson moshën e shfrytëzimit të mjeteve të kursyera në fakt, ai gjatë jetës së vet realizon vetëm një përqindje. Është krejtësisht e padrejtë situata që e kemi me Trustin e Pensioneve që në fakt, anëtari i familjes së pensionistit, nëse pensionisti po e zëmë vdes, merr përnjëherë komplet shumën e mjeteve, të cilat nuk janë të partnerit të bashkëshortit, kurse ai që ka investuar tërë jetën, nuk mundet të disponojë as në formë të kredive, as në formë të një hipoteke që mund ta vendosë në bankë për të realizuar një kredi, në mënyrë që sado pak të zbusë gjendjen e vet.

Unë mendoj se ka hapësirë të mjaftueshme për debat. Unë e di që këto kërkesat e përfaqësuesve të pensionistëve janë krejtësisht legjitime dhe unë inkurajoj që ata të shmangin çfarëdo politike brenda pensionistëve dhe të fillojnë negociatat me Qeverinë, me Ministrinë dhe jam i sigurtë se do të ketë një zgjidhje racionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të lajmëruar për diskutim i kemi edhe 12 deputetë, kryesisht janë nga radhë të Partisë Demokratike dhe të Lidhjes Demokratike., Është mirë për ta kufizuar kohën, por edhe me na dhënë ndonjë propozim konkret në mënyrë që ta mbyllim këtë debat. Ju kisha lutur që vërtet të japim propozime konkrete. Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Padyshim që ky debat parlamentar është më se i domosdoshëm, por në anën tjetër është pak sa i vonuar, mbase është dashur të kalojnë më se 13 vite nga paslufta dhe tash në nivel të Parlamentit të diskutohet për gjendjen e tyre vërtet të mjerueshme dhe nënçmuese.

E them nënçmuese nga se e ardhura mujore prej 45 eurove deri në 80 euro, të gjithë e dimë se nuk është pensin, por është më tepër një asistencë sociale. Përgjegjësia mbi të gjithë për faktin se kemi të bëjmë me një numër jo të madh, konkretisht me një kategori të pensionistëve, që nuk përbëjnë përqindje në indeksin e përqindjeve numër shumë të madh, duke marr parasysh me përqindjen moshës të qytetarëve të Kosovës. Andaj kemi të bëjmë me një përqindje shumë të vogël dhe me një, nëse nuk jemi në gjendje të menaxhojmë me një numër kaq të vogël, konkretisht me kthimin e dinjitetit të mirëfilltë të pensionistëve të Kosovës, atëherë ne tregojmë se vetë nuk kemi dinjitet dhe nuk kemi respekt për shoqëri e cila është e dëmtuar vite me radhë, përderisa shprehim shqetësimin për këtë situatë jo të lakmueshme më mirë me thënë të mjerueshme për pensionistët e Kosovës, është e udhës që tu ofrojmë edhe zgjidhje. Zgjidhja nuk është e pamundur për faktin se Kosova në dallim prej vendeve tjera qoftë rajonit, qoftë nivelit evropian, e ka indeksin e moshës së re shumë më të madh se sa vendet e tjera. Do të thotë, përqindja e popullatës moshës së re është shumë më e madhe se vendet e tjera, andaj edhe taksapaguesit dhe kontribuuesit e tillë janë në numër shumë më të madh se sa

mosha e vjetër dhe me një menaxhim të mirëfilltë një gjë e tillë shumë lehtë mund të arrihet, kështu që nëse rroga e parë do të jetë me rritjen e taksave të këtyre të punësuarve, konkretisht taksapaguesve apo të kontribut paguesve që të ndahet një pjesë nga të ardhura të tyre dhe të rritet fondi pensional.

Në anën tjetër, si zgjidhje tjetër alternative për situatën aktuale të cilën ndodhet Kosova, do të ishte më e mirë të bëhet lidhja në mes të Fondit të Trustit Pensional dhe Fondit Pensional, skemës pensionale në mënyrë që të derdhen apo alokohen ato mjete.

Por, në këtë rast, duke pasur parasysh se mjetet të fondit të trustit pensional, i takojnë qytetarëve të Kosovës dhe vetë qytetarëve të Kosovës, atëherë është e udhës që të mbahet një referendum në mënyrë që të merret pëlqimi i qytetarëve të Kosovës për alokimin e këtyre mjeteve nga trusti pensional në funksion të skemave pensionale për çka unë jam i bindur që askush nga qytetarët e Kosovës nuk do të dalë kundër këtij vendimi që të ndihmohet shtresa e pensionistëve të Kosovës.

Për fund, ne siç shoqëri nëse nuk i respektojmë paraardhësit tanë, nuk e respektojmë as shtetin tonë, dhe kur nuk e respektojmë shtetin, atëherë padyshim është aktuale kjo dukuri që ndodhë ngase shtetin e konsiderojmë si mjet ku përfitojmë e jo si një vend ku duhet të kontribuojmë për shtet.

Prandaj, ne si unë fuqishëm e përkrahi kërkesën e pensionistëve se vërtetë ata duhen të marrin pagë të dinjitetshme, jo ndihmë, jo lëmoshë, jo asistencë sociale, por në bazë të standardeve të cilat janë në vendet e rajonit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit! I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Po vërehet se po zgjatet debati si për nga rëndësia ashtu edhe nga nevoja që të gjejë zgjidhje, ngase mjaftë edhe është vonuar.

Shumë gjëra u thanë, i kemi përpara edhe rekomandimet e Komisionit me kusht që këto rekomandime të mos e kenë fatin e rekomandimeve të Kuvendit të para 7 vjetëve. Po ashtu, me kusht që të mos ngjajnë me komunikatën shterpe të Ministrisë Ekonomisë dhe Financave të janarit 2010 për rritjen e pensioneve dhe pagesën retroaktive.

Më lejoni këtë rast veç ta përmend pak edhe premtimin për pagesa retroaktive, përkundër se u pat nënshkruar nga punëtorët, nuk janë dhënë dhe ju e dini se si janë përdorë ato nënshkrime dhe po ashtu që kjo Qeveri ka obligime edhe më tepër ndaj kërkesës të kësaj kategorie edhe për vetë faktin që i ka përdor edhe në fushatë elektorale memorandumin për rritje të pensioneve.

Atë që e kisha dash me e përsëritur, ku mendoj ndoshta më pak u përmend për fond, do të kishte me qenë që edhe njëherë kjo Qeveri, nëse e ka pa të nevojshme, të ulet dhe të

bisedojë për diçka me Serbinë do të ishte dashur që për numër një: të bisedohet për pensionet, për fondin e grabitur.

Ky ndoshta do të ishte minimumi i seriozitetit të dy Qeverive që ulen edhe bisedojnë. Pra, do të ishte mirë po them edhe njëherë rekomandimet mos të mbesin vetëm në letër por gjendet mundësia të ulen të gjithë ata që janë përgjegjës për këtë edhe që t'i jetësojnë ato ngase është bërë mjaftë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur ju të gjithëve, të përshëndes edhe peticionin e pensionistëve.

Është një shqetësim i madh dhe është shprehje e një padrejtësie të madhe e cila për fat të keq nuk është adresuar ende sa e si duhet.

Unë s'dua të përsëris ato që u theksuan, por konsideroj se Komisioni ka bërë mirë që ka rekomanduar zgjidhje konkrete të cilat në parim ato që janë të zbatueshme i mbështes.

Kam konsideratë edhe për vështirësitë financiare të Qeverisë dhe mendoj që këtë konsideratë e kanë edhe pensionistët, por çështja do të duhej adresuar edhe në dialog të sinqertë social dhe nuk është vetëm me pensionistët. Dua të vë theksin sidomos te çështja që u theksua për të satën herë, po thonë nuk ka të keqe që të përsëritet diçka e drejtë dhe e mirë.

Fakti pse kjo çështje nuk është në tryezën e dialogut apo të bisedimeve, apo sido që t'i quajmë Prishtinë-Beograd? Ka qenë dashur të jetë prej fillimit. Dhe, shfrytëzoj rastin të them se janë edhe shumë çështje tjera që meritojnë të jenë në tryezën e bisedimeve para disa tjerëve që po na imponohen, duke i përfshirë edhe reparacionet e luftës.

Unë kam dëgjuar se Fondi pensional nuk është ashtu siç e perceptojmë ne, por ne duam të dimë çka ka ndodh me Fondin pensional të Kosovës? Është çështje jo vetëm financiare, ekonomike, sociale por është çështje edhe politike. Prandaj, mendoj se e para që do të duhej të bëhet të sqarohet dhe të adresohet siç duhet kjo çështje.

Çështja e dytë, mendoj që pensionistët e kanë pjesën e tyre të djersës në pasurinë shoqërore të Kosovës që po privatizohet dhe kanë të drejtë ta kenë pjesën e tyre edhe në fondin e privatizimit. Po ashtu, është një çështje që duhet të adresohet dhe duhet të krijohen mundësitë për të vepruar në Kosovë ato praktikrat që po veprojnë edhe në vendet e tjera.

Për më tepër, ka ndodh, në këtë padrejtësi të madhe, edhe një padrejtësi tjetër brenda saj! Edhe në atë të ashtuquajturën 20% të privatizimit janë përjashtuar pikërisht ata që kanë

qenë më të diskriminuarit, të përjashtuarit nga puna. Është një lloj diskriminimi i të diskriminuarve, diskriminim i dyfishtë.

Mendoj që duhet shtruar këtë çështje, sepse përsëri është fjala për djersën e pensionistëve e cila pastaj shitet e privatizohet, e shpesh bëhet “rrush e kumbulla” por nuk privohen nga kjo dhe nuk ka kuptim që të privohen ata që e kanë krijuar ato me djersën e tyre.

Dua të shtroj me lejen tuaj edhe çështjen e fundit, që nuk u theksua nga askush dhe është një nga çështjet që më bëri të marrë fjalën. Pra, është edhe fakti se Kosova ka veçori të shumta dhe një nga veçoritë është edhe një numër jo i vogël, mijëra vetë që kanë qenë të detyruar të bëjnë punë të detyrueshme nëpër burgjet e ndryshme në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Dhe është po ashtu një punë që nuk është marrë parasysh as si shtazh pa le më në format tjera. Dhe sa herë flitet për pensionistët dhe për stazhin e tyre, mendoj që duhet të përfshihen edhe ish të burgosurit politik, të cilët pa të drejtën e tyre dhe plus me format tjera të dhunës e të torturave tjera janë detyruar të bëjnë punë të detyrueshme, poshtëruese e tjera. Dhe falë sakrificave të tyre, është edhe pjesërisht kjo që kemi sot.

Mendoj që komisioni duhet të mos ndalet me këtë, por siç është kërkuar - në bashkëpunim me ekzekutivin, të gjejë përgjigje për çështjet e shtruara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pensionistë,

“Nuk kërkojmë lëmoshë, ndihmë apo hua, por kërkojmë statusin e pensionistit i cili na takon falë punës dhe angazhimit 40 vjeçar në zhvillimin e vendit”. Këto janë fjalët e një pensionisti me të cilin do të filloj këtë diskutim.

Gjendja e pensionistëve është e mjerueshme. Vdekje për së gjalli, paraqet shkelje më drastike të të drejtave të njeriut dhe ligjeve në fuqi.

180.000 pensionistë në Kosovë, prej të cilëve më shumë se 80.000 pensionistë dhe invalidë të punës të cilët kontribuan vite me radhë për veti dhe për zhvillimin e Kosovës edhe disa vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ballafaqohen me vështirësi të mëdha dhe asnjëherë kërkesat e tyre nuk u realizuan. Dhe, kjo ka ndikuar që pensionistët e Kosovës të radhiten në mesin e kategorive më të rrezikuara të popullsisë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe Evropë.

Përkundër faktit që shumica prej tyre për 40 vjet të punës e shkatërruan shëndetin, e tash përballen me skamje dhe me përpjeke për t'i siguruar kafshatën e gojës, dhe edhe pse kjo Qeveri pati premtime se do të rriten pensionet, kjo nuk ndodhi. Po ashtu, edhe pas komunikimit për media, me 21 janar të vitit 2011 me të cilën Qeveria përmes Ministrisë së Financave informoi se do të ketë rritje të pensioneve dhe kjo rritje do të jepet në mënyrë retroaktive nga 1 janari 2011, kjo nuk ndodhi.

Kjo Qeveri asnjëherë nuk e ka parë të arsyeshme që tema në agjendën e dialogut me Serbinë të jenë fondet pensionale të plaçkitura dhe asnjëherë kthimi i tyre nuk është kërkuar me ngulm. Pensionistëve duhet tu kthehet dinjiteti, sepse ata e meritojnë këtë. Andaj, kërkesat e pensionistëve që: pensionet mesatare duhet të jenë 60% nga vlera mesatare e pagës mesatare në Kosovë, që të hartohet dhe miratohet Ligji për pensione në bazë të të cilit pensionistëve do tu kthehet statusi në bazë të kontributit të dhënë për t'i përcaktuar kategoritë të pensionistëve, që me ligj të rregullohet statusi i pensioneve familjare dhe invalidëve të punës, që aprovimi i ligjit të mos kushtëzohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale me rritjen e pensioneve, që të formohet ekipi i ekspertëve të cilët do të punojnë në përpilimin e Ligjit për pensione edhe shumë kërkesa tjera janë shumë reale.

Pensionistët janë duke pritur Godonë, por sa do të presin ende, nuk dihet. Disa herë sot, gjatë diskutimeve u përmend buxheti, u përmend ajo ana financiare që do të jetë pengesë për realizimin e rritjes edhe për miratimin e ligjit i cili do të ketë ndryshime në të mirë të pensionistëve. Mirëpo, mund të them se i njëjti buxhet ka qenë edhe para fushatës elektorale edhe gjatë asaj, edhe pastaj, edhe tash, edhe tri vjetët e ardhshme ky buxhet nuk do të ketë ndryshime.

Andaj, këtu një gjë më e rëndë është se këtyre njerëzve iu është premtuar rritja, iu është premtuar kthimi i dinjitetit, mirëpo kjo nuk është realizuar. Domethënë, ka qenë një mashtrim. Këta njerëz janë mashtruar e janë shtresa që më së paku e meritojnë një mashtrim të tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën. Ke hequr dorë? Mirë! Atëherë, Salihe Mustafa e ka fjalën!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë qysh në fillim nuk pata planifikuar ta marr fjalën, por tash po e marr fjalën në cilësinë e anëtares së Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, sepse konsideroj se ka nevojë për një sqarim.

Së pari, po pajtohem të gjithë me diskutuesit, që gjendja e pensionistëve nuk është e mirë, se duhet përmirësohet, mirëpo unë mendoj se prej fjalëve pensionistët nuk përfitojnë.

Unë dua të jem konkrete dhe të bisedoj për Projektligjin që ka ardhur në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale. Dua t'ju njoftoj se të gjithë anëtarët e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale me një abstenim, pa asnjë votë kundër e kemi rekomanduar Projektligjin për Kuvend. Mandej, ndodhi ai peticioni, i cili i është drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe nga Kuvendi u kthye projektligji.

Unë mendoj se prej këtyre fjalëve që u thanë edhe bisedave, ministri që është këtu prezentë ka marrë ide edhe nëse ka mundësi me e inkorporuar këto në projektligj dhe të na e sjellë sa më shpejt në komision, gjegjësisht në Kuvend këtë projektligj.

Dhe, ne si Komision, zakonisht qysh i amandamentojmë projektligjet, do t'i ftojme pensionistët të jenë prezentë dhe së bashku do të bëjmë amandamentime aty ku ka mundësi dhe do ta bëjmë një ligj sa më të mirë, sepse konsideroj që nuk duhet humbur kohë, nuk duhet të vonohet ky ligj për arsye se nuk është e vërtetë që përfshihen vetëm dy kategori të pensioneve. Është e vërtetë se përfshihen këtu 5 lloj të pensioneve dhe te kontribut paguesit rritet pensioni për 26%, ndërsa për pensionet e moshës 11%.

Prandaj, unë mendoj që ky projektligj duhet të vijë sa më shpejtë në Kuvend dhe bashkë me pensionistët, Komisioni dhe Ministria ta bëjmë atë që është e mundur dhe pensionistët t'i marrin pensionet e tyre me rritje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haki Demolli, le të përgatitet Njazi Idrizi.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit! I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra, deputetë,

Të nderuar mysafirë pensionistë,

Me vëmendje të posaçme e kam lexuar dhe analizuar rekomandimin e komisionit, si dhe peticionin e koalicionit të pensionistëve të Kosovës, i cili është i nënshkruar së bashku me mbi 15 000 qytetarë të tjerë të Kosovës. Dhe, që në fillim dua ta përgëzoj Komisionin për rekomandimet e bëra Kuvendit të Kosovës, të cilat janë plotësisht të arsyeshme, të drejta dhe të ligjshme.

Sa i përket rekomandimit të parë, sipas të cilit kërkohet prej Qeverisë që në mënyrë urgjente të përgatisë pakon e projektligjeve lidhur me sistemimin e pensionistëve dhe invalidëve të punës, mendoj se jo vetëm që është kërkesë e ligjshme por është edhe më se e domosdoshme. Sepse, me një pako të tillë, më në fund pas afro 13 vjetëve në liri do të krijohet baza ligjore për sistemimin e pensionistëve, si dhe të invalidëve të punës i cili do të ndihmonte në masë të madhe në trajtimin adekuat të kësaj shtrese të shoqërisë kosovare e cila me punën dhe djersën e vetë ka ndihmuar në zhvillimin dhe ndërtimin e shtetit, por edhe në ndërtimin e shumë të mirave materiale, si: çerdhe, shkolla, spitale, universitete, fabrika të cilat populli i Kosovës sot është duke i gëzuar.

Me këtë pako ligjore, gjithashtu do të riformohej skema e pensioneve dhe do të veçoheshin personat të cilët kanë kontribuar me vite të tëra në Fondin pensional të Kosovës e që sot i takojnë kategorisë së pensionistëve. Me një reformim të tillë do të dallonte statusi i pensionistëve kontribut dhënës prej pensionistëve të tjerë dhe në këtë mënyrë do të realizohej edhe rekomandimi i dytë i komisionit.

Për mua, gjithsesi kërkesa më e rëndësishme e këtij rekomandimi është kërkesa e tretë, me të cilën pajtohem në tërësi dhe e përkrahu pa rezervë aprovimin e saj. Kjo kërkesë ka

të bëjë me lartësinë e pensioneëve që sipas saj pensioni mesatar duhet të jetë 60% nga paga mesatare në Kosovë.

Sipas Entit të Statistikës së Kosovës paga mesatare në Kosovë është 374 euro, kurse aprovimi i këtij rekomandimi do të nënkuptonte që pensioni mesatar në Kosovë do të bëhej 224 euro, gjë që do ta paraqiste ndoshta një shumë të mjaftueshme për mbijetesën e një pensionisti, në këtë periudhë të gjendjes së rëndë ekonomike, sociale nëpër të cilën po kalon Kosova.

Është kohë e rëndë, sidomos për kategorinë e pensionistëve, lartësia e pensioneëve të cilave me vite të tëra nuk kanë ndryshuar, ndërsa çmimet e mallrave të konsumit të gjerë përfshirë edhe të barnave, dita-ditës po rriten, gjë që ua ka bërë të pamundur që madje edhe në aspektin teorik të mbulohen gjatë muajit, ndërsa praktikisht mbulesa e tillë as që mund të imagjinohet e lëre më të zbatohet.

Se çmimet e mallrave të konsumit të gjerë janë duke u ngritur në vazhdimësi, tregon edhe fakti se që nga momenti i marrjes së ftesës për këtë mbledhje e deri sot në media u publikua informata se zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike do të lejojë rritjen e çmimit të rrymës prej 7,6% e rritja e çmimit të rrymës sigurisht do të ndikojë në rritjen zinxhirore edhe të çmimit e mallrave të tjera.

Dhe, vetvetiu shtrohet pyetja: si mund të jetojë apo të mbijetojë një pensionist 30 ditë në muaj me vetëm 45 euro? Ku dhe si ta shpenzojë më parë ai 1,5 euro që e ka në dispozicion në ditë, duke blerë bukë, gjëra ushqimore, barna, veshmbathje, apo gjësende tjera për nevoja elementare personale dhe familjare, kur dihet se në Kosovë një bukë 700 gramësh kushton 0,30 cent, 1 litër vaj 1,30 euro, 1 kg sheqer 0,80 cent, 1 pako cigare 1 euro e kështu me radhë.

Arsye tjetër që më shtyn ta përkrahë këtë rekomandim është fakti se pensionet e pensionistëve kosovarë janë më të vogla se sa të pensionistëve tjerë të vendeve të regjionit dhe më gjerë. Kurse, në të njëjtën kohë paga mesatare në Kosovë është 374 euro, nuk është më e ulëta në regjion, apo për 8 herë është më e lartë se sa pensioni sipas moshës, raport kaq i pafavorshëm për pensionet mesatare nuk haset në asnjë vend të regjionit, as të Evropës.

Kështu, për shembull, në Shqipëri paga mesatare është afro 3 herë më e madhe se pensioni mesatar, ndërsa në të gjitha vendet e regjionit ky raport sillet prej 0,7 deri në 2,5 herë më e madhe në favor të pagës mesatare.

Me aprovimin e një rekomandimi të këtillë të gjithë deputetët dhe qeveritarët e Kosovës do të përmbushnin një obligim moral, njerëzor dhe ligjor ndaj pensionistëve të Kosovës, sepse në atë mënyrë do të siguroheshin të hyrat e domosdoshme për ekzistimin fizik të pensionistëve, por edhe do të përafrohej pozita dhe statusi shoqëror i pensionistëve kosovar në nivel deri diku të përafërt me atë që kanë kolegët e tyre në regjion.

Jo vetëm kaq, edhe kërkesa e 4, e cila ka të bëjë me lehtësirat dhe subvencionet për pensionistë lidhur me pagesën e komunalive, transportit, barnave, mjekimit - janë tejet të

arsyeshme dhe e kanë përkrahjen time të plotë, sepse aprovimi i një kërkesë të tillë do tua lehtësonte jetesën pjesëtarëve të kësaj kategorie të respektuar të shoqërisë kosovare, e cila për fat të keq pa fajin e saj në këto vitet e pasluftës është lënë anash duke mos u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të dinjitetshme, ashtu siç e meriton dhe siç trajtohet në të gjitha vendet e zhvilluara dhe demokratike të botës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Njazi Idirizi n'mujshim me rrumbullakuar deri në 5 minuta.

NJAZI IDRIZI: Po, a? E rrumbullakoj!

Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Gjithë ne jemi dëshmitarë se kriza ekonomike që e ka goditur pothuajse tërë Evropën ka sjell edhe shumë probleme dhe dilema rreth skemave pensionale në këto vende.

Shtetet e Bashkimit Evropian që janë goditur më shumë nga kjo krizë, kanë filluar të marrin veprimet e drejtpërdrejta në skemat pensionale ku në disa shtet e kanë ulur shumën e pensioneve deri në 30%, kurse disa të tjera po përpiqen ta gjejnë një rrugë të mesme duke e zgjidhur moshën e pensionimit. Skemat pensionale në Evropë, edhe kur kjo ka qenë e ndarë në dy blloqe, nuk kanë pasur ndonjë dallim, për të mos thënë se janë pothuajse identike.

Debatet që po zhvillohen në Kosovë lidhur me avancimin e skemave pensionale po dominohen nga ideja e përqafimit të këtyre skemave që aktualisht Evropa po bën përpjeke maksimale për t'i ndryshuar. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm lidhur me propozimet që bëjmë.

Nëse Kosova në të gjitha fushat tjera ngec prapa vendeve në zhvillim, të paktën nëse e analizojmë mirë, e ka një avantazh më të madh nga vendet tjera të Evropës, që të ndërtojë skema pensionale shumë më të qëndrueshme dhe që të ofrojë zgjidhje afatgjata, sepse në Kosovë ka ndodhur një fat në fatkeqësi dhe skemat e tilla pensionale të cilat Evropa po i sjellin telashe të mëdha në Kosovë nuk janë funksionale, prandaj kushdo që propozon modelet të tilla duke u thirrur në modelet aktuale të BE-së mund të bëjë një gabim shumë të madh.

Të nderuar deputetë,

Në Kosovë që nga viti 2002 ky Kuvend ka aprovuar një skemë të re pensionale e cila duhet të jetë bazike dhe alternativa më e mirë për ndërtimin e sistemit të ri pensional e invalidor.

Ligji bazik i pensioneve siç po e quajmë ndryshe edhe "ligji i pleqërisë" është funksional. Po ashtu, edhe kategoria tjetër - ajo e trustit pensional është funksionale. E vetmja kategori sa kam dijeni unë e cila ende nuk është e funksionalizuar sa duhet, është kategoria e tretë, pensioni vullnetar. Pra, ligjin bazik për skemat pensionale e kemi të ndarë në këto 3 kategori. Por, i cili është problemi?

Ne nuk kemi probleme me përzgjedhjen e skemave pensionale, por e kemi një problem me pensionistët që kanë kontribuar në skemën e mëparshme dhe në bazë të atyre kontributeve ata janë dëmtuar jo pak, por shumë.

Unë mendoj se nuk kemi nevojë për hartimin e ndonjë ligji të ri, por duhet ta bëjmë amandamentimin shtesë në Ligjin bazik të pensioneve duke e rritur përshkallëzimin në bazë të përvojës së punës.

Edhe tash kemi një përshkallëzim të pensioneve për pensionistët kontributorë, kurse kriter është marrë dëshmia se duhet të kenë së paku 15 vjet përvojë pune. Në sistemin e kaluar mendoj se ky përshkallëzim duhet të rritet, në shkallën e parë të përfshihet një përvojë prej 10 vjetëve, në shkallën e dytë prej 15 vjetëve, kurse në shkallën e tretë duhet të përfshihet një përvojë pune mbi 20 vjeçare, dhe mbi këtë bazë të bëhet edhe shkalla apo diferenca e pensionistëve kontributdhënës.

Më duhet ta përmend faktin se do të ishte mirë që institucionet tona t'i marrin parasysh edhe punëtorët që kanë kontribuar edhe në të kaluarën e të cilët janë larguar me dhunë nga sistemi dhe edhe ata të përfshihen në skemën pensionale, me qëllim që ne pak a shumë tu dalim hakut, për atë kohë që ata kanë qenë në të vërtetë raste sociale.

Sa i përket pensionit invalidor, po ashtu kemi një ligj që i ka përfshirë pothuajse të gjitha kategoritë, por sipas informatave që unë i kam, këtu ka edhe abuzime edhe pse shkalla e invaliditetit është 100%. Ky ligj duhet të rishikohet, e po ashtu edhe këtu duhet të bëhet kategorizimi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja, Vjollcë Krasniqi e ka fjalën!

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, zotni kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm në sallë,

Diskutimi im nuk do të jetë shumë i gjatë. Besoj që do ta rrumbullakoj për dy minuta. Po diskutojmë për një temë të ndjeshme. Po diskutojmë për gjendjen sociale të një kategorie të shoqërisë sonë - për pensionistët dhe invalidët e punës.

Dëgjova nga disa prej deputetëve, që këta njerëz apo këtë kategori e quan të ndjeshme. Unë nuk do t'i quaja të tillë, por do ta quaja gjendjen e tyre të tillë, situatën e tyre do ta quaja të ndjeshme, sepse ata si të tillë nuk do të duhej të ishin të ndjeshëm. E si të mos jetë e tillë kur me shumën që përfitojnë ata nga shteti i tyre i pavarur.

Këta njerëz janë të deprimuar dhe deprimimi i tyre arrin aq sa ata heqin dorë nga drejtësia, që është antiligjore, antirregullare dhe kërkojnë mëshirë. I kërkojnë mëshirë Qeverisë, Kuvendit. Me të vërtetë shumë e dhimbshme!

Kjo ma përkujton kohën e shkrimeve të Migjenit e më pas të Esat Mekulit, që i takojnë shekujve të kaluar. Po ngre këtë paralele, që ndoshta dikush do të ma zë për të madh, por unë do të them që kërkesat e tyre nuk duan mëshirë, duan trajtim duan drejtësi.

Dhe, ne sot në këtë Kuvend, në këtë sallë, folëm shumica e deputetëve fjalë miradije. Qamë shumë për hallet e tyre. Ua rikujtuam edhe një herë në memorien e tyre se sa para dalin në kontot e tyre në muaj. Por, a mjafton kjo?

Andaj, unë vetëm do të doja që Qeveria të jetë e vullnetshme, të ndjejë gjendjen e tyre. Të krijojë politika sociale të qëndrueshme, të bëjë një zgjidhje optimale. Dhe, ndoshta e meritojnë më tepër, por unë kam bindjen se mund të gjinden forma, mënyra, fonde për realizimin e një të drejte themelore qytetare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Salë Berisha-Shala e ka fjalën!

SALË BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Qeveri!

Kolegë deputetë,

Gjithë të pranishëm,

Përshëndetje e veçantë pensionistëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të tyre, të cilët janë këtu.

Edhe unë do të bëj përpjekje, që shumë shkurt të bëjë një rrumbullakim dhe të bëjë përpjekje që me shkrim t'i dorëzoj rekomandimet e mija Njësisë së transkripteve.

Por, gjithsesi më lejoni t'i them nja dy-tri fjalë. Kjo temë si temë, është shumë e ndjeshme nuk po them se çështja e tyre është e ndjeshme siç e ceku kolegja, por tema është e ndjeshme për secilin për neve veç e veç, për secilin pra edhe për këta që janë në Qeveri, ne që jemi në Qeveri, por edhe ata që kanë qenë më herët dhe s'kanë bërë asgjë më tepër më shumë se sa na, në kuptimin se s'kanë pas mundësi, jo pse s'kanë dashtë po pse s'kanë pas mundësi, sikurse edhe ne sot që nuk po kemi mundësi të ecim më tutje përpara dhe ta ndryshojmë gjendjen. Dhe, mbi të gjitha duhet, që secili veç e veç të angazhohemi dhe bashkërisht të angazhohemi për këtë çështje dhe të gjejmë moduse, të gjejmë rrugë dhe të gjejmë zgjidhje realisht për ta përmirësuar këtë gjendje.

Mendoj se ky angazhim i yni mbi të gjitha, duhet të jetë i ndërtuar mbi humanizmin, në kuptimin se njeriu duhet të jetë më zemërgjerë se sa natyra, edhe pse shpesh dhe në këtë rast realiteti është më kokëfortë se sa zemërgjerësia.

Do të fokusohem pakë a shumë te rekomandimet e Komisionit në fjalë, që edhe e ka sjellë këtë debat në Kuvend. Rekomandimi i parë dhe i dytë i vetë se janë të mundshëm, sepse ne e kemi një strategji legislative për këtë vit, që i parasheh të punojë në këto ligje, që janë edhe në rekomandim.

Te rekomandimi i tretë, mua më vjen shumë çudi dhe befasohem se si ka mundur që Komisioni ta bëjë një rekomandim të tillë dhe të kërkojë që pensioni mesatar të jetë 60%. Unë po them këtu, du me ua kaluar humanizmin këtyre dhe do të them 100% le të rritet.

Ne mund të shkruajmë me laps shumë lehtë 100% e 1000%, por realiteti është krejt tjetër dhe nuk është mirë të njëjtësohen me situatën e pensionistëve tanë, sepse ata kanë të drejtë të mos e kuptojnë realitetin. Faktikisht kanë të drejtë dhe kanë të drejtë të mos i marrin parasysh se si po shkojnë rrjedhat, por ne si deputetë që e kemi edhe besimin e qytetarëve, duhet të rezonojmë pak më ndryshe, më realisht dhe jo vetëm të bëjmë fontanë dëshirash nëpër letër e realiteti të jetë pak më ndryshe. Pra, angazhimet duhet t'i kemi më të mëdha se sa fjalët, që u bënë këtu në Kuvend.

Rekomandimi i katërt, që ka të bëjë me një kërkesë nga Qeveria. Mendoj se pjesërisht është i paraparë edhe në ligjet, të cilat janë në fuqi, siç është fjala te barnat esenciale, kontrollat mjekësore dhe duhet urgjentisht të rregullohet për kategori edhe për transportin urban, sepse përveç mungesës së mjeteve financiare, janë tjerat humanitare, që nuk duhet të maltretohen pensionistët e të nxjerrin para nga kuleta duke iu dridhur dora e gjëra tjera, por duhet të jetë falas transporti urban, e kështu me radhë.

Ndërsa, për rekomandimi i pestë, duhet ta dinë edhe pensionistët edhe qytetarët e Kosovës, se Qeveria e ka në agjendë edhe çështjen e pensioneve në bisedimet teknike me Serbinë.

Unë nuk do ta zgjas më tepër. Diskutimin tim më gjerësisht me rekomandime, do ta dorëzoj në njësinë e transkripteve. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është diskutuesja e fundit Blertë Deliu-Kodra!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë pajtohem se pensionistët si kategori, janë një kategori janë një kategori jashtëzakonisht e rëndësishme e shoqërisë.

Megjithatë, unë mendoj se ata më së paku kanë nevojë për fjalë të ëmbla. Rekomandimet e mia do t'i dorëzoj me shkrim dhe nuk do ta shfrytëzoj këtë foltore për përfitime politike. Faleminderit shumë!

(Pjesë diskutimi, i dorëzuar me shkrim)

Fondi pensional konsiderohet si shtyllë kryesore, që mund të ofrojë zgjidhje afatgjatë për këto çështje:

- Ligji për pensionistët duhet të aprovohet sa më shpejtë;
- Duhet që patjetër të evidentohen të punësuarit ne tregun joformal, si dhe
- Inspektorati i punës të jetë në objektiv.

Sot gjatë seancës u diskutua gjatë, megjithatë propozoj që ne sot të zotohemi që ligjin ta aprovojmë sa më shpejtë.

Kualiteti i financimit të stabilizohet dhe të funksionalizohet pjesa ndihmëse e ku bëjnë pjesë:

- Shërbimet shëndetësore,
- Shërbimet sociale, si dhe
- Benificione të tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, edhe unë t'i them dy-tri fjalë e pastaj ta jap fjalën ty.

Të nderuar deputetë, ne i dëgjuam diskutimet e të gjithëve. Konsideroj, që edhe ministri do ta thotë fjalën e vet. Por, ne i kemi 5 rekomandime.

Propozimi është që të mbesin propozimi i parë, i dytë dhe i pesti, ndërsa si një çështje tjetër apo si propozim tjetër është që të formohet një grup nga komisioni funksional me përfaqësuesit e Qeverisë dhe me ekspertë për ta hulumtuar mundësinë e themelimit të fondit të pensionistëve.

Dhe, unë i kam disa propozime, nga mund të krijohet ky fond i pensionistëve. Thamë, se:

- 10 – 20% mund të jetë nga Fondi i privatizimit dhe unë mendoj, që ky Fond i privatizimit duhet të jetë në shërbim të krijimit të fondit të pensionistëve.

- 1 – 2%, të tatimohen të ardhurat e të gjithë personave të punësuar për Fondin e pensionistëve.

Do të thotë, kjo do të jetë çështje e Komisionit për t'i hulumtuar këto, por unë po i propozoj disa.

Nga fondi dhe gjithnjë po them fondi, fondi mund të krijohet edhe nga një tatim shtesë për bizneset në Kosovë, 1 – 2% të fitimit në tatim.

Mendoj që në institucionet e shtetit, të Qeverisë, në institucione të Parlamentit, po edhe në nivele komunale ka persona që janë të punësuar në dy e më tepër vende. Pra, nga ajo paga e dytë, mendoj që është mirë këta njerëz që i kanë nga dy e më shumë paga, le ta ndajnë një përqindje. Se a janë 5, 10, 15 a 20% është çështje e komisionit dhe e ekspertëve që e marrin një vendim për krijimin e fondit. Pasi të krijohet fondi, mund të shkohet në çështje tjera.

Dhe, ky grup ose ky komision, që formohet nga përbërja e legjislativit dhe ekzekutivit, brenda tre muajve ta sjellin ligjin në Kuvend. Pra, mbi bazën e punës së ekspertëve të këtij komisioni, brenda tre muajve ta sjellin ligjin në Kuvend. Unë mendoj, që kjo kishte me qenë zgjidhja më e mirë dhe më konkrete.

Por, pas fjalës së ministrit ne do të shkojmë në votimin e këtyre rekomandimeve, të disa rekomandimeve, që i kemi nga komisioni funksional. Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Pošto je rospodin predsednik rekao i naglasio koje su tri tačke prihvatljive, i u ovom slučaju što se mene tiče i ministarstva, od same prve tačke koja zahteva da hitno se pripremi paket nacrta zakona, to već znate i sami da već imamo to i predloženo i kroz registraciju a i pored toga, maltene, ti najosetljiviji zakoni su baš ove godine predviđeni. Kao što je Zakon o penzijama, Zakon o socijalnom staranju, Zakon o promeni socijalne šeme, tako da je sve tu u ovom paketu.

Što se tiče druge tačke ' reforma penzione šeme. Mi smo to već tehnički uradili, i ja sam juče već dobio preporuke koje bi trebalo biti naznačene u samom dokumentu zakona, u kome će ovi ljudi - penzioneri koji su plaćali doprinos - kontributpaguesit da imaju jednu reč gde će status njihov biti ne kao što je dosad bilo benificija, nego će biti penzija - „kontributpaguesit“, ili oni koji su plaćali doprinos.

I naravno, što se tiče tačke tri odnosno tačke pet, ja sam već bio rekao nekoliko puta i javno da sam ja još od samog početka pokušao da kontaktiram sa odgovornim autoritetima u Ministarstvu za rad u Republici Srbiji. Na žalost, nisam dobio nikakav odgovor iako sam pokušavao kroz neke i privatne kanale i službene da dobijem neki, bar bilo kakav odgovor, bar da su zainteresovani da pričamo o tome.

A što se tiče ovih drugih stvari, ja sam na samom početku već i rekao da se slažem sa svima. Sve što ste rekli, sve je na mestu. I ja bih voleo da možemo tako. Stvarno, 270 eura, stvarno je dobra ideja, ne bi mi palo na pamet, ali super za penzionere! Kolko već 200, 220, odlično je to! Pitanje normalno da se postavlja: odakle, ali verovatno ko predlaže 270 eura on verovatno i zna odakle. To bi bilo dobro rešenje i najprijatnije bi bilo.

Eh, sad kako god, ja sam uvek sa penzionerima, sa svim predstavnicima penzionera govorio samo jedno: da ćemo izgubiti ono što nemamo. A to je izgubićemo vreme! Kako vi god hoćete. Svaka od tih komisija, tehničkih grupa tražiće određeno vreme da bi mogli, eventualno i predloge da daju.

Ovo isto sam rekao i prošle godine kad sam na zatvorenim sastancima sa vama govorio da molim vas dajte da usvojimo zakon, da ne izgubimo vreme, zbog toga što posle ne možemo da nadoknadimo.

I opet, na žalost, izgleda da će isto da se desi. Ja mogu da vas molim, da Zakon prihvatite kakav jeste i da preporuke, uz dužno poštovanje predsedniku koji je dao dobro mišljenje, ali moj bi predlog bio da ih ignorišete u potpunosti odnosno da predeme na usvajanje Zakona, koji bi bilo vrlo konkretno nešto što bi se desilo.

Ovako, plašim se da ćemo opet morati da čekamo, i daj bože da nisam u pravu, budžet za neku drugu godinu. E to bi bio tek veliki gubitak, i ne bi mogli, bez obzira koji zakon

bude usvojen, a ne može da bude opet, opet neće biti dobar, neće biti idealan, jer svaki zakon uvek se nadograđuje, unapređuje, usavršava se. Ovakve iste probleme ima svaka zemlja u svetu. I nikad nijedan zakon nije savršen, uvek ima neke kategorije koja je izostavljena. Ali ako nemamo bazu, na koju stalno insistiram, onu bazu koju smo mi predložili, nikad nećemo stići do zakona koji je napredan i koji je dobar.

Prema tome još jednom ja vas molim da imate to na umu kad odlučujete. Volja Ministarstva za rad će apsolutno biti kao i dosad, uvek spremna na konsultacije, predloge, na duge sastanke koje smo uvek imali sa penzionerima - samo u cilju poboljšanja uslova penzionera. U to nemoj da sumjate! Ali, vas molim da imate na umu da stalno gubimo vreme. Već bi do sad bili na drugoj stepenici, o kojoj sam pričao, ali s vremenom smo izgubili puno vremena, diskutujući o tome. Hvala vam puno, još jednom!

KRYETARI: Diskutimet janë përfunduar.

Kjo çështje, edhe pse ka ardhur në Kuvend nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, është çështje e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale. E ai duhet të jetë komisioni funksional, që merret me këtë çështje. Do të thotë, kjo mendoj se dihet cili komision merret me këtë çështje.

Unë edhe njëherë po them, isha shkua në votimin për rekomandimin e parë, të dytë dhe të pestë! Urdhëro Ismet!

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zotni Kryetar!

Ne para vetes e kemi një propozim, gjegjësisht disa rekomandime pas këtij debati.

Dhe unë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, kërkoj që këto rekomandime të hedhen në votim, kështu siç i kemi dhe për to të votojmë. Se çka mund të prodhon më vonë, e si mund të bëhen, është çështje tjetër.

Ne konform procedurave e kemi obligim me i votuar këto rekomandime të këtij komisioni. Pra, si Grup Parlamentar kërkojmë që të hedhen në votim këto rekomandime që i kemi para vetes, mbi bazën e të cilave biseduam Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja, Suzan Novoberdaliu e ka fjalën!

ZUZAN NOVOBERDALIU: Faleminderit, kryetar!

Pikërisht, atë që e tha edhe zotëri Ismeti, pata me e propozuar.

Ne në Kuvend kemi ardhur me pesë propozime. Të gjitha propozimet dëshirojmë t'i votojmë. Bile, bile konsideroj që pikën, të cilën e keni propozua, të hiqet dhe treshi e katërshi janë pika shumë me rëndësi për pensionistët. Dhe, tani a do të votohen dyshi dhe treshi, a treshi dhe katërshi, dhe a do t'i marrin shumicën e votave, është diçka tjetër, mirëpo të t'pestat kërkojmë t'i qesim në votim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Deputeti, Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Vërtetë ne sot kemi debatuar gjerë e gjatë për një kategori, e cila është tepër e ndjeshme, dhe që e meriton mbështetjen e të gjithë neve.

Mirëpo ne vlerësojmë si Grup Parlamentar, se pensionistët kanë nevojë për një mbështetje reale, për zgjedhje të problemit dhe jo manipulim apo zhagjitjen e zgjedhjes së problemit të tyre.

Ne jemi plotësisht dakord dhe mbështesim propozimin që e dhatë ju dhe të përkrahet pika 1, 2 dhe 5, sepse janë të realizueshme. Ndërsa për pikat 3 dhe 4, ne kërkojmë që paraprakisht duhet të kemi ligjin që e rregullon njëherë e përgjithmonë këtë problem. Duhet të kemi fondin, burimet prej nga t'i sigurojmë ato dhe pastaj vërtetë të kemi një zgjidhje.

Nëse ne e përkrahim pikën 3 dhe 4, ne do të manipulojmë me vullnetin, do të luajmë me ndjenjat e pensionistëve dhe ne të gjithë do të marrim një përgjegjësi dhe e dimë që sot se nuk kemi mundësi të realizohen këto dy pika.

Prandaj, unë iu bëj thirrje të gjithë deputetëve të Parlamentit, të mendojnë arsyeshëm për shtetin, për vendin tonë dhe mos ta fusim Qeverinë dhe vendin në kolaps.

Ne e kemi Fondin Monetar Ndërkombëtar këtu. E kemi pas një problem, janë sanuar raportet dhe jemi të mbikëqyrur. Prandaj, ju bëj thirrje që pikën 3 dhe 4 mos ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, i jepni propozimet e juaja, të gjithë deputetët, që e kanë kërkuar fjalën, por mos diskutoni se diskutimet janë harxhuar! Do të thotë, duhet ta keni parasysh këtë çështje. Fjalën e ka kërkuar deputeti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne jemi që të votohen këto pika, këto kërkesa, të cilat janë bërë nga pensionistët. Natyrisht, këto janë kërkesa të pensionistëve, të cilat janë dorëzuar përmes një peticioni dhe rrjedhimisht tash t'i ndryshojmë ato ne duhet që të bisedojmë edhe një herë me përfaqësuesit e pensionistëve për t'i ndryshuar ato.

Pra, këto janë kërkesa të pensionistëve, të cilat duhet hedhur në votim dhe në bazë të votimit le të mbesin ashtu, kurse deputetët le të votojnë si të donë ata. Mirëpo jo që këto t'i tërheqim tash nga votimi tërësisht. Pra, konsiderojmë që pikat ashtu siç janë, duhet hedhur në votim.

KRYETARI: Deputeti Ahmet Isufi, e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Konsideroj që komisioni ka punuar kohë të gjatë dhe i ka sjellë rekomandimet. Nuk është mirë me ikë prej rekomandimeve të komisionit, për shkak se janë shqyrtuar më herët të gjitha mundësitë dhe nuk është mirë me kërkuar që tash për do interesa tjera - të ruajtjes

së Qeverisë e të imazhit të saj, meqë s'po e ruan ajo vet, të votojnë ndryshe deputetët. Ne kërkojmë që të votohen rekomandimet e paraqitura nga Komisioni.

KRYETARI: Faleminderit!

Jo, ju lutem, diskutimet kanë përfunduar. Asnjë diskutim më nuk është për këtë çështje.

Shikoni, unë mendoj që propozimi që e dhashë, është propozimi që brenda një periudhe të shkurtër mund të krijohet fondi dhe mbi bazën e fondit pastaj mund të realizohen edhe kërkesa e tretë dhe e katërt.

Megjithatë, unë jam i obliguar t'i qes në votim dhe i qes veç e veç, sepse kemi dallime. E s'mund ti çojmë krejt përnjëherë.

(Ndërhyrje)

Jo, mundemi! Sepse, tash kemi dallime, ju lutem! Votojmë secili si të do, por deri sa kemi dallime në rekomandime. Urdhëroni! Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Procedurat në Kuvend janë ndryshe. Me keqardhje! Rekomandimet e Komisionit kanë ardhur. Ose votohen rekomandimet, ose nuk votohen rekomandimet.

Nëse dikush ka propozim tjetër, le ta qet propozimin tjetër, por na nuk mundemi me thonë po marrim sikur a'lla kartë po zgjedhim: disa rekomandime po i marrim e disa jo të Komisionit. Nuk mundemi kështu!

(Ndërhyrje)

KRYTARI: Nuk e kam ndërmend më t'ia jap fjalën më askujt!

(Ndërhyrje)

Jo, fjalën nuk ia jap askujt më!

(Polemikë)

Realisht, unë mendoj që më mirë është krijimi i fondit dhe mbi bazën e krijimit të fondit, ne mund t'i zgjedhim këto probleme më mirë se sa që janë propozimet. Ne mund të shkojmë më tutje, por kemi një ndarje, që në debat s'e patëm këtë ndarje.

Kështu që, unë po dua realisht, ta gjejmë një gjuhë të përbashkët, sepse kemi dallim në rekomandime. Dikush është për tri rekomandime, një pjesë është për pesë rekomandime. Tash, unë po mendoj që i dëmtojmë në tërësi rekomandimet dhe unë nuk po dëshiroj t'i dëmtoj rekomandimet.

(Ndërhyrje)

Mos m'i tregoni tash ato mua! Jo, nuk jam për një pauzë. por Po, urdhëro Hydajet, qe po ta jap fjalën si deputet më i vjetër!

HYDAJET HYSENI: E kam një propozim procedural.

Ne e kishim një rekomandim të Komisionit, u diskutua dhe kishte edhe përkrahje, kishte edhe plotësime.

Kjo çështje është trajtuar si çështje e dy komisioneve. Në praktikën tonë dhe në praktikat demokratike të parlamenteve, kur një çështje konsiderohet si e dy komisioneve, lejohet mundësia që ato dy komisione të mblidhen bashkë dhe ta shqyrtojnë çështjen.

Prandaj, propozoj që komisioni funksional, në këtë rast Komisioni për Punë dhe Çështje Sociale dhe Komisioni për të Drejta të Njeriut, duke pas parasysh edhe debatin të mblidhen në një mbledhje të përbashkët, ta sintetizojnë dhe propozojnë një tekst të unifikuar. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Rita Hajzeraj e ka fjalën!

RITA HAJZERAJ: Kryetar! E para është që ky është peticion. Nuk është raport as nuk janë rekomandime që i kanë nxjerrë dy komisione.

Peticioni vjen në Komisionin për të drejtat e njeriut, shqyrtohet dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet për me ardhur në debat në seancë parlamentare. Ka ardhur në debat, debati i shteruar, është një rekomandim në të cilin përfshihen pesë kërkesa.

Fondi për pensionistë nuk mund të krijohet, sepse Komisioni për fond, zoti kryetar, duhet t'i ndryshojë 5 a 6 ligje, e ani me u krijuar fondi. Për me u krijuar fondi duhen 120 milionë euro, nëse ju i keni, me i vendosur aty e pastaj të krijojmë fondin për pensionistë.

Unë konsideroj se tash duhet ta hedhim në votim një rekomandim me pesë kërkesa, sepse është peticion, nuk është vetëm kërkesë.

KRYETARI: Ju lutem, ne nuk merremi me votimin e peticioneve, as të teksteve të peticioneve. Ne merremi me votimin e rekomandimit të komisioneve. Nëse nuk e dini, mësoni.

Unë përsëri po ju them: Jeni kah e ndërlikoni çështjen që unë nuk po dëshiroj ta ndërlikoj.

(Ndërhyrje)

Myzejene Selmani e ka fjalën!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se u diskutua thuaja se sot tërë ditën çështja e debatit mbi të drejtat e pensionistëve apo gjendjen e tyre dhe të invalidëve të punës, duhet të gjithë të reflektojmë pozitivisht, pavarësisht a është pozitë a opozitë.

Në rast se domi të luajmë politikisht me ndjenjat e pensionistëve, atëherë llogarisim se mundemi me i bë fontanë dëshirash edhe 80% të pagës ose 100% të pagës. Po ju them shumë sinqerisht, duhet të kemi kujdes se luajnë shifra marramendëse në buxhet të Kosovës.

Dhe, për një vendim më të mirë a po votohen këto rekomandime apo plotësohen ndoshta ashtu si është më së miri për vetë pensionistët që janë sot prezentë këtu, nuk duhet të luajmë e as me këta njerëz për çështje politike. Prandaj, kryetar, është mirë të marrim pauzë prej 10 minutave.

KRYETARI: Pauzë, jo. Por, dy komisionet le t'i harmonizojnë rekomandimet. Ne po vazhdojnë punën, e komisionet le ta kryejnë atë punë.

(Ndërhyrje, sugjerime, propozime)

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Atëherë, po e bëjmë një pauzë prej 10 minutash, por pas këtyre 10 minutave ju lutem të ktheheni në sallë.

(Jepet pauzë prej 10 minutash)

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Po vazhdojmë punën e seancës. Në sallë, i kemi 88 deputetë.

(Ndërprerje e incizimit)

Hydajet, a mos e kërkoje fjalën?

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Jam i autorizuar që këtë që do ta them, ta them në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por jam i bindur shumë që shpreh edhe vullnetin e pjesës më të madhe të deputetëve dhe të grupeve tjera parlamentare.

Kolegë deputetë,

Ne sot e kishim në shqyrtim një rekomandim të Komisionit për të drejtat e njeriut lidhur me një shqetësim dhe peticion të një kategorie që e vlerësuam bashkërisht si objekt i brengosjes së përbashkët.

Komisioni për të drejtat e njeriut është i obliguar që të bëjë rekomandime nga fusha e veprimit të tij dhe rekomandimet nga kjo fushë hasën në mirëpritje dhe u përkrahën nga të gjitha grupet parlamentare.

Mirëpo, çështja del edhe jashtë suazave të të drejtave të njeriut. Propozohen rekomandime që shkojnë edhe në formën e nismës ligjvënëse. Sepse, propozojnë zgjidhje që janë sistimore, funksionale dhe me implikime financiare. Në raste të tilla, në praktikën tonë dhe në çdo praktikë parlamentare nuk votohet në mënyrë parciale dhe me ndarje votash, por gjenden zgjidhje - modus vivendi që e mundësojnë funksionimin e vazhdueshëm në përputhje me rregullat e procedurës. Dhe, në këtë rast, kjo do të dukej në këtë mënyrë:

Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut hasën në mirëkuptim dhe çështja është adresuar mendoj nga Komisioni, meriton të falënderohet. Por, për çështjet që janë funksionale nuk është Komisioni për të drejtat e njeriut që mund të ofrojë zgjidhje më të mira. Edhe po t'i ofrojë zgjidhjet më të mira, nuk mund të miratohen në Kuvend pa kaluar në komisionin funksional, sepse kanë të bëjnë me sistemin pensional.

Për më tepër, ka edhe çështje të tjera që janë të natyrës financiare, të cilat nuk mund të shqyrtohen pa kaluar në Komisionin për buxhet e financa.

Nuk ka, për fat të mirë, por të kishte edhe çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve, jemi të obliguar që edhe ato të shkojnë në Komisionin përkatës. Ose, po të kishte çështje që lidhen me integritet evropiane dhe me standarde evropiane, të shkojnë edhe atje. Kjo është procedura me të cilën funksionojmë.

Prandaj, edhe propozimi im është: Që ky debat të bartet në komisione. Bashkërisht komisioni funksional, me Komisionin për të drejtat e njeriut të sintetizojnë edhe debatin dhe të marrin parasysh diskutimet dhe propozimet që u dhanë. Ishin shumë të tilla dhe ishin të përkrahshme nga deputetët, dhe pastaj t'ia përcjellin rekomandimet Komisionit përkatës për financa e buxhet dhe në këtë mënyrë ne ta harmonizojmë të gjithë procesin edhe me përpjekjet që po bëhen për ta rregulluar këtë çështje me ligj.

E shtoj edhe një rrethanë. Ky Kuvend ka pasur në procedurë edhe propozimin e ligjit, siç u tha. Komisioni përkatës funksional i ka sjell rekomandimet. Për arsye, që dihen, është kthyer ligji në ripunim. Kur kthehet ligji në ripunim, do të thotë se nënkuptohet që punohet që të merren në konsideratë edhe vërejtjet që janë bërë në debat.

Edhe sikur Kuvendi të kishte nisë një nismë ligjvënëse për një çështje që është funksionale, sistimore – me Rregullore ne jemi të obliguar që ta njoftojmë Qeverinë dhe të shikojmë nëse punohet në atë fushë. Prandaj, një harmonizim me ekzekutivin, është përsëri një rregull elementare.

Për të gjitha këto, propozoj që ne të mos ndajmë votën në grupe parlamentare, sepse jemi në një çështje në të cilën jemi të gjithë bashkë. Kemi të njëjtat shqetësime. Por, ta fusim në binar të shqyrtimit institucional në komisione: në Komisionin për punë dhe çështje sociale, e pastaj edhe në Komisionin për buxhet e financa, e tjera.

Ky është propozimi im dhe i Grupit Parlamentar të PDK-ës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri, në emër të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pas kësaj që u tha, ne qëndrojmë pranë kërkesës që pas përfundimit të debatit dhe pas kalimit të gjitha procedurave, sepse kjo ka kaluar edhe në Kryesi dhe është futur në rend të ditës, i ka plotësuar të gjitha kriteret e kushtet dhe sot për mendimin tonë, dikuajt i bie në mend për këto që u thanë më herët, është total e paqëndrueshme dhe ne si Grup Parlamentar kërkojmë që ky rekomandim, me këto kërkesa, të hedhet në votim në tërësi pas përfundimit të këtij debati.

Përndryshe, dalim edhe jo seriozë. Sepse, një Parlament në këtë mënyrë, në fund të debatit, pas disa ore dalim shumë joserioz, se s'kemi ditur për çka kemi folur, sipas asaj që pak më herë u tha.

Ne e dimë çka kemi kërkuar, sepse është në bazë të gjitha procedurave. Prandaj, kërkojmë, në emër të Grupit Parlamentar që këto kërkesa të përmbledhura në një rekomandim, të votohen në grup dhe le t'i votojnë deputetët ashtu siç dëshirojnë.

Pra, kjo është procedura. Në të kundërtën, të gjitha këto janë shkelje të procedurës së paraparë me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të cilës edhe punon ky Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne pra i qëndrojmë prapa asaj që thamë më herët, para pauze, për këtë çështje. Ne kërkojmë që ky rekomandim të hidhet në votim, sot.

Është e vërtetë se këto rekomandime do të kenë edhe implikime financiare, por një gjë duhet të dihet, e këtë e theksova edhe në fjalimin tim, se kur është puna te pensionet dhe në përgjithësi për ajo se si e ndërtojmë ne shtetin, duhet të bazohemi në të drejtën. Pra, niset nga e drejta e njeriut dhe ajo është pikënisja, e pastaj aty duhet të gjejnë mënyra edhe ekzekutivi dhe institucionet tjera që ta bëjnë të mundshme. Jo të nisemi nga e mundshmja e pastaj t'i reduktojmë të drejtat në bazë të asaj se sa kemi mundësi dhe si, se pastaj përherë do të përfundojmë në ngushtimin dhe mungesën e mundësive, dhe pastaj do të themi për çdo gjë se nuk kemi mundësi.

Pra, kërkojmë edhe një herë që këto rekomandime të hudhen në votim dhe pastaj, natyrisht, deputetët le të vendosin si duan të ëvotojnë karshi tyre.

KRYETARI: Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Definitivisht, edhe ne mendojmë si dy parafolësit. Rekomandimet duhet të hudhen në votim. Do të ishte shkelje e rëndë, nëse pas këtij debati, të mos ndodhë një gjë e tillë.

Në të njëjtën kohë, dua të them se argumentet që u dhanë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës tani kanë qenë dashur të jepen në fillim të seancës, e jo në fund.

Këto argumente, që u folën tash kanë qenë dashur të na përmenden kur ka nisur debati, jo të lejohet debati dhe të gjithë të nxjerrim lot krokodili për pensionistët dhe tash në fund t'i ndërrojmë fjalët.

Pra, duhet pra të hidhet në votim, e partitë që janë në pushtet duhet ta qesin votën ashtu qysh mendojnë. Partitë në opozitë e qesin votën qysh mendojnë, dhe gjithkush e paguan një çmim për votën e vet.

Ne jemi të gatshëm me e paguar çmimin. Le të jenë të gatshëm me e paguar çmimin edhe ata që mendojnë ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, nuk ua jap fjalën më. Shaip, mësou me rregulla. Këtu s'ka nevojë për sqarim, sqarimet u kryen. Tash, sqarimi është në votim.

(Ndërhyrje)

Nuk ka nevojë. Foli Grupi Parlamentar dhe asnjë fjalë s'e dua më! Të lutem, mësou si duhet me u sjell në Kuvend! Diskutimet janë kryer. Tash jemi në procedurën e votimit dhe votoni si të doni.

Unë e kisha për qëllim me e gjetur rrugën më të mirë dhe propozimi im ka qenë më i mirë. Por, këto propozime qysh janë dhënë, dhe mendoj se pa pëlqimin e komisionit funksional dhe pa pëlqimin e Komisionit për buxhet e financa, nuk mund të shkojnë. Megjithatë, përgjegjësia le të mbetet te ata që votojnë.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, atëherë do të votojmë sipas bindjes që e kemi.

I votojmë rekomandimet e Komisionit për të drejtat e njeriut.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje)

Urdhëro!

(Ndërhyrje – polemikë)

Atëherë, lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë edhe një herë. Votojmë tash:

(Ndërhyrje e S. Hamiti: Njehni sa janë, me emër! Shikoni! Nëse s'njehen që tash deputetët sa janë, është manipulim dhe nuk do të pranohet....)

Mirë! Regjia, një moment! Sekretaria, i numëroni deputetët, sa janë prezentë!

Në sallë janë 92 deputetë, si prezencë fizike.

(Ndërhyrje – polemikë)

Edhe një herë ju them se në sallë janë 92 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

47 janë kundër, 43 janë për, 1 ka abstenuar.

(Ndërhyrje – polemikë)

Propozimi i dytë, nuk shkon.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, do të vazhdojmë punën nesër, në ora 10.

* * *

(Seanca vazhdoi punën më 2 mars 2012)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministër Rexhepi,
Në seancë kemi 64 deputetë dhe vazhdojmë punën.

Para se të vazhdojmë, e ka një kërkesë zëvendëskryeministri Petroviq. Urdhëro, e ke fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI, SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala poštovani predsedniče!
Uvaženi narodni poslanici,
Uvaženi ministre,
Zbog dodatnih konsultacija, zajedno sa konsultacijama i sa šefovima grupa poslaničkih stranaka u Parlamentu, u ime Vlade, kao predlagača zakona, tražimo da se drugo razmatranje Zakona broj 0446 o javnom prenosu na Kosovu, ta tačka odloži za sledeću sednicu. Hvala!

KRYETARI: Ju e dëgjuat propozimin. E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Po, realisht, ne jemi konsultuar edhe me shefat e grupeve tjera parlamentare. Jemi dakorduar që Ligji për RTK-ën të shtyhet për një javë, me qëllim të koordinimit apo edhe disa veprimeve që duhet bërë në këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse nuk ka sqarim adekuat dhe faktikisht jo rrallë herë është bërë traditë të shkelen procedurat e Kuvendit, për arsye që mund të jenë objektive, edhe ne pajtohemi që ky ligj të shqyrtohet në seancën e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri, a do të deklarohej Grupi juaj?

VISAR YMERY: Po, edhe ne e pranojmë të shtyhet për një javë, edhe pse nuk na duket se për çështjen që duhet ta diskutojmë kjo javë do ta zgjidhë këtë problem, por meqenëse është kërkesa, e pranojmë për një javë.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne jemi konsultuar, dhe pajtohemi që të shtyhet për një javë, por shpresojmë se nuk do të shtyhet më shumë, sepse mund të shkojë një muaj shumë shpejt dhe është me rëndësi që kjo të vjen më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re!

MYZEJENE SELMENI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se unë s'jam konsultuar për këtë çështje, prapëseprapë, për arsye të ardhjes së një ligji shumë funksional, atëherë për një javë ditë i jepet mundësia.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Sasha e ka fjalën!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Samostalna stranka se, naravno, slaže sa predlogom Vlade i mi smo za to da se odloži za nedelju dana ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 6+, deputetja Duda Balje e ka fjalën!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa 6+ je također saglasna sa predlogom Vlade da se ovaj zakon odloži za nedelju dana.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, të shkojmë me një votim formal.

Pyes, kush është për? Faleminderit!

Po vazhdojmë më tutje. Atëherë, konstatoj se pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës, shtyhet për një seancën e ardhshme.

Tani vazhdojmë me rendin e ditës dhe me pikën e pestë,

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale e familjare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, deputetin Fikrim Damka që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale e ka përfunduar shqyrtimin e Projektligjit Numër 04/L-31 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-17 për shërbimet sociale e familjare, dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me amendamente. Gjithsej i kemi 13 amendamente dhe unë kërkoj përkrahjen prej deputetëve për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Para se të hyjmë në procedurë të votimit, ju njoftoj se në këtë Projektligj janë propozuar gjithsej 13 amendamente nga komisioni funksional.

Amendamenti numër 4 dhe amendamenti numër 5 nuk janë përkrahur nga Komisioni për legjislacion.

Vazhdojmë me votim të amendamenteve.

Amendamenti 1,

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka,

Miratohet.

Amendamenti 3,

Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Tani jemi te amendamenti 4. Komisioni funksional, pa përkrahje të Komisionit për legjislacion.

Kryetarët e komisioneve nëse kanë ndonjë arsye, mund të deklarohen. A e doni fjalën? Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Amendamentet 4 dhe 5 janë refuzuar, siç e dini, prej Komisionit për legjislacion, për arsye se bie ndesh me procedurat e rregullave legislative dhe me Rregulloren e Kuvendit, dhe Komisioni duke marrë parasysh edhe praktikën e deritashme dhe duke parë rëndësinë e qëllimit të ligjit, mendon ai duhet të jetë sa më të mirë dhe më funksional. Mendojmë se këto amendamente duhet të përkrahen, sepse e bëjnë ligjin më funksional.

Komisioni, gjithashtu gjatë amendamentimit të projektligjit, ka bashkëpunuar edhe me Ministrinë përkatëse dhe amendamentet kanë qenë të harmonizuara edhe me ministrin.

Komisioni mendon se sipas rregullës që ende është në fuqi, këto amendamente mund të përkrahen nga deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, shkojmë në votim. Fjalën e ka kërkuar edhe kryetari i Komisionit për legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Arsyeja pse Komisioni për legjislacion nuk e ka përkrah, është sepse kanë ardhur jashtë procedurave. Nismat legislative për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, nuk i ka paraparë nenet që i kanë dhe Komisioni ka ndërhyrë në bazën e ligjit pa pasur nismë për ndryshimin e ligjit. Amendamentet janë jashtë nismës legislative, dhe për këtë arsye Komisioni nuk i ka përkrahur. Besoj se është e qartë.

KRYETARI: Jo, unë mendoj që nëse amendamentet e plotësojnë ligjin, nuk duhet të kundërshtohen. Po, megjithatë, ne po votojmë për këto dy amendamente.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe e votojmë, Amendamentin numër 4, amendament i komisionit funksional, po që s'e ka përkrahjen e Komisionit për legjislacion. Votojmë tash:

Me 65 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi amendamentin 4.

Tash e votojmë në të njëjtën mënyrë dhe procedurë edhe amendamentin 5. Votojmë tash:

Me 67 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Në radhë kemi amendamentin 6.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër, nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezent janë 76 deputetë.
Për kanë votuar 74 deputetë. Kundër s'ka, abstenim nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës,

6. Rekomandimi i Komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me vërejtjet e presidentes në Ligjin numër 04/L-76 për Policinë.

Komisioni parlamentar për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka shqyrtuar Vendimin e presidentes së Kosovës për kthimin në Kuvend të Ligjit Numër 04/L-76 për Policinë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Ahmet Isufi që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi shqyrtuar në Komision Vendimin e presidentes. I kemi bërë amendamentimet sipas propozimeve dhe jemi dakorduar që të shkojnë në votim amendamentimet.

Po ashtu, në amendamentin 4 e kemi një vërejtje, që është një lëshim teknik. Dhe kur të vijmë në radhë të shqyrtimit të atij amendamenti, e përmirësojmë.

KRYTARI: Faleminderit! Po ju e dini që, për të kaluar këto amendamente dhe ligji në tërësi duhen 61 votë, sipas Rregullores së punës të Kuvendit, kur i kemi rastet e rikthimit të ligjeve në Kuvend.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Me 73 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Me 72 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Me 73 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4. Deputeti Ahmet Isufi, e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Në amendamentin 4, neni 32 pas paragrafit 3, riformulohet paragraf i ri, me këtë përmbajtje:

“Me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve Drejtoria e përgjithshme e Policisë së Kosovës përveç stacioneve policore, që gjenden në secilën komunë, themelon edhe stacionet policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e Drejtorisë rajonale të Policisë Kufitare.”.

Kështu duhet të jetë formulimi, për shkak se është lëshuar një gabim, nuk është përmendur Drejtoria e përgjithshme këtu.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Ne konsiderojmë se vërejtja që e tha deputeti do të evidentohet edhe në transkript, dhe ne votojmë sipas korigjimit që e bëri kryetari i Komisionit. Përgatituni për votim dhe e votojmë tash amendamenti 4.

Me 69 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Dhe tani e kemi në radhë, amendamentin 5 dhe votojmë tash.

Me 74 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi i miratoi amendamentet në Ligjin për Policinë, dhe me ndryshimet e miratuara Ligji konsiderohet i shpallur. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës,

7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri deputetin Zenun Pajazitin që të marrë fjalën për ta arsyetuar raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, në kuadër të Planit të punës e ka paraparë po ashtu edhe mbikëqyrjen e zbatimit të disa ligjeve. Në këtë rast Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme ka qenë një prej ligjeve në agjendë dhe dëshiroj t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit, veçanërisht ata që kanë qenë më të përfshirë në Grupin punues, e po ashtu edhe anëtarët e Komisionit për buxhet e financa, zotin Latif Gashi dhe Muhamet Mustafa të cilët kanë qenë aktivë në gjithë procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji.

Është një prej ligjeve, të cilët për shkak të proceseve dhe zhvillimeve sidomos në projektet e infrastrukturës në vendin tonë ka qenë më delikat, pra ka qenë një punë më e shtruar për ministritë përkatëse dhe për institucionet lokale sidomos të gjykatave për shkak edhe të shqetësimeve herë pas herë edhe të ankesave të ndryshme që kanë dalë nga banorët të cilët janë përballë me zbatimin e këtij ligji.

Komisioni ka arritur t'i kontaktoj të gjitha institucionet përkatëse, duke përfshirë ministritë, institucionet e ndryshme - degë ose departamentet e ndryshme të ministrive

përkatëse, Zyrën e kryeministrit, Gjykatën Supreme dhe faktorë tjerë të cilët kanë pas interes ta trajtojnë këtë projektligj.

Grupi punues dhe rrjedhimisht Komisioni ka ardhur në përfundim që duhet t'i nxjerr disa rekomandime të cilat në Komision i kemi miratuar, dhe më lejoni t'i lexoj.

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Ministria e Financave të nxjerrin akte të nevojshme nënligjore në afatin prej 6 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.

2. Organi shpronësues Qeveria dhe komuna duhet të bëjnë studime të hollësishme dhe të kujdesshme sikurse kërkohet në ligj për të provuar që qëllimi i shpronësimit është i ligjshëm e publik.

3. Organi shpronësues Qeveria dhe komuna duhet të jenë transparente në nxjerrjen e vendimeve për shpronësim gjatë fazave të parashikuara me ligj.

4. Vendimet preliminare të organit shpronësues duhet të përbëjnë arsyetimin për ligjshmërinë e qëllimit të shpronësimit.

5. Vendimet e organeve shpronësuese duhet të jenë me gjuhë të qartë, të saktë dhe të përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen me ligj.

6. Ministrinë përkatëse dhe komunat që në fillim të procedurave të shpronësimit të zhvillojnë konsultime paraprake me komunitetin që tanojnë nga shpronësimet duke u bazuar me standardet dhe përvojat ndërkombëtare.

Dhe po ashtu, është edhe një rekomandim shtesë:

7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë duhet t'i raportojë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për nivelin e zbatimit të ligjit, së paku një herë në vit.

Dëshiroj po ashtu të theksoj që Komisioni ka pasur takime dhe me disa komuna për të shikuar edhe shqetësimet e komunave. Në këtë rrafsh kemi zgjedh edhe një prej komunave e cila drejtohet nga komunitetet pakicë dhe për të parë po ashtu nëse ka shqetësime edhe të komuniteteve në raport me zbatimin e Ligjit për shpronësimin.

Ajo që ka qenë më shqetësuese, për shkak të numrit të ankesave, ka qenë po ashtu edhe një numër i madh i lëndëve të cilat trajtohen në Gjykatën Supreme dhe po ashtu nga takimet që i kemi pasur lidhur me shqetësimet që i kanë thënë vetë përfaqësuesit ose drejtuesit të këtij organi, është pa që rrjedhimisht një numër i madh i qytetarëve kanë kërkuar ose kanë mendua se këto lëndë të tyre ose këto kërkesa do të duhej të trajtoheshin edhe në nivele të gjykatave komunale.

Megjithatë, ne kemi pas po ashtu edhe tendenca ose propozime të ndryshme edhe me qëllim të ndryshimit të ligjit, po në ndërkohë kemi mësuar se Gjykata Supreme ka

kërkuar edhe një sqarim shtesë nga Gjykata Kushtetuese dhe kemi mendua që paraprakisht duhet të presim se eventualisht do të mund të kishte ndonjë sqarim të tillë nga Gjykata Kushtetuese në mënyrë që ne të mos interferonim në institucionet e drejtësisë sidomos në çështje që kanë të bëjnë me ligjet ose eventualisht të drejtat e njeriut, e tjera..

Më lejoni po ashtu që rrjedhimisht, pasi e kam fjalën, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'i mbështesë këto rekomandime të nxjerra nga Komisioni funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti e industri, dhe po ashtu që të mbetemi me shpresë se jo vetëm ky komision por edhe institucionet tjera të përkujdesen që zbatimi i këtij ligji të jetë sa më i saktë.

Ne shpresojmë po ashtu që institucionet me vetë faktin se u kanë dhënë prioritet projekteve të mëdha zhvillimore, po ashtu kërkojmë edhe nga institucionet e drejtësisë që t'i trajtojnë me prioritet edhe ankesat eventuale që mund të dalin nga qytetarët për çështje të ndryshme të pronave të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e ka fjalën deputeti, Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Edhe anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së kanë marrë pjesë në monitorimin e Ligjit në kuadër të Grupit punues.

Janë të themi dy çështjet të cilat mund të ndahen për mangësi. Njëra ka të bëjë me çështjet administrative apo mangësi në zbatimin e ligjit, dhe janë dy: është kundërshtimi i vendimeve që bëjnë me Gjykatën Supreme. Në rastet kur Qeveria është shpronësues, Gjykata Supreme i kryen punët e gjykatës së shkallës së parë, kështu që nga ana e kryetarit të Gjykatës Supreme jemi njoftuar se kjo është në kundërshtim me praktikën edhe me Ligjin mbi Gjykatën Supreme. Ne besojmë se shpejt kjo çështje do të zgjidhet nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Çështja tjetër, prapë përsëri administrative, shtë përmbajtja e vendimeve për shpronësim. Në shumicën e vendimeve mungon shpjegimi për qëllimin e shpronësimit dhe mungon botimi i aktit dhe shuma e kompensimit. Pra, janë dy çështje administrative kanë mangësi të zbatimit të Projektligjit.

Në anën tjetër, ne përkrahim rekomandimet, që janë 3 rekomandime. E para është që duhet të bëhet patjetër studimi i rastit për shpronësim, para se të bëhet shpronësimi;

E dyta, është të rritet transparenca me nxjerrjen e vendimeve për shpronësim, dhe

Dhe e treta, është zhvillimi i konsultimeve paraprake me banorë para se të bëhet shpronësimi i një paluajtshmërie. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Vetëvendosjes, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetët

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, i përkrahë këto rekomandime dhe do t'i votojë.

Konsiderojmë që deri në masë të madhe këto do ta përmirësojnë punën në këtë çështje, sidomos të institucioneve dhe veçanërisht kështu është i rëndësishëm rekomandimi i fundit pra rekomandimi 6, i cili e obligon ose e thërret Qeverinë, ministrinë përkatëse që të ketë takime, konsulta edhe një lloj dakordimi paraprakë me komunitetin të cilin do të shpronësohet prona e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj, e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës përkrahë rekomandimet, por vendimet dhe afatet të cilat janë caktuar në afatin gjashtëmuor ose afatet tjera, duhet në mënyrë të përfikët të realizohen dhe mos të lihen që këto afate të zgjaten e mos të merren vendime në kohën e caktuar. Ndërsa rekomandimet të cilat ai ka cekur Komisioni, i përkrah Grupi i Aleancës.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh punën e deputetëve, e cila është e obliguar në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, që mos të jetë vetëm në amendamentim të ligjeve por edhe në monitorim të ligjeve, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, e ka marrë Ligjin për shpronësim të pronës së paluajtshme, ligj i cili i mundëson edhe ndërtimin e projekteve shumë të mëdha mirëpo njëkohësisht ligj i cili është i një rëndësie të posaçme për arsyet e zbatueshmërisë së tij.

Puna e Komisionit është shumë e mirë sidomos në rekomandimet të cilat kanë dal pas monitorimit të ligjit dhe Koalicioni për Kosovë të re i përkrahë 6 rekomandimet, me rekomandimin 7, mirëpo kërkon që këto rekomandime nga Qeveria të jenë të zbatueshme për arsye se është Ligj i cili është shumë i ndjeshëm për qytetarët dhe ankesat e tyre të mos vijnë edhe një herë në Kuvend, siç kanë ardhur, por të zbatohen dhe të kthehen këto rekomandime në mendim për Qeverinë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të SLS-së, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem gospodine predsjedniče!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke, takode je aktivno učestvovala u Radnoj grupi pri monitorisanju Zakona o eksproprijaciji. Smatramo da je zakon jako bitan za kosovsko društvo i podržace Grupa usvajanje izveštaja Komisije sa preporukama. Zahvaljujem!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit 6+, deputeti Albert Kinolli e ka kërkuar fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar 6+, e ka shqyrtuar këtë raport me rekomandime. Është për këtyre rekomandimeve dhe do të votoj për to. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe një deputet e kemi të lajmëruar për diskutim. Deputeti Imri Ahmeti, e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht kam pritur që ky Ligj do ta ketë vëmendjen dhe interesimin e deputetëve sepse deri tash procedurat e shpronësimit dhe zbatimi i këtij ligji kanë reflektuar dhe prodhuar disa pakënaqësi për të cilat të gjithë jemi në ngjarje.

Megjithatë, Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësim, padyshim e ka bërë një punë që duhet vlerësuar dhe rekomandimet janë mjaft specifike dhe me interes. Megjithatë, përveç që se e ka vlerësuar të drejtën e shpronësimit dhe procedurat e zbatimit, mendoj se ka anashkaluar çështjen e rregullimit për kompensim.

Komisioni konstaton se Ministria për Financa, deri tani nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ për zbatimin e këtij ligji dhe ky konstatim është në pikën 5 të raportit.

Neni 15.6 i Ligjit përcakton që Ministria e Financave, duhet me nxjerrë akt nënligjor për përcaktimi ne metodologjisë për përlllogaritjen e kompensimit për pronën e shpronësuar dhe dëmet nga shpronësimi në afat prej 120 ditësh.

Mirëpo çka ndodhi? Lidhur me këtë Komisioni rekomandon që brenda 6 muajve, pas miratimit të këtyre rekomandimeve, Ministria e Financave dhe Ministria e Planifikimit të nxjerrin aktet nënligjore.

Sa për rikujtim, po theksoj se ky ligj ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2009. Pra, përmes këtyre rekomandimeve, konsideroj se Komisioni nuk ka të drejtë të jep afat shtesë për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe tek e fundit është në kundërshtim me vet ligjin, të cilin e ka monitoruar.

Konsideroj se rekomandimi adekuat dhe në përputhje me Ligjin, do të duhej me qenë që të pezullohen të gjitha vlerësimet e pronave derisa të plotësohet legjislacioni sekondar. Këtë e themi sepse deri me tani janë vlerësuar me qindra prona në mungesë të zbatimit të neni 15.6 sipas konstatimit të Komisionit raportues.

Komisioni konstaton se dispozitat ligjore lidhur me nxjerrjen e vendimeve shpronësuese, nuk zbatohen sa i përket përmbajtjes së tyre. Konsideroj se këtu, përveç moszbatimit, kemi edhe defekte ligjore.

Nëse i referohemi vendimeve për shpronësim të nxjerra nga Qeveria e Kosovës, askund nuk mundësohet dhënia e të drejtës për kontestimin e bazushmërisë ligjore për nxjerrjen e vendimit për shpronësim, por njihet vetëm e drejta e kontestimit të shumës së vlerësimit, që i bie drejtpërsëdrejti në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës.

Nuk mund të jetë zgjidhje e drejtë ligjore publikimi i vendimeve preliminare për shpronësim vetëm në Gazetën zyrtare dhe në një gazetë ditore, në bazë të cilave pronari i paluejtshmërive mund të ushtrojë të drejtën për të kundërshtuar këtë vendim. Vendimi për shpronësim, është një akt që individualisht e atakon pronarin, prandaj pronari duhet të jetë i njoftuar zyrtarisht në të gjitha fazat dhe duhet të përcaktohet qartë e drejta e pronarit për ushtrimin e ankesës para marrjes të vendimit përfundimtar për shpronësim.

Prandaj propozoj se si rekomandim shtesë të jetë ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave përkatëse që e rregullojnë mënyrën e publikimit të njoftimeve për të drejtën e ushtrimit të ankesës që duhet të jetë në përputhje edhe me nenin 54 të Kushtetutës.

Çështje tjetër, është çështja e vlerësimit dhe e kompensimit për shpronësim dhe këtë çështje Komisioni mbikëqyrës e ka trajtuar vetëm nga aspekti i veprimt të organeve zyrtare, përkundër faktit se në planin e tyre të punës është paraparë takimi edhe me pronarët, pronat e të cilëve janë shpronësuar dhe vlerësimi nga ky aspekt shumë i rëndësishëm, na mungon.

Realizimi i interesit publik reflekton drejtpërdrejtë tek pronarët e caktuar dhe vlerësimet nga ana e tyre, nuk i dimë përveç shumë ankesave sipas raportit të gjykatave. Konsideroj se këtë çështje tepër të rëndësishme, Komisioni mbikëqyrës është dashur gjithsesi ta trajtoj.

Dispozitat ligjore për pagesën e kompensimit brenda dy viteve, nga marrja e vendimit përfundimtar, do të duhej rishikuar sa më parë dhe propozoj që kjo të hynë në radhën e rekomandimeve.

Edhe një herë i nderuar kryetar, do të doja ta keni vëmendjen tuaj. Rekomandimi i parë që e jep Komisioni, është në kundërshtim me vet Ligjin për të cilin e ka monitoruar ky komision. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tjerë nuk ka për diskutim, por numër për t'i votuar këto rekomandime, nuk kemi. Dhe, unë po ua tërheq vërejtjen sepse ne nuk i kemi as 45 minuta që e kemi filluar seancën dhe kemi një pa gatishmëri për të ndejt pak më gjatë në punën e Kuvendit.

Megjithatë, ne po vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës,

8. Shqyrtimi i Propozim-statutit të Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti edhe Industri e ka shqyrtuar Projektstatutin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti edhe Industri deputetin Zenun Pajazitit për ta arsyetuar raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E kemi sjell Raportin me rekomandime për Statutin e Autoritetit të konkurrencës së Kosovës. Siç e dini me Ligjin për autoritetin e konkurrencës parashihet që Kuvendi ta miratojë Statutin e këtij mekanizmi, këtij autoriteti.

Komisioni, rrjedhimisht me një grup punues, bashkë me përfaqësuesit të këtij autoriteti e kanë trajtuar një dokument fillestar të punuar prej Autoritetit të Konkurrencës e Kosovës. Dhe, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar edhe vetë përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës në përpilimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës.

Më lejoni t'ju them se gjatë përpilimit të këtyre dokumenteve shpeshherë Komisioni has edhe në laramani të ndryshme në funksionim të agjencive të ndryshme të autoriteteve të ndryshme, por në përputhje me ligjin jemi munduar që të jenë të adaptuara në mënyrë pak më uniforme.

Dhe, si do që të jetë, ky statut është i punuar nga vetë autoriteti dhe i miratuar apo i korrigtuar dhe se vetë Komisioni i ka trajtuar gjitha pikat e këtij statuti dhe mendojmë që është në përputhje të plotë me ligjin në fuqi, prandaj kërkojmë nga Kuvendi që t'ia jep dritën jeshile apo ta votojë këtë statut. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës, e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Pajaziti! Tani kërkojmë mendimet e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së do të flas Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë projektstatut të Autoritetit të Konkurrencës dhe e mbështetë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Shala! Për Grupin Parlamentar të LDK-së flet deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuari nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim. E unë, do t'i them disa fjalë për punën që është bërë aty.

Statuti besoj se tash në mënyrë më të mirë e përcakton një ndarje të kompetencave mes komisionit, si pjesë apo si anëtarë që emërohen nga Kuvendi dhe pjesës administrative të Autoritetit të Konkurrencës.

Është lejuar me statut organizimi i brendshëm i autoritetit, është bërë vetëm në vija të trasha, gjegjësisht vetëm departamente, kështu që i lejohet vetë komisionit të krijojë divizione tjera por ka hapësirë për ndryshimin e organizimit të brendshëm.

Është bërë definimi i mirë i kompetencave mes kryetarit dhe sekretarit, i cili është përgjegjës për çështje administrative.

Është ajo që s'ka qenë e paraparë me ligj, e tash e kemi me statut mënyrën e zgjedhjes së nënkryetarit të komisionit.

Janë dy çështje besoj gabime, lëshime teknike. Është neni 7 pika "i", që ka të bëjë me kërkimin e informatave në afatin 15 ditë e që është çështje që duhet të rregullohet me procedurën administrative. Dhe neni 15 thotë se konfliktet e interesit do të rregullohen me Ligjin mbi mbrojtjen e konkurrencës, kurse kjo në realitet rregullohet me Ligjin mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, shefi i këtij grupi, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do ta përkrahë këtë statut. Do të votojmë për.

KRYESUESI: Ju lutem! Iu sjell në vëmendje deputetëve që ka votime, ka ligje. Ejani në sallë ose e ndërprejmë, sepse nuk ka bisedime. Domethënë, ju thërras ejani në sallë! Nëse jeni nëpër byfe, a kah jeni! Më falni, Visar vazhdo!

VISAR YMERI: E përfundova unë, kryesues! Domethënë do të votojmë për statutin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri! Burim Ramadani flet në emër të Grupit Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do të votoj për Projektstatutin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ramadani, faleminderit! Në emër të Grupit të SLS a paraqitet ndokush? Fjalën e ka Murselj Haljilji!

MURSELJ HALJILJI: Hvala, presidanujući!
Parlamentarna Grupa Samostalne liberalne stranke će podržati Predlog statuta Kosovskog autoriteta za konkurenciju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haljilji! Në emër të Grupit 6+, Duda Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!
Parlamentarna grupa 6+ podržava Izveštaj sa preporukom o Statutu Autoriteta konkurencije Kosova.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë për të diskutuar.
Në sallë i kemi 53 deputetë, tash po hyjnë brenda të shoh, të presim 2-3 minuta e të shoh sa janë. Edhe regjia, i thërrisni me atë zilen tuaj që e keni, elektronik!

(Regjia, i bie ziles)

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Zotni deputetë, po vazhdojmë punën!

Në sallë kemi 65, shumica në byfe paskan qenë. Dhe mund të vazhdojmë!

Po kthehem te pika 7 që ta votojmë shqyrtimin e raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Ne i dëgjuam pak më parë vlerësimet e grupeve parlamentare, të cilët i lavdëruan ato përfundime. Unë ju njoftoj edhe njëherë se tash në sallë janë 67 deputetë dhe votojmë për këto përfundime. Regjia bëhemi gati, dhe votojmë tash:

Me 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi raportin me rekomandimet, Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Tash, votojmë për Propozim-statutin e Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës.

Ne dëgjuam mendimet e grupet e parlamentare dhe i dëgjuam dhe diskutimet e deputetëve.

Konstatoj, edhe njëherë që në sallë janë 67 deputetë. Thërras që të votojmë. Regjia dhe deputetë të bëhemi gati, dhe votojmë tash:

Tani në sallë janë 68 deputetë.

Dhe konstatoj se i kemi 68 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim dhe Kuvendi miratoi Statutin e Autoritetit të konkurrencës së Kosovës.

Në radhë është pika e nëntë e rendit të ditës,

9. Njoftim për rekomandimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje

Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit ka shqyrtuar mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Numër 04-DO-822 të datës 8 shkurt 2012 lidhur me pretendimet për shkeljen e Rregullores së Kuvendit gjatë punimeve të mbledhjes së jashtëzakonshme, të mbajtur më 31 janar 2012 dhe Kuvendit ia ka paraqitur përfundimin lidhur me këto çështje për njoftim.

Njoftimin e keni marrë të gjithë, i cili në esencë thotë që nuk ka pasur shkelje. Ky është njoftim dhe diskutim s'ka.

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës,

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Numër 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisjen lokale dhe Media deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandimet. Zoti Vehapi e ke fjalën!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe i ka dhënë amendamentet, e pas kësaj edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin.

Projektligji ka gjithsej 21 amandamente. Komisioni për Legjislacion e ka pas një vërejtje të vogël sa i përket amendamentit 5 dhe ka sugjeruar për një riformulim dhe ne e kemi marrë parasysh atë sugjerim.

Ndërkaq sa i përket vërejtjes së Komisionit për Integritet, që ka pas vërejtje në amendamentin 16, përkatësisht neni 31, pika 1 dhe neni 31 pika 2 dhe uqerimet e Komisionit për Integritet nuk janë marrë parasysh për faktin se ky amendament është në përputhshmëri të plotë me direktivën evropiane për AVMS-të dhe kemi qenë të detyruar që direktivën pas konsultave me ekspertin që e ka angazhuar Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, si Komision këtë direktivë e kemi marrë ashtu si ka qenë dhe është në amendament.

Nuk ka pasur vërejtje tjera. Prandaj i propozojmë deputetëve që Projektligjin, së bashku me amendamentet ta miratojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti raportues, kryetari i Komisionit! Në sallë i kemi 64 deputetë dhe fillojmë me votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1.

A ka kundër?

A ka abstenim?

Nuk ka kundër, nuk ka abstenim.

Miratohet, amendamenti 1.

Amendamenti 2

A ka kundër, a ka abstenim?

Nuk ka as kundër, as abstenim.

Miratohet, amendamenti 2.

Amendamenti 3,

Nuk ka as kundër, as abstenim.

Miratohet, amendamenti 3.

Amendamenti 4,

Nuk ka kundër, nuk ka abstenim.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5,

Kundër, nuk ka, as abstenim.

Miratohet, amendamenti 5.

Amendamenti 6,

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet, amendamenti 6.

Amendamenti 7,

Kundër nuk shoh se ka, abstenim nuk ka.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8,

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet, amendamenti 8.

Amendamenti 9,

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet, amendamenti 9.

Amendamenti 10,

Kundër nuk shoh që ka, abstenim nuk ka.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet, amendamenti 11.

Amendamenti 12,
Kundër nuk shoh që ka, abstenim nuk ka.
Miratohet, amendamenti 12.

Amendamenti 13,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet, amendamenti 13.

Amendamenti 14,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet, amendamenti 14.

Amendamenti 15,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 16,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 17,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 18,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 19,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 20,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 21,
Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.
Miratohet!

Ju lutem të bëheni gati edhe deputetët edhe regjia dhe t'i votojmë amendamentet që i miratuam dhe ligji në tërësi.

Në sallë prezentë i kemi 64 deputetë, dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota për, 1 abstenim, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Kolegë të nderuar,

Me kaq kryhet kjo seancë. Mirë u pafshim në seancat tjera!

Përgatiti:

Njësia për transkriptim dhe lekturë